

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. nr. 199/2015

14 qershor 2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtares së EULEX-it Franciska FISER, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët e EULEX-it Vidar STENSLAND dhe Rene Van VEEN si anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor të EULEX-it Dukagjin KERVESHI si procesmbajtës , në rastin penal kundër:

S. G., lindur më _____, në fshatin _____ në _____, me vendbanim të njëjtë të përhershëm, i punësuar në _____, i martuar me tre fëmijë, gjendja e mesme ekonomike;

akuzuar për:

- **Vrasje e rëndë** e I. I. në shkelje të nenit 147, pika 4) e Kodit Penal e Kosovës (KPK) (tani e tutje: KPK); dhe
- **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar armëve** në shkelje të nenit 328, paragrafi (2) i KPK;

dhe

A. G.1, emri i babait _____, emri i nënës _____, emri i vajzërisë _____, i lindur më _____ në fshatin _____, shqiptar i Kosovës, me vendbanim në rr. _____, Mitrovicë, i papunësuar, i martuar me tre fëmijë, gjendje e mesme ekonomike ;

akuzuar për:

- **Vrasje e rëndë** e M. I. në shkelje të nenit 147, pika 4) e KPK;
- **Tentim vrasje e rëndë** e B. I. në shkelje të nenit 147, pika 4) e KPK; dhe
- **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar armëve** në shkelje të nenit 328, paragrafi (2) i KPK;

Të dy të akuzuar përmes aktakuzës së Zyrës së Prokurorisë së Republikës së Kosovës të datës 26 maj 2010, ndryshuar me 17 mars 2016 dhe 13 qershor 2016;

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, të gjitha publike, më 7 mars 2016, 17 mars 2016, 23 mars 2016, 26 prill 2016, 29 prill 2016, 10 maj 2016, 13 qershor 2016 dhe 14 qershor 2016, shikimi i vendit të ngjarjes më 26 prill 2016, të gjitha në prezencën e prokurorit të EULEX-it të Republikës së Kosovës, i pandehuri **S. G.** dhe avokati mbrojtës i tij Hilmi Zhitia, i pandehuri **A. G. 1** dhe avokati mbrojtës i tij Haxhi Millaku, më 7 mars 2016, 17 mars 2016, 23 mars 2016 dhe 26 marsi 2016 gjithashtu në prezencën e palës së dëmtuar B. I. dhe më 17 mars 2016 gjithashtu në prezencën e palës së dëmtuar F. I.;

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 14 qershor 2016;

Sipas nenit 392, paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tani e tutje: KPPK) më 30 qershor 2016 në dëgjim publik dhe në prezencën e të pandehurit **S. G.**, i pandehuri **A. G.1**, Prokurori i EULEX-it , pala e dëmtuar B. I. dhe avokati mbrojtës i tij Gani Rexha;

Nxjerr në vijim:

AKTGJYKIM

I.

Nën AKUZËN 1, Vrasje e rëndë e M. I. dhe nën AKUZËN 2, Tentim vrasje e rëndë e B. I.:

I pandehuri **A. G.1** është shpallur **FAJTOR** për shkak se:

Më 4 dhjetor 2009 pas orës 12.00 afër kryqëzimit të rrugës “_____” dhe “_____” në Mitrovicë/Mitrovica, më specifik jashtë shtëpisë së R. G., në një rrugicë të vogël e cila kalonte para shtëpisë së G. e cila çonte në të majtë në kthesën kah shtëpia e I., **A. G.1** me **S. G.**, A. G.2 dhe R. G. janë takuar me I. I., B. I. dhe M. I.. Për shkak të një konflikti në vazhdim e sipër në mes të familjeve të të ndjerit I. I. dhe R. G., anëtarët e të dy familjeve kanë filluar të diskutojnë e cila u akumulua në një rrahje me grushte në mes të **S. G.** dhe B. I..

Pastaj B. I. ka hipur në veturën e tij BMW së bashku me bashkëshorten e tij M. I. dhe janë larguar me veturë nga qendra e Mitrovicës në mënyrë që me kërkuar ndihmë nga policia, ndërsa anëtarët e tjerë të dy familjeve kanë mbetur në vend.

Pas një kohe të shkurtë, B. I. dhe M. I. janë kthyer në veturën BMW. Vetura e policisë kishte arrite menjëherë pas veturës BMW dhe ishin ndalur në pjesën perëndimore të rrugës “_____” ndërsa B. I. ishte kthyer kah rruga “_____”.

Ndërsa B. I. ishte duke vozitur në rrugën “_____”, **A. G.1**, **S. G.**, A. G.2, R. G. dhe I.I. ishin duke qëndruar në rrugë afër kthesës së majtë në rrugicë. **A. G.1** e kishte drejtuar pushkën e llojit M57-TT me numër serik 132205 dhe kishte shtënë drejt veturës BMW e cila ishte duke u afruar. B. I. pasta e kishte kthyer veturën drejt **A. G.1** dhe e kishte goditur **A. G.1** me pjesën e majtë të përparme të veturës.

B. I. kishte vazhduar me vozitur pas goditjes me veturë dhe pastaj ishte duke e marr kthesën drejt shtëpisë së I., **A. G.1** kishte shtënë me pushkën e tij në drejtim të veturës BMW, duke e drejtuar kah B. I. dhe e kishte qëlluar atë në dorën e majtë. Me këtë **A. G.1** me qëllim ishte munduar me e privuar nga jeta e tij viktimën B. I..

B. I. kihste vazhduar me e vozitë veturën BMW te këndi, ishte ndalur para hyrjes së I. dhe kishte kapërcyer murin dhe kishte hyrë në oborr të I. , ndërsa **A. G.1** e kishte përcjellë veturën.

M. I. ishte duke dalë nga vetura kur **A. G.1** me qëllim kishte shtënë nga pistoleta e tij e llojit M57-TT me numër serik 132205, në drejtim të tij dhe e kishte qëlluar M. I. në dorën e majtë dhe kishte shkaktuar plagë vdekjeprurëse. Trajektorja e kësaj predhe kishte ecur nga ana e djathtë në të majtë dhe nga lartë poshtë dhe pak ishte kthyer prapa; plumbi ishte gjetur në vrimën e majtë në toraks. Me këtë veprim, **A. G.1** e ka privuar nga jeta e saj viktimën M. I..

Prandaj, A. G.1 ka kryer:

- veprën penale të Tentim Vrasjes së Rëndë ndaj B. I., në kundërshtim me nenin 146 të KPK në lidhje me nenin 20 të KPK; dhe
- vepra penale e Vrasjes së M. I., në kundërshtim me nenin 146 të KPK: dhe

PRANDAJ **A. G.1 DËNOHET** për kryerjen e veprës penale të **Tentim Vrasjes së Rëndë**, në kundërshtim me nenin 147, pika 11) e KPK në lidhje me nenin 20 të KPK, kështu duke e ri-kualifikuar pikën 1 nga akuza e Vrasjes së rëndë, në kundërshtim me nenin 147, pika 4) dhe pika 2 nga akuza e Tentim vrasjes së rëndë , në kundërshtim me nenin 147, pika 4).

II.

Nën AKUZËN 3, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve:

I pandehuri **A. G.1** është shpallur **FAJTOR** për arsye se:

Më 4 dhjetor 2009 pas orës 12.00 afër kryqëzimit të rrugëve “_____” dhe “_____” në Mitrovicë, në mënyrë më specifike jashtë shtëpisë së R. G., në një rrugicë të vogël e cila kalon para shtëpisë së G. dhe duke shkuar në kthesën e majtë e cila çon te shtëpia e I., **A. G.1** pa një leje të vlefshme nga organi kompetent, ka pasur në posedim një pistoletë të mbushur të llojit M57-TT me numër serik 132205, e cila ishte konfiskuar më vonë nga policia.

PRANDAJ, **A. G.1** është **DENUAR** për kryerjen e veprës penale **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) i KPK.

III.

Nën AKUZËN 1, Vrasje e rëndë e I. I.

I pandehuri **S. G.** është shpallur **FAJTOR** pasi që:

Më 4 dhjetor 2009 pas orës 12.00 afër kryqëzimit të rrugës “_____” dhe “_____” në Mitrovicë/Mitrovica, më specifik jashtë shtëpisë së R. G., në një rrugicë të vogël e cila kalonte para shtëpisë së G. e cila çonte në të majtë në kthesën kah shtëpia e I., **A. G.1** me **S. G.**, A. G.2 dhe R. G. janë takuar me I. I., B. I. dhe M.I.. Për shkak të një konflikti në vazhdim e sipër në mes të familjeve të të ndjerit I. I. dhe R. G., anëtarët e të dy familjeve kanë filluar të diskutojnë e cila u akumulua në një rrahje me grushte në mes të **S. G.** dhe B. I..

Pastaj B. I. ka hipur në veturën e tij BMW së bashku me bashkëshorten e tij M. I. dhe janë larguar me veturë nga qendra e Mitrovicës në mënyrë që me kërkuar ndihmë nga policia, ndërsa anëtarët e tjerë të dy familjeve kanë mbetur në vend.

Pas një kohe të shkurtë, B. I. dhe M. I. janë kthyer në veturën BMW. Vetura e policisë kishte arrite menjëherë pas veturës BMW dhe ishin ndalur në pjesën perëndimore të rrugës “_____” ndërsa B. I. ishte kthyer kah rruga “_____”.

Ndërsa B. I. ishte duke vozitur në rrugën “_____”, **A. G.1**, **S. G.**, A. G.2, R. G. dhe I. I. ishin duke qëndruar në rrugë afër kthesës së majtë në rrugicë.

Në të njëjtën kohë një person tjetër dhe **S. G.**, qëllimisht kanë shtënë me armë në drejtim të dhe e kanë qëlluar I. I.; më konkretisht **S. G.** ka shtënë me pistoletë të llojit TT me numër serik 967473766-1964.

I. I. i cili ka pësuar plagë në anën e djathtë të kokës së tij, anën e majtë të qafës, anën e djathtë të gjoksit dhe dorën e tij majtë, kanë vdekur në vendin e ngjarjes për shkak të hemorragjisë së shkaktuar nga plagët e armëve.

Me këtë veprim, **S. G.** e ka privuar nga jeta e tj viktimën I. I..

PRANDAJ, **S. G.** është **DËNUAR** për shkak të kryerjes së veprës penale të Vrasjes në kundërshtim me nenin 146 të KPK në lidhje me nenin 23 të KPK, në këtë mënyrë duke e ri-kualifikuar nga akuza e Vrasjes së rëndë, në kundërshtim me 147, pika 4) e KPK.

IV.

Nën AKUZËN 2, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve;

I pandehuri **S. G.** shpallet **FAJTOR** për shkak se:

Më 4 dhjetor pas orës 12.00 afër kryqëzimit të rrugëve “_____” dhe “_____” në Mitrovicë, më konkretisht jashtë shtëpisë së R. G., në një rrugicë të vogël e cila kalon para shtëpisë së G. dhe e cila çon në kthesën e majtë te shtëpia e I., **S. G.** pa ndonjë leje të vlefshme të lëshuar nga organi kompetent, ka pasur në posedim të tij një pistoletë të mbushur të llojit TT me numër serik 967473766-1964, e cila ishte konfiskuar nga policia më vonë.

PRANDAJ, **S. G.** është **DËNUAR** për kryerjen e veprës penale **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) i KPK.

V.

PRANDAJ , në bazë të dispozitave të nenit 36, paragrafi (1) nën paragrafi (2) dhe neni 38, paragrafi (1) dhe (2) i KPK, gjykata shqipton dënimet në vijim:

- **A. G.1** meqenëse është dënuar për veprën penale Tentim Vrasje e Rëndë nën akuzën 1 dhe akuzën 2 **DËNOHET** me katërbëdhjetë (14) vjet burgim;
- **A. G.1** meqenëse është dënuar për veprën penale Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve nën akuzën 3 **DËNOHET** me një (1) vjet burgim.

Në bazë të nenit 71, paragrafit (2) nën paragrafit (2) të KPK, gjykata shqipton dënimin **UNIK** në vijim :

A. G.1 DENOHET me burgim prej katërmbëdhjetë (14) vjet e gjashtë (6) muaj.

VI.

PRANDAJ, në bazë të dispozitave të nenit 36, paragrafit (1) nën-paragrafit (2) dhe nenit 38, paragrafët (1) dhe (2) të KPK, gjykata shqipton dënimet në vijim:

- **S. G.** meqenëse është dënuar për veprën penale të Vrasjes nën akuzën 1, DËNOHET me dhjetë (10) vjet burgim; dhe
- **S. G.** meqenëse është dënuar për veprën penale Mbjajta në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nën akuzën 2 DENOHET me një (1) vit burgim.

Në bazë të nenit 71, paragrafi (2) nën-paragrafi (2) i KPK, gjykata e shqipton dënimin **UNIK** si në vijim:

S. G. DËNOHET me dhjetë (10) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim.

VII.

Në bazë të nenit 391, paragrafi (5) të KPPK dhe nenit 278, paragrafi (7) i KPPK, koha e kaluar në paraburgim të caktuar dhe arrest shtëpiak nga **A. G.1** nga data 4 dhjetor 2009 derisa aktgjykimi të merr formën e prerë , do të llogaritet në dënim.

VIII.

Në bazë të nenit 391, paragrafi (5) i KPPK dhe nenit 278, paragrafi (7) i KPPK, koha e kaluar në paraburgim të caktuar dhe arrest shtëpiak nga **S. G.** nga 4 dhjetori 2009 derisa aktgjykimi të merr formën e prerë , do të llogaritet në dënim.

IX.

Arma – pistoleta e llojit TT me ngjyrë të zezë me numër serik 967473766-1964, e cila ishte e mbushur me plumba , me këtë **KONFISKOHET** në bazë të nenit 60, paragrafit (1) dhe nenit 328, paragrafi (5) i KPK.

Arma- pistoleta e llojit M57-TT me numër serik 132205, e cila ishte e mbushur me plumba me këtë **KONFISKOHET** në bazë të nenit 60, paragrafit (1) dhe nenit 328, paragrafi (5) i KPK.

X.

Në bazë të nenit 102, paragrafët (1) dhe (4) të KPPK, **A. G.1** do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej katërqind (400) euro jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim të marrë formën e prerë.

Në bazë të nenit 102, paragrafët (1) dhe (4) të KPPK, **S. G.** do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej katërqind (400) euro jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim të marrë formën e prerë.

XI.

Në bazë të nenit 112, paragrafi (2) i KPPK, palët e dëmtuara udhëzohen e tërë kërkesa pasurore juridike të realizohet në kontest civil.

ARSYETIMI

A. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 maj 2010, Prokurori publik i qarkut në Mitrovicë (Prokuroria) kanë paraqitur Aktakuzën PP nr. 405/09, në këtë mënyrë duke i akuzuar të pandehurit **S. G.**, **A. G.1** dhe

- A. G.1** për dy vepra penale, ‘Vrasje e rëndë’, në shkelje të nenit 147 pika 4) e KPK dhe për veprën penale ‘Tentim vrasje e rëndë’ në shkelje e nenit 147, pika 4) e KPK, lexuar me nenin 20 të KPK dhe të gjitha këto vepra penale të dënueshme ne baze të pikës 11) të nenit 147 të KPK dhe nenit 23 të KPK. Të pandehurit e përmendur janë akuzuar gjithashtu për ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’, në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) i KPK në bashkimin real të veprave penale të lartshënuara.
2. Në të njëjtën Aktakuzë, i pandehuri B. I. është akuzuar për veprën penale ‘Tentim vrasje’ në shkelje të nenit 146 lexuar në lidhje me nenin 20 të KPK. Gjithashtu i pandehuri Xh. I. është akuzuar për veprën penale ‘Kanosje’ në shkelje të nenit 161 paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) të KPK.
 3. Aktakuza është konfirmuar më 14 qershor 2010. Më 2 dhjetor, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it i ka caktuar rastin gjyqtarëve të EULEX-it duke u bazuar në nenin 3.3 të Ligjit për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Që nga kjo kohë, gjyqtarët e EULEX-it i kanë mbajtur kompetencat mbi rastin.
 4. Shqyrtimi i parë gjyqësor është nisur më 17 tetor 2011 dhe ka përfunduar më 8 nëntor 2011, kur është shpallur vendimi me gojë.
 5. Duke u bazuar në këtë vendim, i akuzuari **S. G.** është gjetur fajtor për veprën penale ‘Vrasje e rëndë’ e I. dhe M. I. në bazë të nenit 147 pika 11) e KPK dhe për veprën penale ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK, ku ai është gjetur i pafajshëm për veprën penale ‘Tentim vrasje e rëndë’ e B. I., sipas nenit 147 pika 4) e KPK. Ai është dënuar me dënimin unik me burgim prej katërmëdhjetë (14) vjet dhe gjashtë (6) muaj.
 6. I akuzuari **A. G.2** është gjetur fajtor për veprën penale ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK, ku ai është gjetur i pafajshëm për veprën penale ‘Tentim vrasje’, si në nenin 147 pika 4) e KPK, dhe ‘Tentim vrasje e rëndë’, si në nenin 147 pika 4) e KPK. Ai është dënuar me një vit burgim.
 7. I akuzuari **A. G.1** është gjetur fajtor për veprën penale ‘Vrasje’ të M. I. sipas nenit 146 të KPK dhe për ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të

- paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK. Ai është gjetur i pafajshëm për veprën penale ‘Tentim vrasje’, në kundërshtim me nenin 146 të KPK lexuar në lidhje me nenin 20 të KPK. Ai është dënuar me dënim unik me katër (4) vjet burgim dhe me gjobë prej 1000 Eurove.
8. I akuzuari B. I. është gjetur fajtor për veprën penale ‘Tentim vrasje’ në shkelje të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK. Ai është dënuar me shtatë (7) vjet burgim.
 9. I akuzuari Xh. I. është gjetur i pafajshëm për veprën penale ‘Kanosje’ në shkelje të nenit 161 paragrafi (4) i KPK.
 10. Pas ankesa të parashtruara kundër këtij Aktgjykimi, më 25 mars 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës , me aktgjykimin e saj PAKR 962/2012, i ka përkrahur ankesat e përmendura dhe duke u bazuar në nenin 402 paragrafi (1) i Kodit të ri të Procedurës Penale (KPPK), i cili korrespondon me nenin 424 paragrafi (1) i KPPK, *e ka anuluar ex-officio tërë aktgjykimin , duke e rikthyer rastin plotësisht në rigjykim.*
 11. Më 20 maj 2013, procedurat e rigjykimit janë hapur me numrin e rastit P 887/13. Gjatë këtyre procedurave, Prokurori i ka tërheqë akuzat në lidhje me Akuzën III të Aktakuzës, kështu edhe në lidhje me të pandehurin Xh. I. dhe akuzën për ‘Kanosje’. Megjithatë, pas qëllimit të njëres prej palëve të dëmtuara për të ndërmarrë ndjekje penale shtesë, më 21 maj 2013 trupi gjykues e ka veçuar procedurën kundër të pandehurit Xh. I. për veprën penale nën akuzën III të aktakuzës. Pasi që nuk është paraqitë asnjë ankesë kundër këtij aktgjykimi, e ka marrë formën e prerë.
 12. Më 5 qershor 2013 procedurat e ri-gjykimit me numrin e rastit P 887/13 kanë përfunduar me vendimin e mëposhtëm.
 13. I akuzuari S. G. është gjetur fajtor për veprën penale ‘Vrasje e rëndë’ e I. I. dhe M. I., në kundërshtim me nenin 23 dhe nenin 147, pika 11) e KPK, në pajtim me nenin 2 (1) të KPK dhe për ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK në pajtim me nenin 2 (2) të KPK, në bazë të nenit 388(1) të KPPK; ku ai është gjetur i pafajshëm për veprën penale ‘Tentim vrasje e rëndë’, nën nenin 20, neni 23 dhe neni 147, pika 1) e KPK, në pajtim me nenin 2 (1) të KPK. Ai është dënuar me një dënim unik me katërmëdhjetë (14) vjet burgim dhe gjashtë (6) muaj.

14. I akuzuari **A. G.2** është gjetur fajtor për veprën penale ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK, ndërsa ai është gjetur i pafajshëm për veprën penale ‘Vrasje e rëndë’, si në nenin 147 pika 4) e KPK dhe për ‘Tentim vrasje e rëndë’, si në nenin 147 pika 4) e KPK. Ai është dënuar me një vjet burgim.
15. I akuzuari **A. G.1** është gjetur fajtor për veprën penale ‘Vrasje e rëndë’ e I. dhe M. I., sipas nenit 23 dhe nenit 147, pika 11) e Kodit Penal të Kosovës, në pajtim me nenin 2 (1) të KPK, për Tentim vrasje të rëndë të B. I. nën nenin 20, neni 23 dhe neni 147, pika 11) e KPK, në pajtim me nenin 2 (1) të KPK dhe për ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK nën nenin 2 (2) të KPK; në bazë të nenit 388(1) të KPPK. Ai është dënuar me dënim unik prej njëzetë (20) vjet burgim, në bazë të nenit 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 e KPK.
16. I akuzuari B. I. është gjetur i pafajshëm dhe është liruar nga akuzat për veprën penale ‘Tentim vrasje’.
17. Kundër këtij aktgjykimi, janë parashtruar ankesat nga avokati mbrojtës Hilmi Zhitija për të pandehurin **S. G.** dhe nga avokati mbrojtës Haxhi Millaku për të pandehurin **A. G.1.**
18. Më 15 prill 2014, Gjykata e Apelit e ka lëshuar aktgjykimin PAKR 124/14, përsëri duke anuluar aktgjykimin e instancës së parë dhe duke e kthyer rastin prapa për ri-gjykim.
19. Më 6 mars 2015 procedurat e ri-gjyimit me numrin e rastit P. 68/14 kanë përfunduar me vendimin në vijim:
- I akuzuari **S. G.** është gjetur fajtor për kryerjen e veprës penale ‘Vrasje e rëndë’ e I. I. dhe M. I., në kundërshtim me nenin 147, pika 11) e KPK, në pajtim me nenin 2 (1) dhe (2) të KPK dhe për ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK në pajtim me nenin 2 (1) dhe (2) të KPK, në bazë të nenit 388(1) të KPPK; ndërsa është gjetur i pafajshëm për veprën penale ‘Tentim vrasje e rëndë’ e B. I., nën nenin 20, neni 23 dhe neni 147, pika 11) e KPK, në pajtim me nenin 2 (1) e KPK. Ai është dënuar me dënim unik prej trembëdhjetë(13) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim, në bazë të nenit 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 e KPK.

I akuzuari **A. G.1** është gjetur fajtor për veprën penale ‘Vrasje e rëndë’ e I. I. dhe M. I., nën nenin 23 dhe nenin 147, pika 11) e KPK, në pajtim me nenin 2 (1) dhe (2) të KPK, për Tentim vrasje të rëndë të B. I. nën nenin 20, neni 23 dhe neni 147, pika 11) e KPK, në pajtim me nenin 2 (1) dhe (2) e KPK dhe për ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ në bazë të nenit 328 paragrafi (2) i KPK në pajtim me nenin 2 (2) të KPK; në bazë të nenit 388(1) të KPPK. Ai është dënuar me një dënim unik me shtatëmbëdhjetë (17) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim, në bazë të nenit 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 e KPK.

20. Janë parashtruar ankesat kundër këtij aktgjykimi nga avokati mbrojtës Hilmi Zhitija për të pandehurin **S. G.** dhe nga avokati mbrojtës Haxhi Millaku për të pandehurin **A. G.1**.
21. Më 13 tetor 2015 prill 2014, Gjykata e Apelit e ka lëshuar aktgjykimin e saj PAKR.nr.430/2015, duke e anuluar aktgjykimin e instancës së parë dhe duke e kthyer prapa rastin për rigjykim.
22. Më 01 mars 2016, procedurat e shqyrtimit gjyqësor janë hapur kundër dy të pandehurve , **S. G.** dhe **A. G.1**, kësaj radhe me numrin e rastit P. 199/15.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

23. Sipas nenit 11 paragrafit (1) të Ligjit për Gjykata, Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në instancë të parë të gjitha rastet , përveç nëse parashihet ndryshe me Ligj.
24. Neni 9, paragrafi (2) nën-paragrafi (2.7) i të njëjtit Ligj parasheh që Gjykata Themelore e Mitrovicës është themeluar për territorin e komunave të Mitrovicës jugore dhe Mitrovicës veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Skenderaj dhe Vushtrri. Duke u bazuar në aktakuzën e paraqitur, veprat penale të dyshuara janë kryer në Mitrovicë dhe prandaj brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
25. Në bazë të nenit 15, paragrafi (1) nën-paragrafi (1.11) i Ligjit për Gjykata të lartshënuar, vepra penale ‘Vrasje e rëndë’ bie nën juridiksionin e Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, i tërë rasti është gjykuar nga Departamenti për krime të rënda.

26. Sipas paragrafit (2) të të njëjtit nen dhe në bazë të vendimit ¹ me ia caktuar rastin gjyqtarëve të EULEX-it më 8 dhjetor 2015 dhe duke iu referuar asaj që është paraqitur më lartë, rasti është dëgjuar nga trupi gjykues i përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Franciska Fiser, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Vidar Stensland dhe Gjyqtari i EULEX-it Rene Van Veen, si anëtar i trupit gjykues.

C. SHQYRTIMI GJYQËSOR

27. Seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të hapura për publikun dhe ato janë mbajtur më 7, 17 dhe 23 mars të vitit 2016, 26 dhe 29 prill 2016, 10 maj 2016, 13 dhe 14 qershor 2016, vizita e vendit të ngjarjes më 26 prill 2016, të gjitha në prezencën e Prokurorit të EULEX-it të Republikës së Kosovës, të pandehurit **S. G.** dhe avokati i tij mbrojtës Hilmi Zhitia, i pandehuri **A. G.1** dhe avokati i tij mbrojtës Haxhi Millaku, më 7 mars 2016, 17 mars 2016, 23 mars 2016 dhe 26 mars 2016 gjithashtu në prezencën e palës së dëmtuar B. I. dhe më 17 mars 2016 gjithashtu në prezencën e palës së dëmtuar F. I..
28. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 17 mars 2016, i akuzuari **S. G.** është deklaruar fajtor për veprën penale ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’, por është deklaruar i pafajshëm për pikat tjera të aktakuzës. I akuzuari **A. G.1** është deklaruar fajtor për pikën ‘Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve’ për posedim të armëve në atë ditë, 4 dhjetor 2009, por është deklaruar i pafajshëm për pikat tjera të aktakuzës.

D. ADMINISTRIMI I PROVAVE

i) Provat e paraqitura gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor

29. Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:

- B. I. (dëshmitar i thirrur si palë e dëmtuar) është dëgjuar më 23 mars 2016;

¹ GJA.nr. 454/15.

- Zyrtari i policisë F.K. (dëshmitar i thirrur *ex-officio* nga Gjykata) është dëgjuar me 23 mars 2016 dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 26 prill 2016 ;
 - Zyrtari i policisë R. I. (dëshmitari është thirre *ex-officio* nga Gjykata) është dëgjuar me 23 mars 2016 si dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 26 prill 2016;
 - A. G.2 (dëshmitari është thirre *ex-officio* nga Gjykata) është dëgjuar më 23 mars 2016 si dhe gjatë inspektimit të vendi të ngjarjes më 26 prill 2016;
 - F. L. (dëshmitari është thirre nga avokati mbrojtës i të pandehurit **A. G.1**) është dëgjuar më 29 prill 2016;
 - E. K. (dëshmitari është thirre nga avokati mbrojtës i të pandehurit **A. G.1**) është dëgjuar më 29 prill 2016.
 - Dëshmitari ekspert i balistikës H. K. (dëshmitar i thirrur nga gjykata *ex-officio*) është dëgjuar më 10 maj 2016 si dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 26 prill 2016 ;
 - Dëshmitari ekspert i mjekësisë ligjore T.G.(dëshmitar i thirrur nga gjykata *ex-officio*) është dëgjuar më 10 maj 2016 si dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 26 prill 2016;
30. Gjatës seancës së 23 marsit 2016, palët janë pajtuar që t'i konsiderojnë deklaratat si të lexuara, deklaratat të cilat janë dhënë më herët në gjykatë nga dëshmitarët F. I., J. S., R. G., S. M., V. M., M. G., B. O., dhe A. Z., në pajtim me nenin e 368, paragrafi (1), nën-paragrafi (1) i KPPK.
31. Gjatë seancës së 23 marsit 2016, të gjitha palët janë pajtuar që t'ia paraqesin çdo dëshmitari deklaratën e tij/saj të cilën e kanë dhënë në Gjykatë në procedurat e mëhershme dhe me pyetur dëshmitarin se a qëndron ai/ajo pas dëshmisë së dhënë, se a e ndryshon dëshminë ose a ka ndonjë gjë për të shtuar. Është bërë e qartë se secila palë ka të drejtë për të shqyrtuar, marrë në pyetje tërthorazi dhe me marr në pyetje çdo dëshmitar. Përveç kësaj, çdo palë do të ishte prezentë çfarëdo kohe prova të reja.
32. Gjatë seancës së 23 marsit 2016, palët janë pajtuar që t'i konsiderojnë si të lexuara deklaratat e dhëna më herët në Gjykatë më 24 maj 2013 nga dëshmitari ekspert, doktori M. G. në pajtim me nenin 368, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 i KPPK.
33. Gjatë seancës së 29 prillit 2016, palët janë pajtuar që të konsiderojnë si të lexuara deklaratat e dh.na më herët në gjykatë më 27 maj 2013 dhe me 6 shkurt 2015 nga eksperti

i balistikës, dëshmitarja H. H. dhe raporti i saj i datës 9 gusht 2010 në pajtim, me nenin 368, paragrafi 1, nën –paragrafi 1 i KPPK.

34. Gjatë seancës së gjykimit më 23 mars 2016, Skica² është paraqitur në dosje si respektivisht,

Prova A:

Skica me shenja e bazuar në përgjigjet e dëshmitarit B. I.;

Prova B:

Skica me shenja të bëra duke u bazuar në përgjigjet e dëshmitarit F. K.;

Prova C:

Skica me shenja duke u bazuar në përgjigjet e dëshmitarit R. I.;

35. Më 26 prill 2016, inspektimi i vendit të ngjarjes është kryer dhe skica e përmendur në pikën më lartë është përdorë gjatë këtij inspektimi.

36. Gjatë seancës së gjykimit më 10 maj 2016, Skica³ është paraqitur në dosje si, respektivisht:

Prova D:

Skica me shenja duke u bazuar në përgjigjet e dëshmitarit ekspert H. K..

37. Gjatë seancës së njëjte të gjykimit të datës 10 maj 2016, janë administruar edhe janë administruar edhe provat tjera si dëshmi:

Prova E:

Fotografia e maleoulos lateralis e dorëzuar nga dëshmitari doktori T. G.;

Prova F:

Fotografia e maleoulos medialis e dorëzuar nga dëshmitari ekspert doktori T.G..

38. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor së datës 13 qershor 2016, raporti mjekësor i Klinikës së radiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, e datës 12 maj 2016 është sjellë si provë në këto procedura.

39. Gjatë gjykimit të datës 13 qershor 2016, palët janë pajtuar që të konsiderojnë si të lexuara të gjitha provat nga lista e provave materiale të dorëzuara nga Prokuroria,⁴ përveç kallëzimit penal dhe gjithashtu janë sjellë si prova në këto procedura të gjitha provat të cilat janë administruar në gjykimet e mëhershme.

² Lënda e Prokurorisë nr. #III, faqe 34.

³ Lënda e Prokurorisë nr. #III, faqe 34.

⁴ Procesverbali i dates 13 qershor 2016, Aneksi "A".

40. I pandehuri **A. G.1** e ka dhënë një deklaratë gjatë gjykimit të datës 13 qershor 2016. Gjatë seancës së njëjte i pandehuri **S. G.** ka paraqitur dëshirën për të qëndruar prapa deklaratave të dhëna në procedurat e mëhershme në P 22/2010 më 2 nëntor 2011 dhe P 887/2013 më 28 maj 2013.

ii) Mocionet

41. Gjatë seancës dëgjimore të datës 17 mars 2016, avokati mbrojtës Haxhi Millaku ka paraqitur një mocion duke kërkuar caktimin e një eksperti për trafik. Avokati mbrojtës e ka arsyetuar këtë mocion gjatë seancës së 23 marsit 2016. Gjatë të njëjtës seancë, avokati mbrojtës e ka tërheqë propozimin e tij për të thirrë dëshmitarin P. F. dhe në vend të dëgjimit të këtij dëshmitari, avokati mbrojtës e ka propozuar E. K..
42. Gjatë seancës së njëjtë të 17 marsit 2016, Prokurori ka propozuar që të thirret për vendin e ngjarjes një ekspert të traseologjisë. Palët janë pajtuar që H. K. të caktohet si ekspert.
43. Më 24 mars 2016, kryetari i trupit gjykues e ka lëshuar një urdhër dhe e ka caktuar H. K. si ekspert të balistikës, i cili e ka informuar gjykatën se ai nuk mund të jep gjetjet e tij dhe mendimin pa pjesëmarrjen e një eksperti të mjekësisë. Prandaj doktori T. G. është caktuar si ekspert i mjekësisë.
44. Gjatë seancës dëgjimore të datës 10 maj 2016, avokati mbrojtës Haxhi Millaku e ka paraqitur mocionin duke kërkuar:
- Lëshimin e një urdhri për spital të Gjilanit për të siguruar Gjykatën me të dhëna mbi trajtimin e të pandehurit **A. G.1** dhe se a ia kanë vendos allçinë apo jo;
 - për të dëgjuar doktor Xh. L. si dëshmitar.
45. Më 11 maj 2016, kryetari i trupit gjykues i ka dërguar letra spitalit në Gjilan, Qendrës së paraburgimit në Gjilan duke kërkuar për t'i siguruar gjykatës dokumente mjekësore në lidhje me të pandehurin **A. G.1**.

46. Më 11 maj 2016, kryetari i trupit gjykues ka lëshuar një aktvendim duke e caktuar klinikën e Radiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për të kryer një CT për të pandehurin **A. G.1**.
47. Gjatës seancës dëgjimore të datës 13 qershor 2016, avokati mbrojtës i të akuzuarit **A. G.1**, avokati Haxhi Millaku ka paraqitur një mocion duke kërkuar mbledhjen e provave shtesë, siç është ekspertiza ortopedike mbi lëndimet të cilat i ka pësuar i pandehuri **A. G.1** kur është goditur nga vetura si dhe mundësia e tij për të lëvizur.
48. Gjatës seancës dëgjimore të datës 13 qershor 2016, trupi gjykues në pajtim me nenin 152, paragrafi (3) i KPPK ka lëshuar një aktvendim duke e refuzuar mocionet në vijim:
- Mocioni i paraqitur nga avokati mbrojtës Haxhi Millaku për caktimin e një eksperti t trafikut;
 - Mocioni i paraqitur nga avokati mbrojtës Haxhi Millaku për caktimin e një eksperti të ortopedisë;
 - Mocioni i paraqitur nga avokati mbrojtës Haxhi Millaku për të thirrë doktorin Xh. L.;
- me arsyetimin se këto tri prova nuk janë të nevojshme pasi që eksperti i mjekësisë T. G. e ka dhënë mendimin e tij mbi lëndimet të cilat i ka pësuar **A. G.1** kur është goditur nga vetura si dhe mundësia e tij për të lëvizur. Përveç kësaj, raporti mjekësor i përgatitur nga doktori Xh. L., dokumentacioni mjekësor i pranuar nga Qendra e Paraburgimit në Dubravë dhe Qendra e Paraburgimit në Gjilan dhe raporti mjekësor i datës 12 maj 2016 janë pothuajse pjesë e shkresave të lëndës dhe janë pranuar dhe sjellë si prova në këtë procedurë.

E. LIGJI I ZBATUESHËM

49. Sipas nenit 544 të Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP) i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013⁵, rigjykimi është kryer sipas dispozitave të Kodit të vjetër të procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

⁵ KODI I PROCEDURES PENALE Nr. 04/L-123;

F. GJETJET FAKTIKE DHE ANALIZAT E PROVAVE

F.1 Akuzat kundre të pandehurit A. G.1

Akuza 1 – Vrasje e rëndë e M. I. dhe Akuza 2 – Tentim vrasje e rëndë e B. I.

50. Me ndryshimin e aktakuzës së datës 13 qershor 2016, nën Akuzën 1 i pandehuri **A. G.1** është akuzuar për Vrasje të rëndë të M. I., në kundërshtim me nenin 147 paragrafi (1), pika 4) e KPK dhe nën Akuzën 2 i pandehuri **A. G.1** është akuzuar për Tentim vrasje të rëndë të I. I., në kundërshtim me nenin 147 paragrafi (1), pika 4) e KPK.
51. Sipas nenit 387, paragrafi (2) i KPPK, trupi gjykues e ka vlerësuar me vëmendje çdo provë , e cila është administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor , veçmas dhe në lidhje me pjesët tjera të provave dhe në bazë të një vlerësimi të tillë, ka arrite në përfundimin se cilat fakte konsiderohen si të dëshmuara dhe cilat nuk janë dëshmuar.

Ekzistimi i çështjes së moralit në mes të familjeve I. dhe G. si motiv për kryerjen e veprës penale

52. Trupi gjykues gjen se motivi për këtë vepër penale ishte një çështje e moralit në mes të familjes I. dhe familjes G. për shkak të dyshimeve se M. G., djali i R. G. dhe vëllai i S. G., kanë pasur marrëdhënie seksuale me të ndjerën M. I. ndërsa bashkëshorti i saj B. I. ishte në burg, gjë që ka rezultuar me një kërkesë të bërë nga familja I. që familja G. të lëshojnë shtëpinë e tyre. Familjet I. dhe G. ishin fqinjë.⁶
50. Ky fakt është përcaktuar në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, siç janë R. G., M. G., F. I., J. S., S. M. të cilët kanë vepruar si ndërmjetësues dhe djali i tij V. M..
51. Dëshmitari R. G. është babai i të pandehurit S. G.. Ai e ka dhënë deklaratën e tij para Gjykatës më 18 tetor 2011 dhe 21 maj 2013. Sipas nenit 368, paragrafi (1) nën-paragrafi

⁶ Shiko gjithashtu aktvendimin PAKR. Nr. 962/2012, faqe 7, version në anglisht.

1 i KPPK, R. G. nuk e ka dhënë deklaratën e tij para Gjykatës në shqyrtimin gjyqësor P 68/2014⁷ si dhe në shqyrtimin gjyqësor të tij⁸ pasi që palët janë pajtuar që t'i konsiderojnë deklaratat e tyre të mëhershme si të lexuara.

52. Kur jnaë f/dëgjuar si dëshmitarë, R. G. më 18 tetor 2011 ka deklaruar⁹ se ai banonte në Mitrovicë në rrugën _____ dhe se para dhjetorit 2009 ai ka qenë fqinj me familjen I. për 12 vjet. Ai kishte deklaruar se para incidentit të datës 4 dhjetor 2009, ishte pas Bajramit kur B. I. kishte ardhur në shtëpinë e tij dhe kishte kërkuar nga R. për të shkuar me B. në shtëpinë e tij [të B.] në _____, një lagje e Mitrovicës. Në shtëpinë e B., B. e kishte nxjerrë armën e tij dhe e kishte vendosur në tavolinë dhe i kishte R. se djali i R., M. kishte një lidhje me bashkëshorten e B., M.. B. i kishte kërkuar R. që t'ia paguante 25.000 euro, nëse ai [R.] dëshiron që të pajtohet me B. dhe nëse ai nuk paguan atëherë R. duhet të largohet nga shtëpia e tij. R. e ka mohuar se djali i tij M. ka pasur lidhje me M., është ngritë dhe ka dalë nga shtëpia. Kur është kthyer R. në shtëpi, ai ek a thirre djalin e tij S.G. dhe i ka thënë atij çdo gjë që ka ndodhur deri më tani. Pastaj R. së bashku me S. kanë shkuar te J. S., babai i M.. Ata të gjithë janë takuar në shtëpinë e R., S. ka shkuar dhe e ka sjellë gjithashtu B. dhe pastaj R. para tyre, ka përsëritur se ai [R.] nuk i ka pasur borxh asgjë B.. S. i ka dërguar B. dhe J. S. prapa te shtëpia e B. dhe pas kësaj R., së bashku me djemtë e tij S., M. dhe J. kanë shkuar dhe e kanë lajmëruar rastin në polici. Pas tri ditësh, policia e ka informuar R. se Prokurori ka thënë dhe ka sugjeruar se R. duhet ta dërgon një ndërmjetësues në familjen I. në mënyrë që me e zgjidhur këtë rast. Atë natë R. kishte shkuar dhe e ka marrë S. M. dhe djalin e tij V. M., të cilët janë të lidhur nga martesat me familjen I. dhe kanë kërkuar nga ata që të shkojnë në shtëpinë e I. I. dhe B. I.. R. e ka pyetur S.M. me i thënë I. se [R.] nuk i ka borxh familjes I. asgjë dhe se ai [R.] është i gatshëm me u betuar në këtë. I. është përgjigje se R. duhet të betohet para 24 anëtarëve të parisë së fshatit; R. është pajtuar dhe i ka thënë I. se ai [I.] mund t'i përzgjedh njerëzit. Dy apo tri ditë ma vonë I. i kishte thënë S.M. se ata [I.] kanë dëshirë të vijnë te R. dhe të mblidhen së bashku. R. e ka thirre S. në mënyrë që t'i bashkëngjitet atyre pasi që ai [R.] nuk dëgjon mirë. S.M. kishte ardhur në shtëpinë e R. por t I. nuk kishin ardhur. I. e kanë thirre S.M. dhe i kanë thënë atij se ata [I.] nuk do të vinin dhe se

⁷ Lënda P 199/2015, procesverbali i datës 5 shkurt 2015.

⁸ Lënda P 199/2015, procesverbali i datës 23 mars 2016, faqe 6.

⁹ Lënda P 22/2010, faqet 12 dhe 13.

do ta presin S.M. në shtëpi të tij. I., B. dhe Xh. i kishin thënë S.M. se ata nuk dëshirojnë që R. të betohet para parisë së fshatit, dhe i kishin dhënë ultimatum R. që me liruar shtëpinë ditën e nesërme; dhe në rast se R. nuk ikë, I., B. dhe Xh. do të vinin dhe do ta vrisnin R.. R. gjithashtu deklaroi se kjo ka ndodhur natën para se me ndodhë incidenti dhe se S. kishte dëgjuar këto fjalë.

53. Më 21 maj 2013, R. G. përsërit¹⁰ atë që e kishte thënë ma herët dhe gjithashtu deklaroi se në fillimi kishte qenë J. S., babai i M., i cili kishte ardhur tek shtëpia e R. para festave dhe kishte pyetur se a ishte M. më shtëpi. Kur M. iu kishte bashkangjitur atyre, J. S. kishte thënë se ata [I.] janë duke e rrahur vajzën e tij [M.] pasi që ata [I.] pohojnë se M. është në lidhje me M., djalin e R.. R. iu kishte betuar J. se kjo nuk është e vërtetë dhe gjithashtu M. ishte betuar se ai as që e njeh atë grua [M.]. Pas dy deri tri ditësh më vonë, R. ishte takuar me I. dhe e kishte pyetur atë se përse ai [I.] i kishte dërguar këta persona [J.] në shtëpi të R. dhe i cili i kishte thënë I. gjëra të tilla. Kur I. ishte përgjigjur kishte qenë Xh., R. e kishte kapur I. për krahu dhe e kishte dërguar në shtëpinë e tij [I.] në mënyrë që me biseduar me Xh.. Xh. ishte duke fjetur ; I. kishte thënë se ata do ta presin atë për me u zgjuar kështu që R. kishte shkuar në shtëpi. Kur Xh. u zgjua, ata [I.] e kishin thirrë R., R. kishte shkuar në oborrin e I., ku I. e kishte ndalur R. dhe i kishte thënë atij se Xh. kishte refuzuar me biseduar me R.. R. kishte vazhduar rrugës së tij deri në dyqan dhe në atë çast B. dhe Xh. kishin ardhur me veturë dhe e kishin ndalur R. duke thënë: “Dajë, djali yt M. ka hyrë në terrenin tonë.” dhe “...M. me sa duket ka një lidhje me bashkëshorten B.” dhe ata kishin thënë po ashtu “por ne e kemi një dëshmitar .” Kur R. i kishte pyetur ata me ia sjelle dëshmitarin, Xh. kishte thënë: “E di këtë; e kam parë këtë vet ” dhe “E kam parë prej dritares sime dhe e kam vërejtë kur ajo [M.] ishte duke ecur, ai [M.] e përcjelltë atë me sytë e tij.”

54. Dëshmitarja M. G. i kishte dhënë deklaratat më 19 tetor 2011 dhe 23 maj 2013. Sipas nenit 368, paragrafi (1) nën-paragrafi 1 i KPPK, M. G. e kishte dhënë deklaratën e saj para trupit gjykues në këtë shqyrtim gjyqësor¹¹ pasi që palët ishin pajtuar që të konsiderojnë si të lexuara deklaratat e saja të mëhershme.

¹⁰ Lënda P 887/2013, faqet 8, 9 dhe 10.

¹¹ Lënda P 199/2015, procesverbali i datës 23 mars 2016, faqe 6.

55. Më 19 tetor 2011, M. G. e kishte përshkruar¹² një incident kur B. I. kishte hyrë në oborrin e G. Ajo kishte deklaruar se ishte ora 7:00 e mëngjesit, porta kishte qenë e mbyllur; B. e kishte kapërcyer murin dhe kishte hyrë në dhomën e pritjes përmes derës së përparme. M. kishte dëshmuar se B. i kishte thënë R.: “Vishu dhe eja në shtëpinë time në _____.” M. nuk e dinte se për çfarë arsye ; dhe përse B. i kishte thënë R. me shkuar me atë; ata kishin hyrë në veturë dhe kishin shkuar në _____. Në pyetjen se sa kishte qëndruar R. në shtëpinë e B. në _____, M. G. kishte theksuar se B. e kishte vendosur pistoletën në tavolinë dhe e kishte pyetur R. me i paguar 25.000 euro; dhe kur R. ishte përgjigjur se ai nuk kishte pasur para dhe se nuk ka arsye që ai të paguan, B. i kishte thënë R. se ai do ta largonte atë nga shtëpia po që se nuk paguan. M. G. gjithashtu kishte theksuar se R. e kishte thirrë S.G. kur ai [R.] ishte kthyer në shtëpi. Ata [R. dhe S.] kishin shkuar me parë J.. M. gjithashtu e kishte përshkruar se si pas këtij rasti R. e kishte lajmëruar rastin në polici ; ajo që iu kishte përgjigje polici atij dhe si R. e kishte dërguar S.M. te I.. Kur është pyetur, M. G. ishte përgjigje se ajo nuk e kishte përcjellë R. kur B. e kishte marrë atë në shtëpinë e tij në _____.
56. Dëshmitarja F. I. e kishte dhënë deklaratën më 17 tetor 2011, 20 maj 2013 dhe 14 janari 2015. Në bazë të nenit 368, paragrafi (1) nën-paragrafi 1 i KPPK, F. I. nuk e kishte dhënë deklaratën para trupit gjykues në këtë shqyrtim gjyqësor¹³ pasi që palët janë pajtuar me i konsideruar si të lexuara deklaratat e saja të mëhershme .
57. Më 17 tetor 2011, F. I. kishte deklaruar¹⁴ se familja e saj ishte kthyer nga Gjermania pas luftës dhe se ata kishin qenë fqinj me familjen G.. Në atë kohë ajo jetonte së bashku me bashkëshortin e saj I. I., djemtë e saj Xh. I. dhe B. I. dhe bashkëshorten e tij M. I.. Pasi që ishte liruar B. nga burgu, F. I. kishte kuptuar për dyshimet se M. kishte “punë” me djalin e R., M. G.. Dëshmitari kishte theksuar se familja I. nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim dhe se M. kishte shkuar te babi i saj J. S. dhe kishte biseduar me atë. Pastaj, siç kishte deklaruar dëshmitari, R. G. kishte ardhur vetë për të parën herë; më vonë e kishte dërguar S. M.. Asaj i kujtohej se S. M. kishte thënë “R. G. më ka dërguar për këtë çështje, nuk e di se çfarë te them, pasi që ajo [M.] ka pranuar sipas me fjalët e saja .” dhe “kujt do t’i besojmë tani ?” Por F. I. nuk ishte prezentë në ato çaste; vetëm B.,

¹² Lënda P 22/10, faqe 15.

¹³ Lënda P 199/2015, Procesverbali i datës 23 mars 2016, faqe 6.

¹⁴ Lënda P 22/2010, faqet 10, 11, 12, 13 dhe 14.

bashkëshortja e tij M. dhe S.M. kishin qëndruar aty. Ajo kishte theksuar se kjo ka ndodhur pas Bajramit të vitit 2009. F.I. gjithashtu nuk kishte dëgjuar kur I. I. i kishte thënë familjes G. se ata duhet ta lëshojnë shtëpinë e tyre; ajo kishte deklaruar se bashkëshorti i saj nuk do të kishte thënë një gjë të tillë. Dëshmitarja gjithashtu nuk dinte asgjë në lidhje me atë se familja I. do të kërkonte ndonjë kompensim nga familja G.; por F. kishte theksuar “nëse njerëzit janë të këqij, kjo është çfarë bëjnë ata.”

58. Më 20 maj 2013, dëshmitarja F. I. kishte folur¹⁵ rreth problemeve të saja me djalin e saj, B. i cili i kishte pasur me M.; se si M. ishte kthyer në shtëpinë e babait të saj për 8 muaj para se me u kthyer përsëri në shtëpinë e I.. Kur janë shpërndarë thashethemet se M. kishte një marrëdhënie me M.G., i ndjeri I. i kishte sjellë M. dhe B. në shtëpinë e familjes në fshatin _____, ku ata kishin qëndruar për dy muaj. Dëshmitarja po ashtu kishte deklaruar se kishte pasur çështje të pazgjidhura në mes të R. G. dhe bashkëshortit të saj, i ndjeri I. I., kur R. kishte kërkuar një copë tokë nga I. në mënyrë që me e lehtësuar kalimin pasi që kishte pasur vetëm një rrugë shumë të ngushtë e cila çonte në shtëpinë e G..
59. Dëshmitari J. S. i kishte dhënë deklaratat më 17 tetor 2011, 20 maj 2013 dhe 5 shkurt 2015. Në bazë të nenit 368, paragrafit (1) nën paragrafit 1 të KPPK, J. S. nuk e kishte dhënë deklaratën para trupit gjykues në këtë shqyrtim gjyqësor¹⁶ pasi që palët ishin pajtuar që deklaratat e mëhershme të konsideroheshin si të lexuara.
60. Më 17 tetor 2011, J. S. deklaroi¹⁷ se kishte qenë Xh., vëllai i B., i cili e kishte akuzuar të ndjerën M. që ka pasur marrëdhënie seksuale me M. G. , ndërsa B. kishte qenë në burg. Dëshmitari e kishte përshkruar rastin, kur B. dhe vëllai i tij e kishin dërguar me taksì të ndjerën M. në shtëpinë e J. dhe M. i kishte thënë J. ditën e nesërme se ata [B. dhe vëllai i tij] e kishin thirrë J. “në lidhje me diçka.” Kështu që, J. kishte shkuar me M. në shtëpinë e I. dhe aty kishin qenë F.I., B. dhe vëllai i tij i cili jeton në Gjermani [L.] dhe më pas kishte ardhur I. i cili iu kishte bashkangjitur atyre. Të gjithë ata i kishin thënë J. se ata nuk kishin parë asgjë në lidhje me M., përveç Xh. i cili kishte thënë “ju nuk e dini se çfarë vajze ju e keni .” Dëshmitari po ashtu deklaroi se dy ditë para Bajramit të viti 2009, ai [J.] kishte shkuar në shtëpinë e R. dhe i kishte thënë R. “D. [që do të thotë R.]

¹⁵ Lënda P 887/2013, faqet 22 – 31.

¹⁶ Lënda P 199/2015, procesverbali i dates 23 mars 2016, faqe 6.

¹⁷ Case P 22/2010, pages 20, 22, 23, 24, 25.

më ka thënë I. se vajza ime [M.] ka pasur një marrëdhënie me djalin tënd [M.];” dhe kur e ka dëgjuar këtë, R. ishte shokuar dhe ishte përgjigjur “djali im është i sëmure.” J. i kishte kërkuar R. me shkuar te I. dhe me e zgjidhur këtë çështje. Tre ditë më vonë, kur J. kishte shkuar në _____, dhe kishte gjetur se R. nuk kishte shkuar te I., J. ishte kthyer te R. dhe i kishte thënë atij me shkuar te I. dhe me e sqaruar çështjen pasi që kjo ishte një çështje urgjente. Të hënën, kur kishte përfunduar Bajrami, R. kishte ardhur në shtëpinë e J. dhe ata të gjithë kishin shkuar në shtëpinë e B.. Me këtë rast, M. ia kishte konfirmuar atij se kishte pasur një aferë M. G., por J. kishte thënë se ajo po gënjen pasi që ajo ishte rrahur dhe kërcënuar nga I.

61. Më 20 maj 2013, J. S. konfirmoi¹⁸ se kishte qenë dy here në shtëpinë e R. dhe se një herë që e kishte vizituar familjen G., aty ishin 12 anëtarë të familjes; dhe se gjithashtu ishte i pranishëm edhe B.. Dëshmitari deklaroi se 12 personat ishin duke diskutuar nëse M. kishte pasur lidhje me njërin nga familja G. dhe si të zgjidhej kjo. Mes tyre, J. e njohu vetëm njërin (R.) dhe birin e tij M..
62. Më 5 shkurt 2015, dëshmitari deklaroi¹⁹ se kjo ngjarje kur 12 persona ishin në shtëpinë R. kishte ndodhur një muaj para ditës kur ndodhi vrasja.
63. Dëshmitari S. M. i dha deklaratat më 19 tetor 2011, 23 maj 2013 dhe 5 shkurt 2015. Në bazë të nenit 368, paragrafi (1) nënparagrafi 1 i KPPK, S. M. nuk e ka dhënë deklaratën para trupit gjykues në këtë shqyrtim gjyqësor²⁰ pasi që palët u patjuan t’i konsideronin si të lexuara deklarata e tij të mëparshme.
64. Më 19 tetor 2011, S. M. deklaroi²¹ se R. G. erdhi në shtëpinë e tij dhe kërkoi që ai të bëhej ndërmjetësues mes dy familjeve. Pas kërkesës së R. S. shkoi në shtëpinë e I. dhe bisedoi me I.. Ata ishin gati të gjenin zgjidhjen që familja G. të largohej nga shtëpia e tyre. Dëshmitari pastaj shkoi te R., i tregoi për këtë kërkesë dhe se R. është përgjigjur: „Nëse ka nevojë, do të largohem nga shtëpia, ngase nuk dua probleme mes dy palëve. Ai (I.) mund t’i zgjedhë tre persona për ta vlerësuar vlerën e shtëpisë dhe lokacionin e shtëpisë. I. mund të m’i jep (duke menduar R.) paratë dhe unë do të shkoj.” S.M. deklaroi se I. nuk e pranoi këtë; S.M. shkoi përsëri te I. dhe tentoi që ta bindë: “le të betohet

¹⁸ Lënda P 887/2013, faqe 34, 35, 39.

¹⁹ Lënda P 68/2014, faqe 5.

²⁰ Lënda P 199/2015, Procesverbal i datës 23 mars 2016, faqe 6.

²¹ Lënda P 22/2010, faqe 3, 4.

bashkë me 24 pleq që mençur se nuk ka hile në këtë.” Pasi që R. u pajtua, ata e caktuan një datë për të shkuar në xhami dhe për t’u betuar atje. Por edhe kjo dështoi pasi që I. përsëri e refuzoi propozimin. S.M. shkoi te R. dhe e informoi se çka kishte thënë I. dhe u tha të dy palëve se tash e tutje të bëjnë si dinë vet. Dëshmitari tha se derisa e vizitoi I. I. pati kërcënime të bëra nga I. dhe anëtarët e tjerë të familjes ndaj R. G.. Dëshmitari deklaroi se i tërë procesi zgjati një javë dhe se do të ketë qenë pas Bajramit të vitit 2009.²² Dhe dëshmitari gjithashtu deklaroi se familja I. kërkoi nga G. t’i paguante 25.000 euro në praninë e tij (S.M.).²³

65. Më 23 maj 2013, S. M. shtoi²⁴ se ai ishte bashkë me birin e tij V. në shtëpinë e R.; dhe se çdo herë kur R. e kontaktonte, R. e pyeste atë personalisht, jo përmes telefonit dhe se R. gjithmonë ka qenë i shoqëruar me një apo dy anëtarë të familjes.
66. Dëshmitari V. M. e dha deklaratën e tij më 19 tetor 2011. Në bazë të nenit 368, paragrafi (1) nënparagrafi 1 i KPPK, V. M. nuk e dha deklaratën para trupit gjykues në këtë shqyrtim gjyqësor²⁵ pasi që palët u pajtuan ta konsideronin si të lexuar deklaratën e tij të mëparshme.
67. V. M. konfirmoi²⁶ se ai shkoi vetëm një herë me babanë e tij S.M. në shtëpinë e I. ku gjithashtu Xh., B., gruaja e tij (M.) dhe nëna e tij (F.) ishin të pranishëm; ai e dëgjoji vetëm një pjesë të bisedës ndërmjet tyre dhe deklaroi se më së shumti flisnin I. dhe Xh.. Dëshmitarit i kujtohet se ata kanë thënë që familja G. do të duhej të largohej nga shtëpia në mënyrë që kjo çështje të rregullohej.
68. Më 4 mars 2015, i pandehuri **A. G.1** deklaroi²⁷ se atë ditë kritike, më 4 dhjetor 2009, ai e pati një diskutim me R. G. (i cili është axha i tij) për rastin se çfarë kishte ndodhur mes fqinjëve dhe çarë mosmarrëveshje kishin pasur ata. Gjatë diskutimit, R. e përmendi se si ai (R.) ka dërguar njerëz te I. i ndjerë por I. nuk është përgjigjur në përpjekjet e atilla për marrëveshje. 20 apo 30 minuta më vonë, kur **S.** dhe **A.2** arritën, **S.** bisedoi me babanë e tij (R.) për mosmarrëveshjen që e kishin pasur me I. e ndjerë, si ta zgjidhnin këtë dhe si ta

²² Lënda P 22/2010, faqe 6.

²³ Lënda P 22/2010, faqe 8 dhe 9.

²⁴ Lënda P 887/2013, faqe 29 dhe 30.

²⁵ Lënda P 199/2015, Procesverbal i datës 23 mars 2016, faqe 6.

²⁶ Lënda P 22/2010, faqe 11, 12.

²⁷ Lënda P 887/2013, faqe 11.

dërgonin dikë atë për të parandaluar atë që tashmë kishte ndodhur. I pandehuri deklaroi²⁸ se ai (i pandehuri) gjithashtu i propozoi R. ta dërgonte personin e njëjtë përsëri ose dikë tjetër për ta rregulluar këtë çështje.

69. Më 13 qershor 2016, i pandehuri gjithashtu deklaroi²⁹ se ishte Bajram kur ai shkoi për ta vizituar R. G.; pati një diskutim mes R. dhe të tjerëve por ai (i pandehuri) nuk dëgjoi për çka bisedonin ata. Rrugës duke dalë dhe kur iu afrua derës së axhës së tij, J S. filloi t'i tregonte për çështjen; J. fliste për M., dhe se familja I. ishte duke e akuzuar M. G. që kishte pasur marrëdhënie intime me M.. Por ai (i pandehuri) i tha J. se duhej të shkonte me e falë xhumanë. I pandehuri gjithashtu deklaroi se nuk dëshironte të implikohej në çështjet e tyre dhe e vazhdoi rrugën dhe shkoi për t'u falur; dhe pastaj ai (i pandehuri) kuptoi se diçka nuk ishte në rregull. Ditën kritike, para se të ndodhnin vrasjet, R. G. ishte ai i cili e filloi bisedën me të pandehurin; R. i tha të pandehurit se ai (R.) kishte marrë kërcënime nga I. I.; që ai (R.) duhej të largohej nga shtëpia ose të vritej dhe se R. kërkonte të gjente një rrugëdalje. R. i tha të pandehurit se kishte dërguar njerëz te I. I. por I. i kishte refuzuar të gjitha propozimet. I pandehuri deklaroi se R. i kërkoi atij këshillë pasi që ai (i pandehuri) shkon në xhami dhe e njeh imamin. I pandehuri e këshilloi R. t'i dërgonte njerëzit te I. të cilët R. i kishte dërguar më parë. Gjatë kësaj bisedë, S. dhe A.2 arritën në shtëpinë e R.. I pandehuri tha se biseda mes tij dhe R. ishte pothuaj në fund dhe pastaj S. filloi të fliste me R.. Ata thanë se “nuk duhet të pyesim me nxitim dhe të mos ngutemi, mos ta tensionojmë situatën;” dhe se A. G.2 tha “duhet t'i dërgojmë të njëjtit njerëz të cilët i dërguam më parë.” Kur u pyet, i pandehuri deklaroi se ai është i bindur që ata (S. dhe A.2) e dinin që kishte një mosmarrëveshje mes familjeve G. dhe I. pasi që ata erdhën (në shtëpinë e R.) atë ditë me një qëllim të caktuar. I pandehuri tha se “qëllimi do të ishte se ndoshta ata (S. dhe A.2) ishin informuar nga babai i tyre (R.) për të ardhur atje, dhe për çka kishin ardhur atje?”

70. Në bazë të dëshmive të lartpërmendura, trupi gjykes e konstatoi të pakontestueshëm faktin se familjet G. dhe I. ishin grindur lidhur me pretendimet për marrëdhënie seksuale mes M. I. dhe M. G. dhe se e tërë kjo filloi para ditës kur ndodhën vrasjet. Kishte disa mospërputhje në dëshmitë e dëshmitarëve lidhur me atë se kush shkoi i pari te R. dhe i

²⁸ Lënda P 887/2013, faqe 12.

²⁹ Lënda P 199/2015, faqe 12, 13, 18, 19, 20.

tregoi për ato pretendimet. R. dhe M. G. deklaruan se ai ishte B.; F. I. tha se familja I. së pari bisedoi me J. S. dhe pastaj ishte R. i cili erdhi në shtëpinë e I. dhe pas kësaj ai (R.) e dërgoi S. M. te I. J. S. tha se së pari kishte biseduar me familjen I. dhe pastaj kishte shkuar te R. dhe kishte kërkuar nga ai (R.) të shkonte te I. dhe ta zgjidhte çështjen.

71. Në bazë të dëshmive, trupi gjykues konstatoi se grindja mes dy familjeve ekzistonte dhe se kishte tentime për ta zgjidhur çështjen. Gjithashtu mund të konstatohet se familja I. fillimisht kërkoi nga R. G. të zhvendosej. Më vonë, I. I. kërkoi nga R. G. të betohej (bënte be) para 12 (sipas S.M. 24) pleqve.
72. Trupi gjykues nuk e konstatoi të provuar se familja I. kërkoi nga R. të paguante 25.000 euro dhe nëse nuk do të paguanin, ata (G.) të largohen nga shtëpia. Ishin R. dhe M. G. të cilët thanë se B. kërkoi të paguhen 25.000 euro; edhe pse M. nuk ishte e pranishme kur B. dhe R. biseduan për këtë.
73. Trupi gjykues konstatoi se deklarata e S. M. ishte më e besueshmja. Ai veproi si ndërmjetës mes dy familjeve. S.M. deklaroi se ishte R. ai i cili kërkoi që ai të shkonte te I. dhe të bisedonte me atë. Kjo provon se fillimisht ka pasur bisedime mes familjeve për atë se si të zgjidhej çështja dhe kur ata (familjet) nuk e gjetën zgjidhjen, S.M. është angazhuar për të ndërmjetësuar mes tyre. Dhe S.M. tha se në praninë e tij familja I. kurrë nuk i ka kërkuar G. të paguanin 25.000 euro. Dhe gjithashtu J. S. i cili ishte gjithashtu i implikuar në bisedë nga fillimi, kurrë nuk e përmendi në deklaratën e tij se një kërkesë e atillë ishte bërë.

Njohuria e A. G. 1 për ekzistimin e çështjes morale mes familjes I. dhe familjes G..

74. Trupi gjykues mendon se i pandehuri **A. G.1** ishte në dijeni për mosmarrëveshjen mes familjeve G. dhe I..
75. I pandehuri tha ³⁰ se ia kuptoi që diçka nuk ishte në rregull kur e vizitoi R. për Bajram dhe e takoi J. S.; dhe më vonë, më 4 dhjetor 2009, para incidentit, R. G. i tregoi atij për mosmarrëveshjen dhe i kërkoi këshillë.
76. Më 18 tetor 2011, R. G. deklaroi³¹ se deri ditën kritike, 4 dhjetor 2009, as A. G.2 dhe as **A. G.1** nuk dinin asgjë për atë se çka kishte ndodhur më parë.

³⁰ Lënda P 199/2015, faqe 12, 13, 18, 19.

³¹ Lënda P 22/2010, faqe 12 dhe 22.

77. M. G. më 23 maj 2013 konfirmoi ³² se **A. G.1** erdhi në shtëpinë e tyre (të R.) shumë herë për ta marrë R. për të shkuar në xhami.
78. Më 2 nëntor 2011 **S. G.** deklaroi ³³ se **A.1**, A.2 dhe babai i tij R. përfshirë edhe **S.** janë e njëjta familje. **S.** konfirmoi se **A.1** dhe A.2 ishin të pranishëm kur familja e R. kishin mysafirë, nipat, axhët, miqtë, më 30 nëntor 2009, tre ditë pas Bajramit të vogël dhe se ai (**S.**) shkoi për t'i marrë B. dhe J.S.. Dhoma ishte plot me njerëz, të afërm dhe shpjegimi i **S.** ishte se “nuk kishte asgjë të keqe aty, vetëm një bisedë shoqërore” dhe jo përpjeke për ta zgjidhur çështjen mes dy familjeve.
79. Pasi që i pandehuri **A. G.1**, sipas deklaratës së tij, e takoi R. së paku dy deri tre herë në muaj; ai ishte nipi i R. dhe si i tillë pjesë e familjes G.; si dhe fakti që të dy familjet ishin të gatshme të diskutonin për çështjen e marrëdhënies intime të pretenduar mes M. dhe M.G., para pleqve, Trupit Gjykses i duket e vështirë që i pandehuri **A. G.1** më 4 dhjetor 2009 kuptoi për mosmarrëveshjen mes dy familjeve. Trupi gjykses mendon se **A.1** duhet të jetë në dijeni për çështjen mes familjeve **G.** dhe **I.** së paku më 30 nëntor 2009, tre ditë pas Bajramit të vogël ose madje edhe më parë.

Prania e personave në shtëpinë e R. G. dhe të I. I. më 4 dhjetor 2009 para ndodhjes së vrasjes

80. Trupi gjykses mendon se është e padiskutueshme se më 4 dhjetor 2009, A. G.2 dhe **S. G.** erdhën në shtëpinë e R. G. ku **A. G.1** tashmë ishte i pranishëm.
81. Më 18 tetor 2011, dëshmitari R. G. deklaroi ³⁴ se **S. G.** dhe A. G.2 erdhën në shtëpinë e këtij të shoqëruar nga **A. G.1**, se të gjithë ata erdhën bashkë. Kjo është në kundërshtim me deklaratën e R. të datës 21 maj 2013 dhe nga ato çka deklaruan dëshmitarët M. G., A. G.2, **S. G.** dhe **A. G.1**.
82. Më 21 maj 2013, R. G. deklaroi ³⁵ se ishte e premtë dhe se zakonisht **A.1** vjen të premtëve në xhami në Zhabar. Dhe pastaj R. tha se nuk ishte kohë e gjatë, një gjysmë ore kur **S.** dhe A.2 arritën dhe thanë (**A.1**):”ku po fshiheni, ishim në shtëpinë tuaj dhe nuk ishit atje, nuk mundëm t’ju gjenim atje.”

³² Lënda P 887/2013, faqe 25.

³³ Lënda P 22/2010, faqe 8.

³⁴ Lënda P 22/2010, faqe 13 dhe 28.

³⁵ Lënda P 887/2013, faqe 10.

83. M. G. më 23 maj 2013 deklaroi ³⁶ se S. erdhi bashkë me A. G.2 në shtëpinë e R. një apo dy orë pas **A.1**.
84. **S. G.** më 2 nëntor 2011³⁷ dhe më 28 maj 2013 ³⁸ deklaroi se ai e kishte kërkuar **A.1** në shtëpinë e **A.1** bashkë me A.2. Kur gruaja e **A.1** i tregoi se ku ishte ai (**A.1**), S. erdhi bashkë me A. G.2 në shtëpinë e R.. Kur ata (S. dhe A.2) arritën në shtëpinë e R., **A.1** tashmë kishte qenë atje.
85. **A. G.1** më 4 mars 2013 deklaroi ³⁹ se ai e kishte pasur një diskutim atë ditën kritike me axhën e tij R. dhe se nuk kishte kaluar kohë e gjatë; ndoshta 20 apo 30 minuta më vonë kur S. dhe A.2 arritën në shtëpinë e R..
86. Lidhur me familjen I., F. I. më 17 tetor 2011 deklaroi ⁴⁰ se ajo ishte brenda në shtëpi atë ditën kritike, bashkë me burrin e saj I. I., dhe birin e saj Xh. I., I cili ishte duke fjetur. Atë ditë gjithashtu biri i saj B., bashkë me gruan e tij M. erdhën për t'i marrë disa dokumente që i nevojiteshin atij për shërbimin social.
87. B. I. më 1 nëntor 2011 deklaroi ⁴¹ se atë ditë ai ngrëni mëngjes me gruan e tij dhe fëmijët në shtëpinë e tyre në _____; pastaj e mori një taksì dhe shkoi te babai i tij I. I. dhe vëllai i tij për ta marrë automjetin që i nevojitej. Ai e mori automjetin e vëllait të tij, u kthye në shtëpinë e tij në _____; dhe bashkë me gruan e tij M. dhe fëmijët e tyre u kthyen në fshatin e prindërve dhe të vëllait të tij në _____.

Fillimi i grindjes mes anëtarëve të familjeve G. dhe I. më 4 dhjetor 2009 para ndodhjes së vrasjes

88. Në bazë të provat të paraqitura, trupi gjykues konstatoi se ditën kritike, pas orës 12:00, përjashta shtëpisë së R. G., në një rrugicë të vogël që kalon para shtëpisë së G. dhe që çon në kthesën majtas në shtëpinë I., **A. G.1**, **S. G.**, A. G.2 dhe R. G. e takuan fillimisht I. I.. Pak më vonë B. I. bashkë me gruan e tij M. erdhën me automjet BMW dhe u ndalën pranë

³⁶ Lënda P 887/2013, faqe 23.

³⁷ Lënda P22/2010, faqe 4.

³⁸ Lënda P 887/2013, faqe 7.

³⁹ Lënda 68/2014, faqe 11.

⁴⁰ Lënda P 22/2010, faqe 14.

⁴¹ Lënda P 22/2010, faqe 10.

tyre. Anëtarët e të dy familjeve filluan të grinden e cila u përshkallëzua në përleshje me grushte mes **S. G.** dhe **B. I.**

89. Dëshmitari **R. G.** më 18 tetor 2011, deklaroi⁴² se **A. G.1** dhe **A. G.2** u desh të shkonin në punë dhe u çuan pasi që autobusi i tyre ishte në ora 12:30 apo 13:00. Edhe **R.** u çua, për t'i përcjellë ata. Kur ai (**R.**) shkoi te dera, e pa **I.** i cili ishte duke i pritur ata. **R.** tha se ai ishte i pari, **S.** ishte pas tij. Sapo doli **S., I.** e kapi **S.** për krahu duke i thënë: "Eja këtu, dua të të them diçka." Derisa ata (**I.** dhe **S.**) ishin duke biseduar, **B.** erdhi me veturën e tij. Kur **B.** erdhi afër **I., M.** doli nga vetura dhe filloi të bërtiste dhe thoshte diçka. **S.** i tha **M.:** "Kthehu brenda në veturë dhe mos bërtit," dhe pastaj **B.** gjithashtu doli nga vetura dhe që të tre ata (**B., M.** dhe **I.**) i kërcyen **S.** në shpinë dhe donin ta godisnin **S.**. Duke e parë këtë, **R.** vrapoi te ata dhe u tha: "Shkoni; çka po tentoni të na bëni?" Bashkimi u kthye brenda në veturë dhe bashkë me **M.** u largua me veturë, derisa **S.** ende ishte duke u kacafytur me **I.** **R.** tha se ai (**R.**) shkoi te **S.** dhe i ra shuplakë tri herë dhe i tha ta lëshonte **I.** **S.** e lëshoi **I.** dhe pastaj **R.** e kapi **I.** dhe i tha të largohej. **R.** tha se **A.1** dhe **A.2** nuk dolën përjashta derës fare. Pastaj **A.2** dhe **S.** shkuan në punë dhe **A.1** gjithashtu shkoi për ta falur xhumanë por vetëm tre apo katër minuta kaluan kur **B. I.** u kthye me veturë.
90. **R. G.** e dha deklaratën e tij gjithashtu më 21 maj 2013. Ai e përsëriti deklaratën e tij të mëparshme duke shtuar⁴³ se **M.** doli nga vetura kur **S.** i tha asaj: "mbylle gojën, kthehu brenda në veturë", dhe pastaj **M.** kërcëu dhe e kapi **S.** në fytyrë dhe ia futi gishtat në sy (**S.**). Pas kësaj gjithashtu edhe **B.** doli nga vetura dhe pastaj që të tre ata (**I., B.** dhe **M.**) kishin hipur mbi **S.**. **I.** e godit **S.** në pjesën e poshtme të nofullës. Së pari, **R.** deklaroi se **A.1** dhe **A.2** nuk lëvizën; ata qëndruan pranë derës anësore. Më pastaj, **R.** deklaroi se **A.1** dhe **A.2** e përcollën atë (**R.**), domethënë ishin pas tij; nuk u larguan nga oborri fare.⁴⁴
91. Dëshmitari **A. G.2** më 5 shkurt 2015 deklaroi⁴⁵ se kur **S.** doli përjashta, ai (**S.**) u konfrontua fizikisht me **B.** dhe **I.**. Pas kësaj, **B.** hyri në veturë dhe u largua dhe nuk zgjati shumë kur ai (**B.**) u kthye.

⁴² Lënda P 22/2010, faqe 12.

⁴³ Lënda P 887/2013, faqe 10.

⁴⁴ Lënda P 887/2013, faqe 17.

⁴⁵ Lënda P 68/2014, faqe 12.

92. B. I. e dha deklaratën e parë më 1 nëntor 2011. Ai deklaroi ⁴⁶ se pasi që doli me veturë nga porta, ai filloi të shkonte me veturë nëpër rrugë dhe mu kur ktheu në kthesë, ai e pa **S.** i cili u paraqit i pari, i përcjellë nga **A.2** dhe **A.1** të cilët dolën të fundit, dhe pastaj së shpejti doli **R.** Ata filluan të vinin në drejtim të automjetit të tij (**B.**). **B.** e ndali veturën; **S.** eci në drejtim të derës së automjetit, e hapi derën dhe i tha **B.**: “mos lëviz ose përndryshe do ta qi nënën dhe t’i derdhi trutë në tokë”. **B.** u përgjigj: “gjuaj se nuk kam frikë fare.” Pastaj **S.** e grushtoi atë (**B.**) në hundë. Në atë çast gjithashtu erdhi edhe **A.2** dhe ata e morën **B.** dhe e mbështetën në mur. Kur **I. I.** erdhi dhe e tërhoqi njërin prej tyre nga **B.**, **S.** u kthye dhe e goditi **I.** me kondakun e revoles së tij.
93. Më 23 mars 2016, **B. I.** e dha deklaratën si dëshmitar dhe e përsëriti ⁴⁷ se ai ishte në veturë bashkë me gruan e tij (**M.**) kur **S.** erdhi nga anash te dera e tij dhe ia drejtoi revolen atij (**B.**). Pastaj grindja filloi mes tij dhe **A.1**, **A.2** dhe **S.**; **R. G.** ishte aty gjithashtu; dhe ndërkohë **I. I.** erdhi. Ky incident ndodhi para portës së fqinjit **M. I.** **B.** tha se **M.** doli nga vetura gjithashtu dhe pastaj ndodhi përleshja me grushte mes **S.** dhe **B.** **B.** gjithashtu tha se që të tre ata (**S.**, **A.1** dhe **A.2**) pos **R. G.**, kishin armë në duar.
94. I pandehuri **A. G.1** më 4 mars 2015 deklaroi ⁴⁸ se ata (**A.1**, **A.2**, **S.** dhe **R.**) ishin duke dalë; dhe pasi që është rrugicë shumë e ngushtë ata ecën njëri pas tjetrit, **R.** ishte i pari, pastaj **S.**, **A.2** dhe ai (**A.1**); **A.3**, biri i **R.** ishte gjithashtu aty. Ata ishin në rrugën përballë portës së **R.** kur e takuan **I. S.** iu drejtua **I.** me fjalët “Dërguam njerëz për të bërë marrëveshje por ju nuk u përgjigjët fare sa i përket marrëveshjes.” Gjatë kësaj bisede **B.** erdhi me veturën e tij; ai e ndali veturën pakëz para portës së **R.**, doli nga vetura, edhe **M.** gjithashtu, dhe pastaj filloi grindja dhe kacafytja dhe filluan ta godasin njëri-tjetrin. Njëkohësisht, i pandehuri tha se nuk i ka parë duke e goditur njëri-tjetrit; por ai (**A.1**) e kapi **S.** për ta parandaluar kacafytjen mes tyre (**B.** dhe **S.**). **B.** dhe **M.** hyrën në veturë dhe u larguan në drejtim të qendrës së Mitrovicës.
95. **S. G.** e dha deklaratën e parë më 2 nëntor 2011. Ai deklaroi ⁴⁹ se ata (**S.**, **A.2** dhe **A.1**) ishin duke u larguar nga shtëpia e **R.** dhe u përballën me **I. I.** i cili i tha **R.**, “**R.**, a nuk të

⁴⁶ Lënda P 22/2010, faqe 10.

⁴⁷ Lënda P 199/2015, faqe nga 9 deri 13.

⁴⁸ Lënda P 68/2014, faqe 12.

⁴⁹ Lënda P 22/2010, faqe 10.

kam thënë të largohesh nga shtëpia dhe të mos mbledhësh njerëz këtupari? “ Pas pak B. dhe gruaja e tij M. arritën me veturë dhe që të tre ata (B., M. dhe I.) e sulmuan atë (S.). Pastaj B. dhe M. u larguan nga vendngjarja; kacafytja u ndërpre dhe biseduan në mënyrë shoqërore.

96. S.G. e dha deklaratën e tij gjithashtu më 28 maj 2013 dhe ai deklaroi ⁵⁰ se në fakt familja I. ia zunë pritën atij (S.) dhe të tjerëve (A.2, A.1, R.) kur ishin duke u larguar nga shtëpia e R.. Me fjalën “pritë”, i pandehuri sqaroi se ata (I.) deshën ta sulmonin atë.
97. Dëshmitaret M. G. dhe F. I. qëndruan në shtëpitë e tyre dhe nuk ishin dëshmitarë të ngjarjeve përjashta shtëpive.
98. Nuk ishte kontestuese se B. I. bashkë me M. I. u larguan nga vendi dhe me veturë shkuan në drejtim të Mitrovicës.

Kthimi i B. dhe M. me veturën BMV të kuqe, dhe fillim i të shtënave

99. B. I. më 1 nëntor 2011 deklaroi ⁵¹ se ai u largua nga vendi i grindjes në veturën e tij bashkë me M.. Së pari ai tentoi ta gjejë një numër për ta informuar policinë por nuk mund t'i kujtohej numri, andaj vazhdoi të ngiste veturën në drejtim të stacionit në qendër të Mitrovicës. Kur has në një patrullë policore në stacionin e autobusëve, ai e ndali veturën dhe i tha policisë se tre persona janë duke e rrezikuar jetën e babait të tij (I. I.) me armë në duar. Polici e pyeti “ku” dhe B. u përgjigj “ejani pas meje.” B. nuk mund të vlerësonte sa shpejt e ngiste veturën; vetura e policisë e përcillte atë në një largësi prej 50-60 metrash. B. tha se në një largësi prej 50 metrash nga vendi ku ndodhi grindja, ai e dëgjoi një të shtënë. Në pyetjen specifike kur e kishte dëgjuar të shtënë e parë, B. deklaroi ⁵² se ”ai (B.) ishte paralelisht me kamionin, 20 metra para se të largohej nga rruga e asfaltuar (Rruga e _____) dhe të ngiste veturën në rrugën (_____).

⁵⁰ Lënda P 887/2013, faqe 13.

⁵¹ Lënda P 22/2010, faqe 10.

⁵² Lënda P 22/2010, faqe 14.

100. Kur u mor në pyetje si dëshmitar më 23 mars 2016, B. I. deklaroi ⁵³ përsëri se i kishte dëgjuar të shtënat para se të largohej nga rruga e asfaltuar “ _____ ” dhe ka kthyer në rrugicën ku ishte shtëpia e tij. Por nuk e dinte se kush kishte shtënë me armë.
101. Dëshmitari F. K. i dha deklaratat më 18 tetor 2011, 21 maj 2013, 15 janar 2015 dhe 23 mars 2016.
102. Më 18 tetor dëshmitari F. K. deklaroi ⁵⁴ se ai kishte qenë bashkë me kolegun R. I.; ai ishte duke e dhënë një gjobë dhe duke ia dhënë tiketën një qytetari i cili e kishte bërë një shkelje. Ata ishin kah fundi i procedurës, kur një automjet i kuq i tipit BMV iu afrua, dhe u ndal para tyre në anën e tyre të majtë. Ata (B. dhe M.) iu drejtuan (K. dhe I.) duke u thënë, “Janë disa njerëz duke e vrarë njëri-tjetrin derisa ju po qëndroni këtu” Pastaj ngasësi i BMV-së në mënyrë agresive e ktheu veturën në formën U aty te kryqëzimi, duke kaluar nga ana e majtë në anën tjetër të rrugës dhe vazhdoi të ngiste veturën në drejtim të _____. Ata (F. K. dhe R. I.) filluan ta përcillnin veturën; ajo ishte duke shkuar shumë shpejt dhe tashmë ishte larguar 150 metra, duke shkuar në drejtim të autostradës së _____ në drejtim të fshatit _____. Dëshmitari tha se ata (K. dhe I.) mund ta përcillnin veturën në distancë prej 150-200 metrash dhe gjithmonë mund ta shihnin. Rreth një kilometër nga vendi ku filluan ta përcillnin, e panë veturën të kalonte nga ana e djathtë në atë të majtë, duke hyrë në një rrugë të vogël që ju çon në një rrugë me zhavorr dhe e cila është paksa përpjetë. Kur K. dhe I. tentuan të ndaleshin dhe të dilnin nga vetura, dëshmitari i dëgjoji disa të shtëna. Në pyetjen specifike kur i ka dëgjuar të shtënat, K. deklaroi ⁵⁵ se në atë çast kur personi (A.) është goditur me veturë, e shtëna është dëgjuar; dëshmitari e pa një person duke rënë dhe pas kësaj dëshmitari dëgjoji të shtëna të pakontrolluara.
103. Të njëjtën sekuencë te ngjarjeve dëshmitari F. K. e përsëriti gjatë dëshmisë së tij më 21 maj 2013, ⁵⁶ duke shtuar se ata (K. dhe I.) ishin në automjetin e tyre zyrtar kur janë dëgjuar të shtënat; kishte të shtëna të shumta kur vetura BMV hyri në kthesë; dhe pastaj ai dhe kolegu i tij (I.) dolën nga vetura.

⁵³ Lënda P 199/2015, faqe 15.

⁵⁴ Lënda P 22/2010, faqe 33, 34.

⁵⁵ Lënda P 22/2010, faqe 36.

⁵⁶ Lënda P 887/2013, faqe 33, 34.

104. Më 23 mars 2016, dëshmitari deklaroi ⁵⁷ se ata (K. dhe I.) e ndalën veturën e tyre në çastin kur automjeti (BMV) shkoi në drejtim të njerëzve (që qëndronin në rrugën “_____”) dhe e goditi një person.
105. Dëshmitari R. I. i dha deklaratat më 18 tetor 2011, 23maj 2013, 15 janar 2015 dhe 23 mars 2016.
106. Në deklaratën e tij të datës 18 tetor 2011, dëshmitari R. I. konfirmoi ⁵⁸ se ai ishte bashkë me kolegun e tij F. K. kur ia ka dhënë tiketën e gjobës një qytetari, kur një person me BMV të kuqe erdhi te ata dhe i tha diçka për një rast të vrasjes që kishte ndodhur në fshatin _____. R. I. dhe K. vendosën ta përcillnin BMV-në e kuqe; I. e ngiste veturën e policisë. Dëshmitari deklaroi se nuk ishte e mundur të përcillej BMV-ja nga afër pasi që ajo shkonte shumë shpejt, por ata (I. dhe K.) e kishin veturën nën vështrim gjatë gjithë kohës. Kur vetura BMV ktheu majtas dhe hyri në rrugën e ngushtë me zhavorr; I. e pa një grup njerëzish duke qëndruar në një rreth në atë rrugë të ngushtë. Kur vetura BMV iu afrua këtij grupi të njerëzve, vetura e vendosi njërin prej tyre përballë veturës me pjesën e përparme të veturës. Dëshmitari tha se në atë çast kuptoi se diçka serioze ishte duke ndodhur. Andaj ai e ndali veturën dhe e nxori çelësin. Derisa ai (I.) ishte duke e hapur derën për të dalë nga automjeti, ai dëgjoi të shtëna dhe e pa se njëri nga personat i cili ishte duke qëndruar në grup filloi të binte në tokë.
107. Më 23 maj 2013, dëshmitari e përsërit sekuencën e ngjarjeve nga deklarata e tij e parë, dhe shtoi ⁵⁹ se në çastin kur vetura BMV e goditi personin, një e shtënë u dëgjua; një e shtënë me armë zjarri. Dhe kur ai (R. I.) doli në anën tjetër të rrugës (rruga _____) i dëgjoi edhe të shtënat e tjera.
108. Dëshmitari R. I. qëndroi pranë deklaratave të tija të mëparshme të dhëna gjithashtu më 15 janar 2015 dhe 23 mars 2016. Më 23 mars 2016, në pyetjen specifike se sa ishte kohëzgjatja e të shtënave, dëshmitari deklaroi ⁶⁰ se nuk mund të thoshte nëse ishte punë sekondash apo minutash por kur automjeti vazhdoi të shkojë në drejtim të anës së majtë, ata nuk e shihnin më veturën, por të shtënat janë dëgjuar.

⁵⁷ Lënda P 199/2015, faqe 29.

⁵⁸ Lënda P 22/2010, faqe 48, 49, 53.

⁵⁹ Lënda P 887/2013, faqe 8, 17.

⁶⁰ Lënda P 199/2015, faqe 39.

109. A. G.2 është marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit më 5 shkurt 2015 dhe 23 mars 2016. Më 5 shkurt 2015, dëshmitari deklaroi ⁶¹ se pasi që vetura e goditi **A.1** dhe kur ai hyri brenda në oborr, i dëgjoji të shtënat. Dhe pastaj, kur ai (A. G.2) doli nga oborri, ai shtiu me armë në ajër.
110. I pandehuri **A. G.1** i dha deklaratat e tij më 4 mars 2015 dhe 13 qershor 2016. Më 4 mars 2015, ai deklaroi ⁶² se kishte dëgjuar të shtëna kur B. u kthye dhe e goditi me veturë.
111. Duke i analizuar deklaratat e lartpërmendura, trupi gjykues mendon se deklarata e B. I. se ai e kishte dëgjuar të shtënenë e parë para se të largohej nga rruga e asfaltuar “Rruga _____” dhe ka kthyer në rrugën “_____” është logjike. B. I. ishte konsekuent në deklaratat e tij; ai shtoi disa detaje kur i janë parashtruar disa pyetje të tjera specifike.
112. Dhe trupi gjykues gjithashtu mendon se deklarata e B. I. nuk është në kundërshtim me deklaratën dëshmitarëve F. K. dhe R. I.. Ata vërtet deklaruan se i dëgjuan të shtënat e para kur akoma ishin në veturë zyrtare (K.); ose përkatësisht I. deklaroi se e dëgjoji të shtënenë nga arma derisa ishte duke e hapur derën për të dalë nga vetura.
113. Trupi gjykues mendon se është e mundur se të shtënat që K. dhe I. i dëgjuan ishin të shtënat që i dëgjuan si të shtënat e para. Por, siç thanë që të dy, ata shkonin me veturë rreth 150-200 metra pas veturës së B.; trafiku ishte i ngjeshur; dëshmitari K. gjithashtu pranoi ⁶³ se vetura e policisë e kishte sirenën të kyçur derisa e përcillnin veturën e tipit BMW, Dhe siç deklaroi B. ai e dëgjoji të shtënenë e parë kur akoma ishte duke e ngarë veturën në rrugën kryesore, përkatësisht 20 metra para se të largohej nga rruga kryesore. B. e pa se babai e tij (I. I.) tashmë ishte qëlluar kur **A.1** iu kthye atij dhe filloi të qëllonte me armë në të; dhe se I. tashmë kishte rënë në tokë, kur B. erdhi te dera e R. G.. ⁶⁴
114. Bazuar në të gjitha, trupi gjykues mendon se situata siç është treguar nga B. se të shtënat me armë filluan para se ai (B.) të kthente në rrugën “_____” dhe e goditi **A. G.1** me veturë, si plotësisht logjike, të mundshme dhe të vërtetë.

⁶¹ Lënda P 68/2014, faqe 9, 14.

⁶² Lënda P 68/2014, faqe 12.

⁶³ Lënda P 22/2010, faqe 43.

⁶⁴ Lënda P 22/2010, faqe 14, 15, 21.

Vrasja në tentativë e B. I.

115. Dëshmitari F. K. më 18 tetor 2011, deklaroi ⁶⁵ se i ka parë disa persona, ishin 5 deri në 6 apo më shumë persona, që qëndronin në rrugë të cilët B. i mori pasi që ktheu majtas pas rrugës kryesore. Në çastin kur vetura BMV shkoi në drejtim të këtyre njerëzve, K. vërejti se njerëzit shkuan në anë të rrugës. Dëshmitarit iu kujtua se vetura BMV e goditi njërin nga këta njerëz; ai person kishte mjekër. Dëshmitari gjithashtu vërejti se vetura BMV në mënyrë shumë agresive hyri në rrugën e vogël, dhe derisa ata (K. dhe I.) përpiqeshin të ndaleshin dhe të dilnin nga vetura, disa të shtëna u dëgjuan. Ishte dëshmia e dëshmitarit ⁶⁶ se kur vetura e goditi personin me anën e majtë të veturës dhe e mbështeti personin në mur, vetura ende ishte në lëvizje dhe e mbante personin përballë veturës. Pra ky person shkoi në anën tjetër; dhe pastaj automjeti e bëri një lëvizje agresive dhe ngasësi i veturës ia doli ta kalonte kthesën e rrugës dhe hyri në rrugën anësore. K. gjithashtu deklaroi se ai nuk e pa asnjë armë në dorën e personit me mjekër i cili u godit nga vetura BMV dhe se njerëzi e tjerë të cilët qëndronin në rrugë, u shpërndanë. ⁶⁷
116. Më 21 maj 2013, dëshmitari e përsëriti ⁶⁸ se ata (K. dhe I. si ngasës i veturës së policisë) e ndalën veturën e tyre në anën e djathtë të rrugës së asfaltuar dhe se mu në atë çast e panë veturën BMV duke shkuar në drejtim të një grupi njerëzish pre 4,5 apo 6 vetash; personat u shpërndanë në anën e djathtë të rrugës anësore derisa vetura BMV e goditi njërin nga personat me anën e majtë të veturës dhe e shtyu personin në drejtim të murit. Pikërisht në atë çast ata (K. dhe I.) gjithashtu e dëgjuan një të shtënë; dhe derisa ishin duke dalë nga vetura, e vërejtën se një person tjetër nga grupi i njerëzve ra në tokë. Pastaj dëshmitari e pa se vetura BMV hyri në kthesën e majtë dhe pastaj doli në një rrugicë tjetër. Në pyetjen specifike nëse kishte pasur një apo më shumë të shtëna, K. deklaroi ⁶⁹ se në atë çast kur vetura hyri në kthesë, kishte të shtëna të shumta; dhe pas kësaj ai dhe kolegu i tij dolën nga vetura e policisë.

⁶⁵Lënda P 22/2010, faqe 34.

⁶⁶ Lënda P 22/2010, faqe 36.

⁶⁷ Lënda P 22/2010, faqe 40 and 41.

⁶⁸ Lënda P 887/2013, faqe 32, 33.

⁶⁹ Lënda P 887/2013, faqe 34.

117. Më 15 janar 2015, dëshmitari F. K. deklaroi ⁷⁰ se së pari vetura BMW e goditi personin me mjekër dhe pikërisht në atë çast u dëgjuan të shtënat. Dëshmitari gjithashtu tha ⁷¹ se shkak i veturës BMW e cila shkonte në drejtim të një personi i cili ishte goditur nga vetura, ai (K.) nuk mundi të shihet nëse personi i goditur kishte ndonjë gjë në duar.
118. R. I. më 18 tetor 2011 deklaroi ⁷² se ai e ndali një veturë policie në rrugën kryesore, kur vetura BMW kishte kthyer majtas, I. e pa një grup njerëzish duke qëndruar në rreth dhe kur vetura BMW iu afrua këtij grupi njerëzish, vetura e vendosi njërin prej tyre në mur me anën e saj të përparme të majtë. Në atë çast I. ende ishte i ulur në veturë; ai e ndali veturën, e nxori çelësin dhe derisa ishte duke e hapur derën për të dalë e dëgjoi një të shtënë dhe gjithashtu e pa njërin nga ata njerëz të grupit të bie në tokë.
119. Më 23 maj 2013, dëshmitari R. I. e përsëriti dëshminë e tij të mëparshme, duke shtuar ⁷³ se po të njëjtën kohë kur vetura BMW e goditi dhe e mbështeti personin në mur dhe derisa ai (I.) ishte duke dalë nga vetura, ai e pa një person tjetër të binte në tokë. Dhe në çastin kur automjeti e goditi personin, u dëgjua një e shtënë. Dëshmitari gjithashtu tha ⁷⁴ se në çastin kur personi u godit nga vetura e tij BMW dhe e shtyu në mur, duart e këtij personi ishin mbi kapakun e motorit të veturës; rrotat e prapme të veturës ende ishin duke u rrotulluar dhe vetëm dy apo tre skedona pas kësaj të shtënat filluan.
120. R. G. më 18 tetor 2011 në dëshminë e tij si dëshmitar deklaroi ⁷⁵ se kur B. I. u kthye me BMW-në e tij, A.2 dhe S. i u larguan duke kërcyer anash rrugës. B. shikoi me veturë në drejtim të **A.1** dhe e goditi atë. Në atë çast, R. e mbuloi fytyrën dhe nuk e di çka ndodhi pastaj. Dëshmitari gjithashtu tha se kur u kthye, e pa se I. ishte vrarë dhe se B. u përpoq ta godiste **A.1** dy herë me veturë.⁷⁶ Kur u ballafaqua me deklaratën të cilën ai (R.) ia dha policisë gjegjësisht “Sapo ai (B.) e goditi **A. G.1** në mur, ai (B.) filloi të ikte në drejtim të shtëpisë së tij. Në atë çast u dëgjuan të shtënat. Dhe unë (R.) nuk e di se kush shtiu. Vetëm e pashe I. në shtrirë prapa meje.” R. deklaroi, “Kështu ndodhi por unë nuk kam dëgjuar të shtëna.”⁷⁷

⁷⁰ Lënda P 68/2014, faqe 5.

⁷¹ Lënda P 199/2015, faqe 28.

⁷² Lënda P 22/2010, faqe 49, 53.

⁷³ Lënda P 887/2013, faqe 7, 8.

⁷⁴ Lënda P 887/2013, faqe 19.

⁷⁵ Lënda P 22/2010, faqe 13.

⁷⁶ Lënda P 22/2010, faqe 17.

⁷⁷ Po aty.

121. Më 21 maj 2013, R. u mor në pyetje përsëri si dëshmitar dhe ai gjithashtu deklaroi ⁷⁸ se nuk ishte në dijeni që I. I. dhe M. I. ishin vrarë atë mëngjes; se nuk kishte dëgjuar të shtëna; se kuptoi më vonë kur policia e mori edhe pse ai nuk e pa kur arriti policia.
122. A. G.2 u mor në pyetje si dëshmitar më 5 shkurt 2015. Ai deklaroi ⁷⁹ se vetura BMW u paraqit, ai (A.2) e kapi R. dhe hyri brenda në oborr dhe pasi që hynë brenda, ai i dëgjoji të shtënat. Kur A.2 doli përjashta, ai gjuajti në ajër dhe e pa **A.1** të shtrirë në tokë në anën e majtë të rrugës dhe në anën e djathtë ai e pa personin e dytë të shtrirë në tokë.
123. Kur B. I. e dha deklaratën e tij më 1 nëntor 2011, ai deklaroi ⁸⁰ se e dëgjoji një të shtënë nga një armë para se të vinte te vendi ku ndodhi grindja. Kur iu afrua më shumë babait të tij (I. I.), ai e humbi kontrollonin ndaj veturës. Në atë çast, **A.1** filloi të qëllonte në drejtim të tij (B.); dhe pikërisht në atë çast B. e pa A.2 dhe babanë e tij (I. I.) i cili po përpiquej të çohet pasi që ishte rrëzuar. Dhe B. më tutje tha: “Pikërisht në atë çast, s’mund të them saktësisht, mund ta kem ndalur veturën, mund t’i kem shkelur frenat por e vërejtja që isha shumë afër vendit ku ishin ata dhe në atë çast e hoqa këmbën nga pedali i frenit me qëllim që të largohesha nga aty dhe e pashë **A.1** duke më qëlluar në kyçin e dorës së majtë. Në atë çast e humba kontrollin (u zemërova) dhe nuk e dija më (...)” Dhe B. I. gjithashtu deklaroi ⁸¹ “Isha këtu pikërisht para shtëpisë së R. G.”. Kur arrita atje, **A.1** u kthye në drejtimin tim dhe e gjuajti në drejtimin tim(...) vetura të cilën isha duke drejtuar anonte nga njëra anë në tjetrën dhe e di se vetura goditi diçka dhe bëri ‘bum’ dhe kur fillova të kthehesha dhe të shkoja në drejtim të shtëpisë sime, e pashë **A.1** siç do të paraqitet në anën time të majtë që ishte afër 24, ai shtiu në mua dhe më qëllloi në kyç të dorës dhe pastaj shitiu 2-3 herë (...)”. Në pyetjen specifike nëse babai i tij (I. I.) ishte qëlluar para se B. ta shihte **A.1** duke shtënë në atë, B. u përgjigj se babai i tij tashmë ishte qëlluar kur **A.1** u kthye kah ai (B.) dhe filloi të shtënte në atë. Dëshmitari gjithashtu sqaroi se **A.1** ishte në anën e majtë dhe babai i tij (I. I.) ishte në anën e djathtë. ⁸²

⁷⁸ Lënda P 887/2010, faqe 11, 18.

⁷⁹ Lënda P 68/2014, faqe 9, 10.

⁸⁰ Lënda P 22/2010, faqe 10.

⁸¹ Lënda P 22/2010, faqe 15.

⁸² Lënda P 22/2010, faqe 28.

124. B. I. e përsëriti dëshminë e tij kur u mor në pyetje si dëshmitar më 14 janar 2015,⁸³ si dhe me 23 mars 2016.⁸⁴ Më 23 mars 2016, B. I. shtoi se **S. G.** dhe A. G. 2 ishin në anën e djathtë dhe se **A. G.1** e qëllloi atë (B.) me armë para se B. ta godiste **A.1** me veturë. Në pyetjen specifike, sa herë ka shtënë **A.1** në drejtimin e tij, B. I. deklaroi⁸⁵ se ai nuk ka mundur t'i numëronte, nuk ishte i përqendruar në këtë. Por iu kujtua se pistoletat e **A.1** ishte bllokuar dhe se ajo e hodhi një fishek përjashta. B. I. e pa qartë **A.1** kur ai e tërhoqi këmbëzën e pistoletës; dhe kjo e shtënë dhe tërheqja e këmbëzës së armës ndodhi para se **A.1** të goditej me veturë.
125. B. I. më 23 mars 2016 deklaroi⁸⁶ se dritarja e anës së majtë të veturës së tij ishte e mbyllur. Kur **A. G.1** filloi të shtinte në drejtimin e tij pasqyra u thye si dhe dritarja në të njëjtën kohë kur plumbi e qëllloi në krah, u thye kur ai (B.) ishte duke u kthyer në kthesë.
126. I pandehuri **A. G.1** më 4 mars 2015, deklaroi⁸⁷ se në rastin kur B. u kthye me veturën e tij me shpejtësi të madhe jo të gjithë ata mundë të iknin, andaj vetëm A.2, R. dhe A.3 hyrën brenda nëpër derë derisa **A.1** dhe **S.** qëndruan përjashta portës. **S.** shkoi në anën e djathtë të rrugës, ai (**A.1**) u mbështet në mur, dhe B. e ktheu veturën e tij dhe e goditi **A.1** derisa ishte i mbështetur në mur. **A.1** tha se nuk e di se si arriti t'i ik asaj goditjeje; ai i vuri duart e tij mbi kapakun e motorit të automjetit dhe vetura e përdrodi, ia goditi këmbët dhe e përplasi në mur. **A.1** tha se ai ra në tokë dhe pothuaj u alivanos; atij i merreshin mendtë dhe gjatë kësaj goditjeje ai gjithashtu dëgjoi të shtëna.
127. I pandehuri **A. G.1** deklaroi se kur e dëgjo **S.** duke shtënë në drejtim të gruas së ndjerë (M.) ai e pa një armë afër tij dhe ai e mori atë armë; ai nuk e përdori atë dhe e vuri në brezin e tij.⁸⁸ I pandehuri gjithashtu dëshmoi se nuk pa asnjë armë në duart e B. si dhe nuk pa ndonjë armë te I. ose në tokë afër I. derisa I. qëndronte ose ishte përkulur me duar mbi kraharrorin e tij.⁸⁹ Dhe i pandehuri gjithashtu dëshmoi se kur e pa **S.** duke shtënë, nuk kishte parë ndonjë armë në tokë.

⁸³ Lënda P 68/2014 faqe 22.

⁸⁴ Lënda P 199/2015, faqe 15.

⁸⁵ Lënda P 199/15, faqe 48, 49.

⁸⁶ Lënda P 199/2015, faqe 51, 52.

⁸⁷ Lënda P 68/2014, faqe 12.

⁸⁸ Lënda P 68/2014, faqe 13,19.

⁸⁹ Lënda P 68/2014, faqe18.

128. Trupi gjykues i shqyrtoi të gjitha deklaratat e lartpërmendura dhe konstatoi se deklaratat e dhënë nga B. I. vlen të besohet dhe se është e besueshme. B. I. ka qenë konsekuent në deklaratat e tija kur i përshkruan detajet e ngjarjes, derisa dëshmia e dëshmitarit R. G. nuk mund të konsiderohet si e besueshme. R. G. deklaroi se ai e mbuloi fytyrën e tij dhe nuk pa dhe nuk dëgjoi asgjë. Kur R. u ballafaqua me deklaratën e tij të mëparshme kur ai (R.) kishte deklaruar se i kishte dëgjuar të shtënat, përgjigja e R. në këtë seancë ishte se ai nuk i ka dëgjuar të shtënat.
129. Edhe pse dëshmitarët K. dhe I. deklaruan se nuk i kanë dëgjuar të shtënat para se B. ta godiste **A.1** me veturë, trupi gjykues konstatoi se deklaratat e tyre nuk janë në kundërshtim me deklaratën e B. I.. Dëshmitarët K. dhe I. ishin ende në veturën e tyre të policisë, ata u ndalën në anën e djathtë të rrugës kryesore, kur B. e goditi **A. G.1**; kishte trafik të ngjeshur në rrugën kryesore. K. dhe I. thanë se e kishin dëgjuar një të shtënë në çastin kur vetura e goditi **A.1**. Por siç thanë gjithashtu, gjithçka ndodhi brenda disa sekondave dhe ata ishin të përqendruar në tërë situatën në mënyrë që të zbulonin se çka po ngjante e jo në detaje. Shkaku i kësaj, K. dhe I. gjithashtu nuk panë asnjë armë në duart e **A. G.1**.
130. Trupi gjykues e konstatoi të provuar faktin se B. I. është qëlluar me armë në krahun e tij të djathtë nga i pandehuri **A. G.1**, derisa ai ishte duke e drejtuar veturën BMW.
131. Fillimisht, trupi gjykues e konstaton të provuar se i pandehuri **A. G.1** ishte në posedim të armës që ishte konfiskuar nga ai si dhe trupi gjykues e konstatoi të provuar se i pandehuri **A. G.1** e përdori armën kur e qëlloi B. I. dhe më vonë M. I. (kjo do të shqyrtohet në një kapitull të veçantë).
132. Një konkluzion i tillë është arritur nga trupi gjykues pas trajtimit me kujdes gjithashtu të provave tjera të cilat plotësisht e vërtetojnë deklaratën e B. I.. Provat e tjera të cilat janë trajtuar nga trupi gjykues, janë vlerësuar si më poshtë.
133. Raporti i ekzaminimit të veturës BMW të datës 9 dhjetor 2009⁹⁰ tregon se gjurmët e të shtënave janë gjetur vetëm në anën e majtë të veturës; pasqyra e majtë është dëmtuar; xhami i përparmë i majtë është prishur dhe kishte shumë copa xhamash në ulësen e vozitësit.

⁹⁰ Regjistratori i prokurorisë #III, faqet 39 – 50.

134. Raporti i ekzaminimit të veturës BMW i përgatitur nga B. O., një zyrtar i forenzikës, i cili e ka ekzaminuar veturën BMW dhe është dëgjuar si dëshmitar më 27 maj 2013 dhe 15 janar 2015. Më 27 maj 2013, kur dëshmitarit i është treguar raporti i ekzaminimit dhe fotografit me nr. 5, 13 dhe 14, B. O. e konfirmoi⁹¹ se dëmet në anën e vozitësit janë shkaktuar nga një fishek. Dëshmitari e konfirmoi gjithashtu se dëmet që shihen në fotografitë me nr. 10, 11 dhe 12 janë shkaktuar nga një fishek.
135. Trupi gjykues e caktoi ekspertin e mjekësisë T. G. dhe ekspertin e balistikës H. K. dhe ata bashkërisht përgatitën një raport të datës “prill 2016.”⁹² Në mendimin e tyre ata dhanë konfirmimin se plaga që e ka pësuar B. I. në pjesën e pasme të dorës së tij është shkaktuar me armë zjarri, dhe se kjo plagë është shkaktuar kur B. i kishte duart apo dorën e tij në timon të veturës BMW. Më tutje, ekspertet kanë vërtetuar se B. ishte duke e vozitur veturën BMW, personi, i cili shtiu në B. I., ishte në anën e djathtë, respektivisht në anën e majtë të veturës. Distanca në mes të gjuajtësit dhe viktimës ishte më e madhe se një metër. Në bazë të dëmeve të shkaktuara nga të shtënat në veturën BMW, ekspertët nuk mund të kenë dhënë pozicionin e saktë se nga kanë ardhur të shtënat sepse trajektorja e predhës nuk është vërtetuar. Megjithatë, ekspertët kanë vërtetuar se personi apo personat të cilët kanë shtënë në drejtim të veturës BMW, ishin në anën e majtë të veturës.
136. Eksperti mjekësor T. G. dhe eksperti i balistikës H. K. i dhanë gjetjet e tyre në mënyrë verbale dhe gjithashtu opinionin e tyre në seancën e datës 10 maj 2016. Ekspertët e shpjeguan se gjatë kohës kur ishin duke e hartuar raportin me shkrim ata kanë përgatitur skicat e tyre personale dhe kanë krijuar trajektorët imagjinare duke bërë lidhjen me vrimën hyrëse dhe gëzhojat që janë gjetur në vendin e ngjarjes.⁹³
137. Eksperti mjekësor T. G. e përsëriti⁹⁴ se në bazë të dëmeve të veturës BMW mund të vërtetohet se nga B. I. është qëlluar gjë që i ka shkaktuar plagë në dorën e tij të majtë, nga ana e majtë. Megjithëse, ekspertët nuk kanë mundur ta përcaktojnë nëse ishte në pjesën e parme apo të pasme.
138. Në bazë të mësipërme dhe duke pas parasysh dinamikat e ngjarjeve në vijim, kur B. I. vazhdoi ta ngiste veturën BMW rreth qoshes, e ndaloi veturën para portës së I. dhe

⁹¹ Lënda P 887/2013, page 25.

⁹² Shiko procesverbalin e datës 10 maj 2016.

⁹³ Lënda P 199/2015, faqe 14.

⁹⁴ Lënda P 199/2015, faqe 15.

kërceu mbi mur në oborrin e I., i vetmi moment kur B. I. ka mundur të qëllohej në dorën e tij të majtë, ishte kur ai filloi të bënte një kthesë drejt shtëpisë së I.. Dhe në atë moment, A. I. ishte personi i vetëm i cili ishte në anën e majtë të veturës; të tjerët janë shpërndarë në anën e djathtë të rrugës anësore.⁹⁵

139. Trupi gjykues nuk mund ta besoj deklaratën e **A. G.1**,⁹⁶ kur ka thënë se një armë ishte afër tij [**A.1**] dhe ai e kishte rrëmbyer por nuk e kishte përdorur; ai e kishte vënë në bel. Kjo deklaratë është në kundërshtim me dëshminë e tij [**A.1**]⁹⁷ e dhënë më vonë. I pandehuri **A. G.1** deklaroi se kur e ka parë **S.** që qëllonte ai nuk e ka parë asnjë armë në tokë. Ai e pa armën në dorën e **S.** dhe të A.2, por nuk pa asnjë armë në dorën e B., as I. dhe as në tokë afër I.; gjithashtu edhe **A.1** nuk e ka parë **M.** që kishte armë apo që po qëllonte.
140. Kur oficerët e policisë K. dhe I. kanë ardhur te vendi, ata i kanë urdhëruar **S.** dhe A.2 që t'i lëshojnë armët e tyre. Në atë kohë **A.1** veçse kishte një armë në bel dhe nuk ka asnjë provë që do të dëshmonte se dikush tjetër ishte në posedim të asaj arme të tretë. Ishte i pandehuri **A. G.1**, i cili e kishte atë armë, e kishte përdorur atë dhe më vonë është sekuestruar nga ai.
141. Në fakt, ishte vetëm **S. G.** i cili ka deklaruar⁹⁸ se I. I. ishte në posedim të asaj arme. **S.** ka thënë se arma të cilën e kishte I. në krahë, ka rënë afër **A.1** atëherë kur I. ka rënë. Në njërin nga deklaratat e tij, **S.** ka thënë se ai [**S.**] ia ka larguar armën e I. kur është qëlluar I. dhe kur ka rënë në tokë. Më 28 maj 2013 **S. G.** tha⁹⁹ se ai e ka larguar më tutje armën nga I..
142. Fotografitë nr. 27, 28, 29, 30 dhe 32 nga foto-albumi¹⁰⁰ tregojnë pozitën e I. I. pasi që ai ka rënë në tokë; ai ishte shtrirë në tokë në gjoksin e tij dhe me duart e tij nën trupin e tij. Deklaratat e **S. G.** nuk ishin konsistente. Trupi gjykues nuk i ka konsideruar si të besueshme deklaratat e **S.** dhe ka vërtetuar se I. I. nuk ishte në posedim të armës si dhe që I. nuk ka përdorur asnjë armë.

⁹⁵ Lënda P 873/2013, procesverbali i datës 21 maj 2013, faqe 33.

⁹⁶ Lënda P 68/14, faqe 18.

⁹⁷ Lënda P 68/14, faqe 19.

⁹⁸ Lënda P 22/2010, faqet 6, 12, 13, 14,15, 16 dhe P 887/2013, faqet 6, 17, 18, 19, 20.

⁹⁹ Lënda P 887/2013, faqe 6.

¹⁰⁰ Regjistratori i prokurorisë #II, faqet 38 – 40.

143. Prandaj, trupi gjykues konstatoi se arma të cilën **A. G.1** e kishte në bel ishte arma të cilën **A. G.1** e posedonte dhe e kishte përdorur kur ka qëlluar në drejtim të B. I..

Vrasja e M. I.

144. F. K., më 18 tetor 2011, kur është marrë në pyetje si dëshmitar ka deklaruar¹⁰¹ se ata [F. K. dhe R. I.], pasi që është ndalur vetura e policisë; pasi janë të dëgjuar të shtënat me armë; dhe pasi që një person kishte mbetur në tokë, ka bërë një marrëveshje se si të vazhdohet dhe si t'i ndajnë detyrat e tyre. K. shkoi në anën e tij të djathtë dhe i ka thënë kolegut të tij I. të shkonte në anën e majtë. Dëshmitari shpjegoi se pozita e rrugës ku ka ndodhur incidenti ishte pak më lartë; ishte më lartë se rruga kryesore ku ata e kishin parkuar veturën e policisë. Kur ata i janë afruar vendit ku ka ndodhur incidenti, K. i ka parë dy persona përpara tij; njëri prej tyre po e mbante një armë; personi i cili nuk po e mbante armën ishte i parruar. K. e urdhëroi personin që e kishte armën që ta hedh armën tutje; ai bëri ashtu pas asnjë rezistencë. Pastaj K. e urdhëroi atë të shtrihet poshtë në tokë; një person tjetër ishte shtirë në tokë së bashku me të parin. Personi që e kishte armën i kishte duart në pranga. Ndërsa I. ishte duke e prangosur atë personin që kishte armë, K. e vërejti veturën BMW të parkuar diku 15 – 20 metra më larg dhe ai [K.] gjithashtu e vërejti edhe një person tjetër i cili po e mbante një armë në duar. K. ia dha të njëjtat urdhra këtij personi dhe ai shkoi drejt këtij personit të tretë, ndërsa kolegu i tij I. qëndroi me dy personat e parë. K. shkoi 15 – 20 metra kah personi i tretë; e prangosi atë dhe kërkoi për ndihmë policore nga qendra e komunikimit të policisë. Kur kishte të bënte me personin e tretë, K. gjithashtu e ka parë një femër jashtë veturës; ajo ishte në tokë afër veturës.
145. Në vazhdim, F. K. deklaroi¹⁰² se ndërsa ai dhe I. ishin ende në vetura, ata e panë se pas gjuajtjes së personit, vetura BMW ka shkuar drejt rrugës anësore dhe mori një kthesë; prandaj ishte e vështirë për ta [K. dhe I.] ta shohin dhe ta vëzhgojnë lëvizjen e veturës.

¹⁰¹ Lënda P 22/2010, faqe 34.

¹⁰² Lënda P 22/2010, faqe 37.

146. Më 21 maj 2013, dëshmitari F. K. e përsëriti dëshminë e mëparshme, duke specifikuar¹⁰³ se ndërsa ai dhe I. dolën nga vetura e policisë dhe po afroheshin, aty kishte të shtëna të shumta.
147. R. I. më 18 tetor 2011 deklaroi¹⁰⁴ se pasi e ndaloi veturën e policisë, ai vazhdoi në këmbë kah rruga dytësore; vetura BMW ka shkuar mbrapa murit tek një shtyllë elektrike. Kur ai [I.] erdhi në qosh të rrugës anësore, K. doli jashtë dhe ju dha urdhra dy personave të cilët po qëndronin në distancë prej 5-6 metra nga I.; njëri prej tyre po bartte armë. Kur I. i përsëriti urdhrat, këta dy persona u shtrinë në tokë; I. e prangosi atë i cili e kishte një armë në duar dhe po e mbante personin tjetër nën kontroll duke e bërë të palëvizshëm me disa lëvizje të duarve. Ai gjithashtu e ka parë personin e tretë që po e bartte armën i cili po qëndronte pak më tutje veturës BMW. I. e konfirmoi¹⁰⁵ se ai e pa një femër që ishte e shtrirë afër veturës BMW; ajo ishte e shtrirë te dera e veturës.
148. Dëshmitari R. I. më 23 maj 2013 e përsëriti deklaratën e mëparshme dhe ai gjithashtu konfirmoi¹⁰⁶ se i kishte dëgjuar të shtënat kur kishte shkuar në anën tjetër të rrugës kryesore pasi ka dal nga vetura e policisë.
149. Më 18 tetor 2011, R. G. deklaroi¹⁰⁷ në fillimi se pasi e kishte goditur **A.G.1** dy herë, B. I. pastaj kishte shkuar përpjetë në drejtim të shtëpisë së tij; B. doli nga vetura dhe hyri në shtëpinë e tij dhe pastaj ai [R.] nuk e ka parë më B. pas kësaj. Dëshmitari pastaj deklaroi¹⁰⁸ se ai nuk ka mundur ta sheh B. I., B. vetëm po largohej me veturë; R. e ka parë B. duke u larguar me veturë. R. tha se ai asnjëherë nuk e ka parë trupin e M. I. që ishte i shtrirë në tokë;¹⁰⁹ ai e kuptoi se M. ishte vranë, rreth 10 – 20 minuta pasi që erdhi autoambulanca. Kur është dëgjuar si dëshmitar më 21 maj 2013, R. G. tha¹¹⁰ se ai nuk e ka parë që kanë ardhur policia; ai nuk i dëgjoji të shtënat me armë dhe se nuk ishte në dijeni se në këtë mëngjes kritik, ishin vranë I. I. dhe M. I..

¹⁰³ Lënda P 887/2013, faqe 35.

¹⁰⁴ Lënda P 22/2010, faqe 49.

¹⁰⁵ Lënda P 22/2010, faqe 51.

¹⁰⁶ Lënda P 873/2013, faqe 17.

¹⁰⁷ Lënda P 22/2010, faqe 23.

¹⁰⁸ Lënda P 22/2010, faqe 24.

¹⁰⁹ Lënda P 22/2010, faqe 31.

¹¹⁰ Lënda P 873/2013, faqet 11, 18.

150. B. I. më 1 nëntor 2011 deklaroi¹¹¹ se pasi që ishte qëlluar nga **A.1**, dhe ai [B.] e kuptoi se vetura e tij e kishte goditur dikë; ai shkoi ka qoshja drejt portës. B. doli nga vetura dhe që të tre [**A.1**, **S.** dhe A.2] filluan të vrapojnë në drejtim të tij dhe filluan të gjuajnë në të. Në atë moment, duke parë që porta ishte e mbyllur, ai u ngjit me duar në mur dhe u gjuajt në oborr. B. I. tha se e kishte dëgjuar shumë mirë kur është hapur dera e veturës dhe M. ka bërë titur ‘lëshomi flokët’ dhe një zë tjetër ‘jo gruan’. Pastaj ai i dëgjoji tri të shtëna me armë. Në pyetjen specifike se si B. i ka parë që të tre [**A.1**, **S.** dhe A.2], B. u përgjigj¹¹² se kur ka dal nga vetura, **S.** ishte personi i parë, ishte në distancë të shkurtë, pastaj A.2 ishte pak më poshtë dhe **A.1** ishte i fundit. Pastaj B. u gjuajt kah murit dhe pas kësaj i dëgjoji tri të shtëna. B. I. gjithashtu tha¹¹³ se nuk e ka vërejtur se M. është qëlluar me plumb deri sa ai [B.] ishte ende në veturë. B. e dëgjoji M. duke bërë titur “oh, e vranë babanë tonë” kur B. mbërriti tek pjesa e kthesës së rrugës ku babai i tij [I. I.] ishte qëlluar. Dhe hera e fundit kur B. e dëgjoji M. ishte kur ajo po thoshte “mi lësho flokët.”
151. Më 14 janar 2015 dhe 23 mars 2016, B. I. e përsëriti deklaratën e tij dhe shtoi¹¹⁴ se pasi e goditi **A.1** dhe kur vazhdoi drejt derës së tij hyrëse, ai i pa nga xhami që të tre [**A.1**, **S.** dhe A.2] që vraponin prapa veturës.
152. Më 4 mars 2015, i pandehuri **A. G.1**, theksoi¹¹⁵ se ai ka dëgjuar të shtëna gjatë goditjes së veturës BMW, edhe pse ai nuk e din se cilin e ka qëlluar, A.2 apo **S.**. Ai [**A.1**] ra poshtë; vetura ka hyrë në kthesë me qëllim që të vazhdojë tutje; **A.1** ka provuar të ngrihej por nuk ka mundur ta realizoj. **A.1** eci dy apo tre hapa por ra poshtë në qoshe të murit. **A.1** pohoi se ai e ka parë B. duke u kthyer për në shtëpi; ai e pa se si B. e hapi derën e veturës së tij, pastaj i vendosi duart në mur dhe kërceu përmes murit në oborrin e tij. **A.1** ishte i shtrirë në tokë, kishte dhimbje të rënda, i ka dëgjuar të shtënat dhe e ka parë I. duke i vënë dy duart e tij në gjoks; I. po binte në gjunjë dhe po binte poshtë. **S.** dhe A.2 ishin shumë afër I. **A.1** e ka parë A.2 shumë afër I. me pistoletë në kokën e I. dhe A.2 e qëllloi I. dy herë. **A.1** gjithashtu e ka parë **S.** duke ecur shumë shpejt; **A.1** gjithashtu i ka dëgjuar disa të shtëna por nuk e ka ditur nëse **S.** apo A.2 kanë shtënë

¹¹¹ Lënda P 22/2010, faqe 11.

¹¹² Lënda P 22/2010, faqet 25, 26.

¹¹³ Lënda P 22/2010, faqe 29.

¹¹⁴ Lënda P 68/2014, faqe 23 dhe lënda P 199/2015, faqet 15, 16.

¹¹⁵ Lënda P 68/2014, faqet 12, 13.

në drejtim të veturës. **A.1** tha, ai filloi të vjell dhe e pa **S.** duke shkuar drejt veturës; e ndjera bashkëshortja [**M.**] ishte në këmbë kur **S.** qëllloi në drejtim të saj dhe **A.1** e pa **M.** e cila binte nga mbrapa; **A.1** e pa **S.** që e qëllloi përsëri **M.** dhe ajo ra në shpinë. Gjatë këtyre të shtënave, **A.1** e pa një armë afër tij; ai e mori armën dhe e vendosi në bel. **A.1** nuk e di se e kujt ishte ajo armë. Pasi që **A.1** e mori armën, ai e pa **A.2** që vinte t'i ndihmonte të ngrihej. Atëherë kur u ngritën erdhën policia dhe thanë “lëshoni armët në tokë.” **A.2** e gjuajti armën larg vetës; pastaj policia i urdhëroi të dy të shtrihen në tokë. **A.1** u përgjigj “nuk mundem sepse siç po e shihni jam i dërmuar” dhe qëndroi në pozicionin ulur dhe oficeri i policisë ia rrotulloi dorën mbrapa. **A.1** tha se askush nuk është lënduar nga duart e tij apo veprimet e tij. **A. G.1** gjithashtu tha¹¹⁶ se dera e anës së pasagjerit ishte e hapur; **M.** ishte gati përpara derës, vetëm edhe pak larg derës, por afër derës. **A.1** e përsëriti që e ka parë **M.** që përkulej kur e dëgjoji të shtënën e parë; dhe pastaj **M.** ra sikur dikush kur mundohet të ulet dhe ra mbrapa në tokë. Kur është dëgjuar e shtëna e dytë, pastaj **M.** ka ra në shpinë dhe pas të shtënës së tretë duart e saj janë hapur dhe ajo ishte shtrirë me shpinë me duart e shtrira.

153. I pandehuri përsëri e përsëriti¹¹⁷ se ai nuk kishte pistoletë në dorë. Policia nuk e kishin prangosur. Ndërsa po hynte në veturën e policisë, ai është pyetur nga policia nëse ai kishte diçka me të dhe ai i kishte thënë policisë se ai e kishte një revole dhe që e kishte marr nga toka. Oficeri i policisë e pyeti se ku e kishte armën dhe i pandehuri i tha “se ishte në belin e tij.” Oficeri i policisë e mori pistoletën nga beli i **A.1**.

154. I pandehuri gjithashtu tha¹¹⁸ se ai e pa armën në duar të **S.** dhe **A.2** por nuk ka parë asnjë armë në duar të **B.**, dhe as në të **I.** dhe as në tokë afër **I.** kur **I.** po përkulej me duart e tij në gjoks; gjithashtu ai nuk e ka parë **M.** që kishte armë apo që gjuante. Ishte dëshmia e **A.1**¹¹⁹ që kur **A.1** e ka parë **S.** që qëllonte, ai nuk ka parë asnjë armë në tokë. Dhe kur **A.1** e ka parë **S.** duke qëlluar ato të tri të shtëna në drejtim të **M.**, ajo armë ishte afër tij [**A.1**] dhe ai e ka marr atë armë por nuk e ka përdorur; ai e ka vënë në belin e tij.

¹¹⁶ Lënda P 68/2014, faqet 14, 15.

¹¹⁷ Lënda P 68/14, faqet 15, 16.

¹¹⁸ Lënda P 68/14, faqe 18.

¹¹⁹ Lënda P 68/14, faqe 19.

155. Më 13 qershor 2016, i pandehuri tha¹²⁰ se ai ishte në qoshe të murit, afër shtyllës elektrike, ndërsa **S.** dhe **A.2** ishin afër tij, të rreshtuar në anën e tij të djathtë. **A.1** tha se ishte në pozicionin e njëjtë sikur kur bie në gjunjë, këmba e tij e majtë ishte e shtrirë dhe po e mbështeste trupin e tij në këmbën e tij të djathtë pasi të majtën e kishte të lënduar. Pastaj **A. G.1** erdhi dhe i ndihmoi; **A.2** i vendosi krahët e tij nën sqetulla të **A.1** dhe e ngriti lartë.
156. Deklaratat e të dy oficerëve të policisë, **K.** dhe **I.**, të cilët janë dëgjuar si dëshmitarë, e vërtetuan faktin se pasi që personi [**I. I.**] ka rënë në tokë; pasi që vetura **BMW** e goditi një person [**A. G.1**] dhe pasi që **B.** ka vazhduar të vozis drejt portës së **I.**, është dëgjuar e shtëna. Edhe pse ata dy dëshmitarë, më shumë për shkak të terrenit i cili është pak më lartë dhe kthesës së rrugës anësore, nuk kanë parë se kush në fakt i ka shkrepur ato të shtëna.
157. Siç e ka shpjeguar tashmë trupi gjykues në kapitullin përpara, trupi gjykues e konstatoi si të provuar faktin se i pandehuri **A. G.1** ishte në posedimi të një arme. Trupi gjykues e konstatoi si të provuar se **A.1** e ka përdorur armën kur e ka qëlluar **M. I.**
158. Gjatë vlerësimit të provave të cilat vërtetojnë se i pandehuri **A. G.1** qëllimisht ka qëlluar me armë-revole të tipit **M57-TT** me numër serik **132205**, në drejtim të saj dhe e qëllloi **M. I.** në krahun e djathtë dhe i shkaktoi një plagë vdekjeprurëse, trupi gjykues konstatoi deklaratën e **B. I.** si të besueshme dhe bindëse.
159. Deklarata e **B. I.** se **M.** ishte gjallë dhe nuk ishte plagosur derisa **B.** e ndaloi veturën para portës së **I.** dhe kërceu përmes murit në oborr, është vërtetuar me provën në vijim.
160. I pandehuri **A. G.1** më 4 mars 2015 tha¹²¹ se pas goditjes me veturën **BMW**, ai ra në tokë; atij gati po i binte të fikët; po i merreshin mendtë; ai u mundua të ngruhej në këmbë por nuk ia arriti; ai eci dy apo tre hapa por ra në qoshe të murit. Megjithatë, **A.1** tha se i ka dëgjuar të shtënat, ai e pa **I.** me të dyja duart në gjoks; ai e pa **I.** që ra në gjunjë e pastaj që ra poshtë; ai e pa **A.2** dhe **S.** afër **I.** Dhe **A.1** gjithashtu e përshkroi në detaje se çfarë bënë **A.2** dhe **S.**; si dhe kush iu qas veturës **BMW**; si dhe kush qëllloi në **M.** dhe

¹²⁰ Lënda P 199/15, faqet 13, 14.

¹²¹ Lënda P 68/2014, faqe 12.

se si ajo ra poshtë gjithashtu edhe pozitën e saj pas të shtënave. Për më tepër, i pandehuri **A. G.1** tha¹²² se ai ishte i shtrirë në tokë kur erdh A.2 dhe e ndihmoi të ngrihej. Kur **A.1** është marr nga policia për në Mitrovicë; ata ia ekzaminuan këmbët e tij. **A.1** tha se kishte disa lëndime në gjoks; kishte “shok sepse ishte përdredhur;” këmba e tij ishte lidhur por pa gips. I pandehuri tha se këmba e tij e majtë ishte lënduar; ishte thyer ose kërcitur, i ishte vendosur pak losion në këmbën e tij të djathtë pasi ishte ënjtur dhe i ishte përshkruar një terapi për dhimbje në klinikë mjekësore.

161. Më 13 qershor 2016, i pandehuri **A. G.1** tha¹²³ se në fakt R. G. i tha fjalët “mos e mbyt gruan.” Kur R. G. i përsëriti ato fjalë disa herë, **A.1** ishte në qoshe të murit, afër shtyllës elektrike dhe të dy edhe S. edhe A.2 ishin afër tij të renditur në anën e tij të djathtë. **A.1** gjithashtu ka thënë¹²⁴ se ishte në pozitën në gjunjë, këmba e tij e majtë ishte shtrirë dhe ai po e mbështeste trupin e tij në këmbën e djathtë. Pastaj A.2 erdhi dhe e ndihmoi.
162. Deklaratat e të pandehurit **A. G.1** e kundërshtojnë dokumentacionin mjekësor dhe mendimin e ekspertit mjekësor. Ekzistojnë tri raporte mjekësore¹²⁵ lidhur me të pandehurin **A. G.1**, pra raporti i datës 4 dhjetor 2009, i përgatitur nga mjeku Xh. L., i cili e ekzaminoi i pari të pandehurin, raporti i datës 6 dhjetor 2009 i përgatitur në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan dhe raporti i datës 4 mars 2010, i përgatitur në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë.
163. Më 17 prill 2016, trupi gjykues e caktoi një ekspert të mjekësisë ligjore, T. G., dhe ia ofroi ekspertit të tri raportet mjekësore të cituara më lartë.
164. Eksperti T. G., i ofroi gjetjet dhe opinionin e tij me shkrim më 29 dhe 30 prill 2016, si dhe gojarisht në seancën e datës 10 maj 2016. Në raportin e datës 29 dhe 30 prill 2016,¹²⁶ eksperti T. G. shkroi se kishte konstatuar nga raporti mjekësor i përgatitur nga mjeku Xh. L., se ashti i pjesës së fundit të shputës së majtë të **A.1** [maleolusi] ishte thyer. Eksperti T. G. ka theksuar se nuk është përcaktuar se cila pjesë e ashtit është thyer; i njëjti raport mjekësor i datës 4 dhjetor 2009 nuk e përcakton nëse thyerja e maleolusit pasohet me nxjerrje nga vendi apo jo. Në vazhdim, eksperti konstatoi se raporti i Qendrës

¹²² Lënda P 68/2014, faqe 14.

¹²³ Lënda P 199/2015, faqe 13.

¹²⁴ Lënda P 199/2015, faqe 14.

¹²⁵ Lënda P 22/2010, Procesverbali i datës 2 nëntor 2011, faqe 2.

¹²⁶ Lënda P 199/2015, Regjistratori i gjykatës, vëllimi #II, fashikulli nr.8.

së Paraburgimit në Gjilan tregon se është bërë RTG e ijës dhe pjesës e fundit të anës së majtë të shputës së majtë dhe se rezultatet e RTG tregojnë se janë thyer kockat, apo që është vënë re ndonjë ndryshim tjetër. Eksperti T. G., në bazë të skicës së vizatuar nga mjeku në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, gjithashtu tregon se kontuzionet janë lokalizuar në hapësirën e gjurit të djathtë dhe pjesës së poshtme të shputës së këmbës së majtë, të cilat përputhen me xhinset e grisura të të pandehurit **A. G.1**.

165. Eksperti T. G. e dha mendimin se në bazë të dokumentacionit mjekësor kontuzionet janë gjetur në hapësirën e gjurit të djathtë dhe në thembrën e shputës së majtë, por çarjet dhe thyerjet e kockës nën gjurin e majtë (tibia dhe fibula) nuk ekzistojnë; si dhe as i pandehuri **A. G.1** nuk kishte pësuar asnjë kontuzion të rëndë të trurit, dhe kjo as nuk është përcaktuar në dokumentacion mjekësor. Prandaj, eksperti T. G. është i mendimit se i pandehuri **A. G.1** ishte në gjendje të lëviz pas disa sekondave apo pas 1 – 2 minutave.

166. Eksperti T. G., gjithashtu ka dhënë mendimin se lëndimet që gjinden në dokumentacionin mjekësor, me përjashtim të thyerjes dhe nxjerrjes nga vendi, që nuk janë vërtetuar në dokumentacionin mjekësor, gjithashtu ia mundësojnë të pandehurit **A. G.1**, aftësinë të qëndrojnë në këmbë dhe të lëviz në distancë prej 20 metra apo edhe më gjatë. Dhe eksperti T. G. gjithashtu ka mendimin se nëse ka thyerje të kockës tibia ose fibula, në anën e majtë në rastin konkret, kjo do ta bënte të vështirë për të pandehurin të qëndroj në këmbë dhe të lëviz dhe të veprojnë në distancë prej 20 metra apo edhe më shumë se 20 metra.

167. Eksperti T. G. i ka dhënë gjetjet e tij në formë verbale gjatë seancës së 10 majit 2016¹²⁷ dhe e përsëriti se diagnoza e Xh. L. në raportin e datës 4 dhjetor 2009 ishte gabim në lidhje me thyerjen e kockave të maleolusit të shputës së majtë të **A.1**, pasi që rezultatet e RTG-s tregojnë “PVP” që do të thotë ‘pa veçori të përgjithshme’ apo ‘pa ndryshime’ dhe eksperti e vërtetoi se lëndimi është gjetur në gjurin e djathtë dhe në nyje të shputës së majtë.

168. Në bazë të rekomandimit të ekspertit T. G. për të kryer një RTG të thjeshtë apo CT të pjesës skajore të kockës tibia dhe fibula e majtë e kockave të shputës së këmbës së

¹²⁷ Lënda P 199/2015, faqet 24 – 36.

majtë të **A.1**, trupi gjykues me urdhër të datës 11 maj 2016 caktoi Klinikën Radiologjike të QKUK-së të kryejë CT siç është përmendur nga eksperti.

169. Klinika e Radiologjisë të QKUK-së bëri CT-në e kërkuar dhe ia dërgoi trupit gjykues raportin e datës 12 maj 2016¹²⁸ me konkluzionin se CT e pjesës skajore të diafizës së tibias së majtë dhe e shputës së majtë nuk ka asnjë shenjë të ndryshimeve traumatike.
170. Konkluzionet e Klinikës Radiologjike mbështesin gjetjet e ekspertit T. G. se fraktura të ndonjëres nga ekstremitetet nuk janë regjistruar as në Gjilan apo në Qendër të Dubravës përveç në raportin e parë të hartuar nga mjeku Xh. L., në ditën e incidentit. Dhe sipas ekspertit, edhe me frakturë apo me frakturë edhe nxjerrje nga vendi nuk do të ishte e pamundur për **A.1** të qëndronte në këmbë apo të lëvizte; megjithëse do të ishte e vështirë; por gjithçka varet prej secilit njeri veç e veç. Në rastin konkret, i pandehuri **A. G.1** nuk ishte krejtësisht i mbështetur për muri nga vetura; prandaj ai kishte vetëm hematoma dhe gërvishtje të cilat ndodhen në raportet mjekësore. Nëse **A.1** do të kishte fraktura të tërë hapësirës së pelvisit ai do të vuante për tërë jetën.
171. Në bazë të mësipërme, trupi gjykues konstatoi se i pandehuri **A. G.1** ishte në gjendje të ecte pasi që është goditur me veturën BMW dhe që **A.1** ka ecur dhe ka lëvizur.
172. Një konkluzion i tillë është vërtetuar edhe me deklaratat e dëshmitarëve R. I.¹²⁹ dhe F. K.,¹³⁰ të cilët vërtetuan se i pandehuri **A. G.1** nuk ishte arrestuar në të njëjtin vend ku edhe ishte goditur me veturën BMW. Në vazhdim, F. K. dëshmoi¹³¹ se kur ai [K.] erdhi te vendi dhe dha urdhra për të ulur armën dhe pastaj për tu shtrirë në tokë, ishin dy njerëz që qëndronin para tij, të cilët ishin identifikuar si **A.1** dhe A.2. E njëjta që të dy këta persona po qëndronin në këmbët e tyre, është vërtetuar gjithashtu nga dëshmitari R. I. më 18 tetor 2011,¹³² më 22 maj 2013¹³³ dhe më 23 mars 2016.¹³⁴

¹²⁸ Lënda P 199/2015, Regjistratori i gjykatës, vëllimi #II, ndarja nr.4

¹²⁹ Lënda P 199/2015, Procesverbali i datës 23 mars 2016, faqe 43 dhe procesverbali i datës 26 prill 2016, faqe 15.

¹³⁰ Lënda P 199/2015, Prova materiale B.

¹³¹ Lënda P 22/2010, faqe 34, 37 dhe Lënda P 887/2013, faqe 36 dhe Lënda P 68/2014, faqe 6 dhe Lënda P 199/2016, faqe 29, 30 .

¹³² Lënda P 22/2010, faqe 55.

¹³³ Lënda P 887/2013, faqe 9.

¹³⁴ Lënda P 199/2015, faqe 39.

173. Konkluzioni, se i pandehuri **A. G.1** ishte në posedim të armës, konkretisht të armës-revoles e llojit M57-TT me numër serik 132205, dhe që ai ka lëvizur pasi që është goditur nga vetura BMW, e çoi trupin gjykues në konkluzionin se i pandehuri **A. G.1** e kishte përcjellë veturën BMW dhe kishte shtënë me armë-revole në atë drejtim dhe e kishte qëlluar M. I. ndërsa ajo po dilte nga vetura. Provat që e mbështesin një konkluzion të tillë janë të arsyetuara në pikat në vijim.
174. Në bazë të raportit të autopsisë i datës 14 dhjetor 2009¹³⁵ mund të vërtetohet se e ndjera M. I. kishte pësuar nëntë (9) plagosje me armë. Pesë (5) nga to ishin plagë hyrëse me armë dhe katër (4) plagë dalëse me armë. Plaga hyrëse numër 1 është e lidhur me plagën dalëse numër 7, plaga hyrëse numër 3 është e lidhur me plagën dalëse numër 2, plaga hyrëse numër 5 është e lidhur me plagën dalëse numër 4, dhe plaga hyrëse numër 6 është e lidhur me plagën dalëse numër 8. Plaga hyrëse numër 9 nuk ka plagë dalëse pasi që plumbi ka mbetur në trup në kraharonin e majtë.
175. Plumbi që është gjetur në trupin e M. I. gjatë kryerjes së autopsisë¹³⁶ i është dorëzuar policisë, e pranishme gjatë autopsisë, konkretisht F. L.. Plumbi është dorëzuar si provë materiale D#33 dhe e ekzaminuar nga Laboratori i Forenzikës. Në bazë të raportit të balistikës të datës 9 gusht 2010,¹³⁷ ai plumb është shtënë me revole “C. Zastava” e kalibrit 7.62x25mm me numër serik “C-132205” dhe e shënjuar si prova materiale F6. Dhe në bazë të certifikatës për sekuestrimin e gjërave e datës 4 dhjetor 2009¹³⁸, revolja e kalibrit 7.62x25mm me numër serik “C-132205” është sekuestruar nga **A. G.1** së bashku me një karikator dhe 4 fishekë.
176. Eksperti i caktuar i balistikës H. K. dhe eksperti i mjekësisë ligjore T. G., në raportin e tyre me shkrim të prillit 2016 dhe i korrigjuar më 19 dhe 22 prill 2016¹³⁹ e kanë dhënë mendimin e tyre se M. I. është qëlluar nga dy pozicione apo nga dy kënde. Ekspertet dhanë mendimin se predhën e cila ka mbetur në anën e majtë të kraharonit të saj, dhe që është nxjerrë gjatë autopsisë dhe e shënjuar si prova materiale D#33, ka mundur t’i ketë ndodhur M. atëherë kur është qëlluar në krahun e saj të djathtë nga pozicioni gjersa ajo po qëndronte në këmbë. Kjo plagë ka qenë plagë vdekjeprurëse për

¹³⁵ Regjistratori i Prokurorisë nr. #I, faqet 95 – 115.

¹³⁶ Regjistratori i Prokurorisë nr. #III, faqe 240.

¹³⁷ Regjistratori i Prokurorisë nr. #I, faqe 50 – 63.

¹³⁸ Regjistratori i Prokurorisë nr. #II, faqet 310, 311.

¹³⁹ Lënda P 199/2015, Regjistratori i gjykatës vëllimi #II, Ndarja nr.12.

M.. Në bazë të gëzhjave të gjetura, të shënuara me 22 dhe 23, e njëjta plagë ka mundur t'i jetë shkaktuar, kur M. ishte ulur në ulësen e pasagjerit, nëse në ndërkohë ishte i hapur xhami i veturës. Lëndime tjera që janë gjetur në të ndjerën M., janë shkaktuar kur M. ishte e shtrirë në tokë në shpinë, me këmbë pak të ngritura, nga rruga me zhavorr. Trajektorja e të gjitha plagëve shkon nga poshtë lartë.

177. Eksperti i balistikës H. K. dhe eksperti i mjekësisë ligjore T. G., ishin të pranishëm gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes si dhe i kanë dhënë mendimet e tyre gojarisht në seancën e 10 majit 2016.¹⁴⁰ Eksperti T. G. e përsëriti se plaga që M. I. e kishte pësuar në krahun e djathtë dhe me trajektoren e saj që ka shkuar prej anës së djathtë kah ana e majtë, dhe prej lartë poshtë dhe pak mbrapa, ndërsa predha ka mbetur në trupin e të ndjerës M., ishte plaga vdekjeprurëse. Ajo i shqeu organet vitale, ndërsa i ka dëmtuar indet e mushkërive; dhe ku është gjetur një sasi e madhe e gjakut, rreth 1,8 litra gjaku dhe 60 ml. gjaku në anën e majtë të gropës së toraksit; dhe një sasi e tillë e gjakut e ka shkaktuar vdekjen e M. I.. Pas këtij lëndimi në krahun e djathtë, M. nuk ka mundur të bëjë lëvizje të mëdha, ndoshta një apo dy hapa. Ishte mendimi i ekspertit se M. e ka pësuar këtë plagë ndërsa ishte në veturë dhe ndërsa xhami ishte i hapur ose kur u ndal vetura dhe dera e veturës ishte hapur dhe kur M. po dilte jashtë. Pastaj M. i kishte bërë dy apo tre hapa dhe menjëherë kishte rënë poshtë në tokë; të gjitha plagët e tjera ka mundur t'i ketë pësuar ndërsa ishte në pozicionin e shtrirë me këmbët e saj pak të ngritura, në pozicion mbrojtës. Eksperti ka ardhur në konkluzion të tillë sepse të gjitha lëndimet tjera janë poshtë dhe nëse M. ka qenë në këmbë të saj nuk ka mundur t'i ketë pësuar ato plagë.

178. Mendimi i ekspertit G. ishte se M. ishte e kthyer me krahun e djathtë kah person i cili qëllloi në të dhe se ajo ishte qëlluar nga distanca; mund të jetë më shumë se 70 deri 80 cm. Meqenëse kjo plagë ishte shpuese dhe jo depërtuese dhe fisheku ka mbetur në trup, nuk ka shkaktuar gjakderdhje. Dhe meqë nuk kishte asnjë gjurmë të gjakderdhjes në veturë, plagët tjera që ishin plagë depërtuese janë shkaktuar kur M. veçse ishte jashtë veturës.

¹⁴⁰ Lënda P 199/2015, faqet 4 – 24.

179. Në bazë të foto-albumit¹⁴¹ trupi gjykues ka konstatuar se xhami i djathtë në anën e pasagjerit ishte i mbyllur. Në bazë të tabelës së matjeve në vend¹⁴² dhe skicës¹⁴³ trupi gjykues vërtetoi se dy fishekë (“fisheke”) janë shfaqur nga policia si prova materiale D5 dhe D24 dhe katër gëzhoja (“gëzhoje”) janë shfaqur nga policia si D17, D20, D22 dhe D23.
180. Në bazë të raportit të balistikës të datës 9 gusht 2010¹⁴⁴ trupi gjykues vërtetoi se provat materiale D5 dhe D24 nuk kanë karakteristika balistike, ndërsa gëzhoja e zbrazet provë materiale D17 ishte shkrepur nga një armë – revole e llojit TT me numër serik 967473766-1964, gëzhoja provë materiale D20 ishte shkrepur nga një armë – revole e kalibrit 7.62x25mm, me numër serik 160982 dhe gëzhojat, D22 dhe D23 janë shkrepur nga një armë – revole e kalibrit 7.62x25mm me numër serik “C-132205.”
181. Siç është vërtetuar më parë, në bazë të certifikatës për sekuestrimin e sendeve e datës 4 dhjetor 2009¹⁴⁵, revolja e kalibrit 7.62x25mm me numër serik “C-132205” është sekuestruar nga **A. G.1** së bashku me një karikator 1 magazine dhe 4 fishekë. Ndërsa dy armë të tjerë janë sekuestruar nga **S. G.** dhe **A. G.2.**¹⁴⁶
182. Për më tepër, në bazë të foto-albumit¹⁴⁷ dhe raportit të balistikës të datës 9 gusht 2010,¹⁴⁸ trupi gjykues vërtetoi se është shtënë nga të gjitha armët e sekuestruara nga i pandehuri **A. G.1, S. G.** dhe **A. G.2.**
183. Trupi gjykues nuk gjeti asnjë provë se **S. G.** apo **A. G.2** e kanë përdorur armën që ishte sekuestruar nga **A.1.** Gjithashtu trupi gjykues nuk gjeti asnjë provë se **I. I.** ka qëlluar në **M.** ndërsa ajo ishte në pozicionin ulur në ulësen e pasagjerit. Trupi gjykues e gjen një mundësi të tillë të pamundshme pasi që; askush përveç **S. G.** nuk ka parë ndonjë armë në duart e **I.**; **I. I.** veçse ishte qëlluar dhe po binte në tokë, kur **B. I.** e goditi **A.1** me veturën **BMW.** Për më tepër, xhami i pasagjerit ishte i mbyllur dhe jo i thyer, dhe nuk ka asnjë gjurmë të të shtënave në anën e djathtë të veturës **BMW.**

¹⁴¹ Regjistratori i Prokurorisë nr. #III, faqe 42, foto nr. 3.

¹⁴² Regjistratori i Prokurorisë nr. #III, faqet 35 – 38.

¹⁴³ Regjistratori i Prokurorisë nr. #III, faqe 34.

¹⁴⁴ Regjistratori i Prokurorisë nr. #I, faqet 50 – 63.

¹⁴⁵ Regjistratori i Prokurorisë nr. #II, faqet 310, 311.

¹⁴⁶ Regjistratori i Prokurorisë nr. #II, faqet 302 – 305.

¹⁴⁷ Regjistratori i Prokurorisë nr. #III, faqe 42, foto nr. 3.

¹⁴⁸ Regjistratori i Prokurorisë nr. #I, faqet 50 – 63.

184. Dhe përfundimisht, eksperti i balistikës forenzike H. K. e dha mendimin e tij më 10 maj 2016¹⁴⁹ duke filluar në atë se nëse I. kur ndodhej në pikën 4¹⁵⁰ dhe do të kishte qëlluar në veturën BMW, gëzhojat D22 dhe D23¹⁵¹ nuk do të kishin mbetur në rrugë. Pasi që arma i nxjerr gëzhojat 4 deri në 5 metra larg në anën e djathtë, gëzhojat do të kishin shkuar shumë larg në të djathtë. Prandaj, pasi ato janë gjetur afër trotuarit ato janë shtënë diku nga mesi i rrugës. Eksperti e ka shënjuar këtë pikë si “x B.”¹⁵²
185. Në ndërrimin e pretenduar të provave, të pohuar përsëri në këtë procedurë nga i pandehuri **A. G. 1** dhe avokati i tij mbrojtës, trupi gjykues i ka dëgjuar dy dëshmitar, F. L. dhe E. K.. Ata i kanë dhënë deklaratat në seancën e 29 prillit 2016. F. L. është Hetues Regjional i Departamentit të Forenzikës dhe ishte i pranishëm gjatë autopsisë së të ndjerës M. I. E. K. ishte po ashtu Hetues Regjional në Mitrovicën Jugore, në dhjetor 2009 dhe ishte përgjegjës për dhomën e provave.
186. Në bazë të deklaratave të tyre, trupi gjykues konsideron se nuk ka prova për ndërrimin e pretenduar të provave. I pandehuri **A. G.1** dhe avokati i tij mbrojtës nuk kanë paraqitur asnjë indikacion konkret se si ka mundur të ketë ndodhur ndërrimi i provave. Trupi gjykues gjeti se provat ishin mbledhur, mbyllur dhe dorëzuar në dhomën e provave sipas rregullave.
187. Në bazë të fakteve të vërtetuar më lartë dhe të gjitha provave të paraqitura, trupi gjykues vërtetoi se i pandehuri **A. G.1**, pasi që është goditur nga vetura BMW, e përcolli veturën BMW e cila vazhdoi rreth qoshes dhe ndaloi para portës së I.. Kur M. I. po dilte nga vetura, **A. G.1** qëllimisht ka qëlluar me armë-revole të llojit M57-TT me numër serik 132205, në drejtim të saj dhe e ka qëlluar M. I. në krahun e djathtë. Kjo ishte një plagë vdekjeprurëse e cila e shkaktoi vdekjen e M..

Pika 3 – Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve

¹⁴⁹ Lënda P 199/2015, faqe 13.

¹⁵⁰ Shih skicën, Regjistratori i Prokurorisë #III, faqe 34.

¹⁵¹ Shih skicën, Regjistratori i Prokurorisë #III, faqe 34.

¹⁵² Lënda P 199/2015, Prova materiale D.

188. Nën pikën 3 i pandehuri **A. G.1** është akuzuar për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328 paragrafi (2) i KPK-së
189. Në pajtim me nenin 387, paragrafi (2) i KPP-së, trupi gjykues vlerësoi me vëmendje secilën provë, i administroi gjatë shqyrtimit gjyqësor, veç e veç dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë arriti në konkluzionin se cilat fakte i konsideroi si të provuara dhe si jo të provuara.
190. Më 17 mars 2016¹⁵³ i pandehuri **A. G.1** tha se ai ndihet fajtor për posedimin e armës vetëm për atë ditë.
191. Në bazë të certifikatës për sekuestrimin e gjërave të datës 4 dhjetor 2009¹⁵⁴ trupi gjykues vërtetoi se revolja e kalibrit 7.62x25mm me numër serik “C-132205” është konfiskuar nga **A. G.1** bashkë me 1 karikator dhe 4 fishekë.
192. Prandaj, trupi gjykues vërtetoi se i pandehuri **A. G.1** e kishte në posedim revolen e tij pa kartelë autorizimi për armë.

F.2 Akuzat kundër të pandehurit S. G.

Pika 1 – Vrasje e rëndë e I. I.

193. Pas aktakuzës së ndryshuar më 13 qershor 2016, nën pikën 1 i pandehuri **S. G.** është akuzuar për Vrasje të Rëndë të I. I., në kundërshtim me nenin 147 paragrafi (1), pika 4) e KPK-së.
194. Në pajtim me nenin 387, paragrafi (2) i KPP-së, trupi gjykues vlerësoi me vëmendje secilën provë, i administroi gjatë shqyrtimit gjyqësor, veç e veç dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë arriti në konkluzionin se cilat fakte i konsideroi si të provuara dhe si jo të provuara.

¹⁵³ Lënda P 199/2015, faqe 9.

¹⁵⁴ Regjistratori i Prokurorisë nr. #II, faqet 310, 311.

Ekzistimi i çështjes së moralit në mes të familjes I. dhe familjes G. si motiv për veprën penale

195. Për t'iu shmangur përsëritjes, trupi gjykues në tërësi i referohet arsyetimit me të njëjtin titull nën kapitullin "F.1 Akuzat kundër të pandehurit **A. G.1**; pika 1 – Vrasje e Rëndë e M. I. dhe pika 2 – Vrasje e Rëndë në Tentativë e B. I."

Njohja e S. G. për ekzistimin e çështjes morale në mes të familjes I. dhe familjes G.

196. I pandehuri i **S. G.** është djali i R. G., një vëlla i M. G. i cili pretendohet se ka pasur marrëdhënie seksuale me M. I.
197. Më 2 nëntor 2011, i pandehuri **S.G.** tha¹⁵⁵ se në ditën kritike, babai i tij [R.] i përcolli **S., A.1** dhe A2. jashtë shtëpisë së babait. Kur i pandehuri shkoi te dera, komshiu I. I. ishte aty dhe I. i tha **S.** "pse ke ardhur këtu? Sepse duhesh të largohesh nga kjo shtëpi, pra merre familjen tënde dhe largohuni nga këtu." I pandehuri tha se I. e sulmoi dhe që **S.** i tha I.: "E kemi një ndërmjetësues. Babai im i ka dërguar disa ndërmjetësues te ti dhe jemi në bisedime."
198. I pandehuri tha¹⁵⁶ se ai u njoftua rreth pretendimeve të familjes I. kundër familjes **G.**, më 30 nëntor 2009, kur B. I. hyri në shtëpi dhe e kidnapoi babanë e tij [R.]. Tri ditë pas Bajramit të vogël, **S.** shkoi me J. S. te B. dhe i tha B.: "T'i lëmë këto gjëra, ti rri në shtëpinë tënde, unë po rri në shtëpinë time."
199. Më 28 maj 2013, i pandehuri **S. G.** tha ndryshe,¹⁵⁷ konkretisht se babai i tij [R.] nuk i ka thënë asnjëherë rreth problemit me familjen I.; ishte vëllai i **S.**, M. ai që i tregoi atij për atë gjë. I pandehuri tha se M. nuk e kuptoi pse; ishte diçka e pakuptueshme. **S.** gjithashtu tha se ai nuk ka besuar se M. kishte pasur marrëdhënie seksuale me M.; **S.** ka menduar se ishte shaka; ai nuk e ka marr seriozisht, nuk i ka kushtuar rëndësi kësaj.

¹⁵⁵ Lënda P 22/2010, faqe 4.

¹⁵⁶ Lënda P 22/2010, faqet 6, 7, 8.

¹⁵⁷ Lënda P 887/2013, faqe 8.

200. R. G. më 18 tetor 2011 tha¹⁵⁸ se ishte pas Bajramit kur ka ardhur B. në oborr, ka trokitur dhe ka kërkuar që R. të shkojë te shtëpia e B. në Bair. Kur është kthyer R., ai e ka thirr S. dhe ia ka treguar të gjitha; R. i tregoi S. se çfarë kishte ndodhur deri atëherë. R. pastaj ka shkuar ta merr J. S.; ata janë kthyer në “oda”, në dhomën e mysafirëve, dhe S. shkoi te B. dhe e solli edhe B. te R.. Pas bisedës që të gjithë e patën, S. i dërgoi B. dhe J. te shtëpia e B. dhe pastaj S. shkoi bashkë me R. në polici dhe e paraqiten rastin.
201. Në bazë të mësipërmes, trupi gjykues konsideron se S. G. ishte plotësisht në dijeni dhe kishte njohuri për ekzistimin e çështjes së moralit në mes të familjes I. dhe familjes G..

Prania e personave në shtëpinë e R. G. dhe shtëpinë e I. I. më 4 dhjetor 2009 para se të ndodhnin vrasjet

202. Për t’iu shmangur përsëritjes, trupi gjykues në tërësi i referohet arsyetimit me të njëjtin titull nën kapitullin “F.1 Akuzat kundër të pandehurit A. G.1; pika 1 – Vrasje e Rëndë e M. I. dhe pika 2 – Vrasje e Rëndë në Tentativë e B. I..”

Fillimi i grindjeve në mes të anëtarëve të familjes G. dhe I. më 4 dhjetor 2009 para se të ndodhnin vrasjet

203. Për t’iu shmangur përsëritjes, trupi gjykues në tërësi i referohet arsyetimit me të njëjtin titull nën kapitullin “F.1 Akuzat kundër të pandehurit A. G.1; pika 1 – Vrasje e Rëndë e M. I. dhe pika 2 – Vrasje e Rëndë në Tentativë e B. I..”

Kthimi i B. dhe M. me veturën e kuqe BMW, dhe fillimi i të shtënave

¹⁵⁸ Lënda P 22/2010, faqet 4, 5.

204. Për t'iu shmangur përsëritjes, trupi gjykues në tërësi i referohet arsytimit me të njëjtin titull nën kapitullin “F.1 Akuzat kundër të pandehurit **A. G.1**; pika 1 – Vrasje e Rëndë e M. I. dhe pika 2 – Vrasje e Rëndë në Tentativë e B. I.” dhe shton si në vijim.
205. Më 2 nëntor 2011, i pandehuri **S.G.** tha¹⁵⁹ se gjatë bisedimeve në mes të personave të cilët kanë mbetur te vendi, erdhi B. me veturën BMW. B. e shtypi gazin në rrugën me zhavorr dhe u drejtua në drejtim të grupit me njerëz dhe e goditi tërë grupin; ata ikën në trotuar për t'u larguar; vetura BMW e goditi **A.1** dhe e mbështeti për muri; vetura e preku edhe **S.** pak. **S.** tha se ai u gjuajt në të majtë, ku kishte pak baltë; ai ra pak në të. Në ato momente **S.** i dëgjoi të shtënat që u shkrepën; ai [**S.**] e pa xhamin e pasagjerit të hapur dhe e pa I. shumë mirë që po qëllonte në drejtim të veturës.
206. Më 28 maj 2013, i pandehuri **S. G.** tha¹⁶⁰ se ai u largua në anën e djathtë të rrugës kur e pa që vetura BMW u kthye; **A. G.2** e kapi **R. G.** dhe shkuan ka hyrja e vogël; pastaj vetura e goditi **A.1**, dhe e shtypi **A.1** për muri. **S.** e pa **A.1** nën veturë dhe ai [**S.**] i dëgjoi të shtënat me armë në atë moment. Kur **S.** e ktheu kokën për të parë, ai e pa I. që qëllonte me një armë dore. Në të njëjtën seancë i pandehuri **S. G.** gjithashtu tha¹⁶¹ se I. po rrinte tek numri 4¹⁶² ndërsa ai po qëllonte në veturën BMW.

Vrasja e I. I.

207. Për t'iu shmangur përsëritjes, trupi gjykues i referohet gjithashtu arsytimit më lartë me titujt “*Vrasja në tentativë e B. I.*” dhe “*Vrasja e M. I.*” nën kapitullin “F.1 Akuzat kundër të pandehurit **A. G.1**; pika 1 – Vrasje e Rëndë e M. I. dhe pika 2 – Vrasje e Rëndë në Tentativë e B. I.” me shtesë si në vijim.

¹⁵⁹ Lënda P 22/2010, faqe 5.

¹⁶⁰ Lënda P 887/2013, faqe 6.

¹⁶¹ Lënda P 887/2013, faqe 18.

¹⁶² Shih skicën, Regjistratori i Prokurorisë #III, faqe 34.

208. Dëshmitari F. K. më 18 tetor 2011 ka theksuar¹⁶³ se ai kishte parë veturën BMW që kishte goditur një person, të parruar, me mjekër dhe të identifikuar si **A. G.1**. Kur vetura BMW ishte futur një rrugë të ngushtë, K. dhe kolegu i tij I. po mundoheshin të ndalonin dhe të dilnin nga vetura. Në atë moment ishin dëgjuar disa të shtëna armësh. Pas gjuajtjes së parë, një person ishte rrëzuar në tokë. K. nuk kishte mundur të shihte drejtimin e gjuajtjeve dhe ai [K.] nuk kishte vërejtur asnjë armë kur ky person ishte rrëzuar. K. tregoi numrin 4 në këtë skicë¹⁶⁴ ku ai person ishte rrëzuar. Më 21 maj 2013, F. K. kishte përsëritur¹⁶⁵ deklaratën e tij të mëhershme.
209. Dëshmitari R. I. më 18 tetor 2011¹⁶⁶ dhe 23 maj 2013¹⁶⁷ ka theksuar se derisa ai po hapte derën për të dalë nga vetura e policisë, ai dëgjoi të shtëna armësh dhe kishte parë njërin nga njerëzit që qëndronte brenda grupit të binte përtokë. Kur I. më pas iu afrua vendit të ngjarjes, ai pa atë personin që ishte shtrirë përmbys.
210. Dëshmitari R. G. më 18 tetor 2011 ka theksuar¹⁶⁸ se ai kishte kapur kokën e tij pasi që **A.1** ishte goditur nga një veturë dhe se ai nuk e di se çfarë kishte ndodhur pastaj. Kur R. kishte ardhur aty pari, ai kishte parë se çfarë kishte ndodhur dhe R. kishte parë se I. ishte vrarë diku aty. Më 21 maj 2013, R. G. ka theksuar¹⁶⁹ se ai kishte marrë vesh për të shtënat dhe se I. I. dhe M. I. ishin vrarë vetëm pasi që policia e kishte marrë atë.
211. Kur **A. G.2** ishte marrë në pyetje si dëshmitar më 5 shkurt 2015, ai kishte thënë¹⁷⁰ se menjëherë sapo kishte dal te porta, ai kishte parë trupin tjetër të shtrirë në anën e djathtë ndërsa **A.1** ishte në anën e majtë aty ku **A.1** ishte goditur nga një veturë. **A.2** kishte përsëritur këtë deklaratë më 23 mars 2016.¹⁷¹
212. **A. G.1** kishte dhënë deklaratë më 4 mars 2015 dhe 13 qershor 2016. Më 4 mars 2015 **A.1** kishte deklaruar¹⁷² se ai kishte dëgjuar të shtënat derisa ishte i shtrirë përtokë dhe ai gjithashtu kishte parë I. me të dy duart e tij në gjoksin e tij; I. po binte në gjunjë

¹⁶³ Lënda P 22/2010, faqet 34, 36, 39, 45.

¹⁶⁴ Shih Skicën, Regjistratorin e Prokurorisë #III, faqe 34.

¹⁶⁵ Lënda P 887/2013, faqet 33, 34, 35.

¹⁶⁶ Lënda P 22/2010, faqet 49, 51.

¹⁶⁷ Lënda P 887/2013, faqet 7, 12.

¹⁶⁸ Lënda P 22/2010, faqet 13, 17.

¹⁶⁹ Lënda P 887/2013, faqja 11.

¹⁷⁰ Lënda P 68/2014, faqe 10.

¹⁷¹ Lënda P 199/2015, faqe 57.

¹⁷² Lënda P 887/2013, faqe 12.

dhe po rrëzohej poshtë. **A. G.1** gjithashtu kishte deklaruar se **S.** dhe **A.2** ishin shumë afër **I.** dhe **A.1** e kishte parë **A.2** që ia kishte vënë revolen **I.** në kokë dhe kishte shtënë dy herë në **I.** Më 13 qershor 2016, **A.1** kishte përsëritur deklaratën e mëhershme.¹⁷³

213. I pandehuri **S.G.** kishte dhënë deklaratën e parë më 2 nëntor 2011. Ai ka deklaruar¹⁷⁴ se vetura **BMW** e kishte goditur **A.1** dhe e kishte mbështetur atë për muri. Vetura e kishte prekur **S.** vetëm pak; **S.** kishte kërcyer në të majtë dhe kishte rënë paksa në dhe. Në ato momente **S.** kishte dëgjuar të shtëna nga arma. **S.** e kishte parë **I.** duke shtënë në drejtim të veturës; dritarja anash e pasagjerit ishte e hapur. Pastaj **I.** e kishte drejtuar armën drejt **S.**; por plumbi kishte ngecur në armë. Deri në momentin kur **I.** e karrikoi armën e tij dhe e futi plumbin tjetër në tyt, **S.** ishte detyruar të nxirrte armën e tij dhe ai ka shtënë në drejtim të **I.** **S.** nuk e din se sa herë kishte shtënë ai në trupin e **I.**

214. I pandehuri **S. G.** kishte dhënë deklaratën pasuese më 28 maj 2013. **S.** kishte thënë¹⁷⁵ se ai e kishte parë **A.1** i cili ishte futur nën veturë kur ishte qëlluar. Në atë moment **S.** kishte dëgjuar të shtëna dhe kur e kishte kthyer kokën për të shikuar, **S.** kishte parë **I.** që qëllonte prej armës së tij. Pasi që **S.** ishte frikësuar dhe pasi që kishte armën e tij në xhep, ai ishte detyruar në atë moment të shtinte. **S.** kishte deklaruar se ai këtë e kishte bërë pa qëllim dhe nga frika për të mbrojtur veten, babanë dhe kushërinjtë e tij. **S.** theksoi se **I.** kishte një armë në dorën e tij; **S.** hoqi atë armë nga dora e **I.** dhe e shty më tutje.

215. I pandehuri deklaroi¹⁷⁶ se **I.** kishte shtënë 3 – 4 herë në veturën **BMW**, gjersa vetura ishte duke kaluar dhe se **I.** qëndronte afër numrit 4¹⁷⁷ në momentin që ai po shtinte. **S.** gjithashtu ka deklaruar se **I.** kishte shtënë në veturë gjersa vetura po e shtypte **A.1** për muri. Kur vetura vazhdoi tutje dhe ishte duke u kthyer në të majtë, **I.** e drejtoi armën drejt **S.** dhe atëherë **S.** qëlloi në **I.**

216. Sikurse ka konstatuar tanimë trupi gjykues në Kreun me titullin “*Tentim vrasja e B. I.*” nën kreun “*F.1 Akuzat kundër të pandehurit A. G.1; Pika 1 – Vrasja e rëndë e M. I. dhe Pika 2 – Vrasja e rëndë në tentativë e B. I.*”, deklaratat e **S. G.** nuk kishin qenë në

¹⁷³ Lënda P 199/2015, faqet 13, 16.

¹⁷⁴ Lënda P 22/2010, faqet 5, 6.

¹⁷⁵ Lënda P 887/2013, faqe 6.

¹⁷⁶ Lënda P 887/2013, faqet 18, 19, 20, 21.

¹⁷⁷ Shih Skicën, Regjistratori i Prokurorisë #III, faqe 34.

përputhje me njëra tjetrën. Trupi gjykues ka konstatuar se ato nuk janë të besueshme dhe bindëse.

217. Është konstatuar se kur vetura BMW ishte kthyer përsëri dhe i ishte afruar grupit të njerëzve të cilët qëndronin anash rrugës; **A.1** kishte dal në anën e majtë ku vetura e kishte goditur atë, ndërsa **I.** dhe **S.** kishin dal në anën e djathtë të rrugës.
218. Vetëm **S. G.** kishte deklaruar¹⁷⁸ se **I. I.** kishte qenë në posedim të armës; asnjë dëshmitarë tjetër nuk e kishte konfirmuar deklaratën e **S.**; në fakt dëshmitarët theksuan se ata nuk e kishin parë **I.** me armë në duar.
219. I pandehuri **S. G.** kishte pasur mospërputhje në deklaratat e tij. Më 2 nëntor 2011, **S.** kishte thënë¹⁷⁹ dhe se arma që kishte **I.** në dorën e tij kishte rënë afër **A.1** kur **I.** ishte rrëzuar. Në seancën e njëjtë më vonë¹⁸⁰ **S.** kishte deklaruar se ai [**S.**] e kishte shqelmuar tutje armën e **I.** kur **I.** ishte qëlluar dhe kishte rënë në tokë. Më 28 maj 2013 **S. G.** kishte theksuar¹⁸¹ se ai kishte larguar armën nga dora e **I.** duke e hedhur më tutje atë.
220. Dëshmitarët gjithashtu kanë dëshmuar se **I. I.** kishte vendosur duart e tij në gjoksin e tij, së pari kishte rënë në gjunjë dhe pastaj në tokë. Ky fakt vërtetohet gjithashtu bazuar në fotot nr. 27, 28, 29, 30 dhe 32 nga Foto Albumi¹⁸² të cilat tregojnë pozitën e **I. I.** të shtrirë në gjoksin e tij dhe duart e tij nën trupin e tij.
221. Dhe në fund, eksperti i forenzikës balistike **H. K.** kishte dhënë mendimin e tij më 10 maj 2016¹⁸³ duke theksuar se arma i hedh gëzhojat 4 deri në 5 metra tutje në anën e djathtë. Nëse **I.**, derisa qëndronte në pikën 4,¹⁸⁴ me të vërtetë do kishte shtënë në veturën BMW, gëzhojat D22 dhe D23¹⁸⁵ nuk do të kishin mbetur aspak në rrugë por do të kishin dal shumë larg në të djathtë. Prandaj, pasi që ato ishin gjetur afër trotuarit ato janë shkrepur diku nga mesi i rrugës, të shënjuar nga eksperti **K.** me “x B”.¹⁸⁶
222. Bazuar në atë që u tha më lartë, trupi gjykues konstatoi se **I. I.** nuk kishte armë dhe se **I.** nuk kishte përdorur asnjë armë për të shtënë në veturën BMW.

¹⁷⁸ P 887/2013, faqet 6, 17, 18, 19, 20.

¹⁷⁹ Lënda P 22/2010, faqet 6, 12, 13, 14, 15.

¹⁸⁰ Lënda P 22/2010, faqe 16.

¹⁸¹ Lënda P 887/2013, faqe 6.

¹⁸² Regjistratori i Prokurorisë #II, faqet 38 – 40.

¹⁸³ Lënda P 199/2015, faqe 13.

¹⁸⁴ Shih Skicën, Regjistratori i Prokurorisë #III, faqe 34.

¹⁸⁵ Shih Skicën, Regjistratori i Prokurorisë #III, faqe 34.

¹⁸⁶ Lënda P 199/2015, Prova materiale D.

223. Eksperti i mjekësisë ligjore T. G. dhe eksperti i forenzikës balistike H. K. në opinionin e tyre të datës 22 prill 2016 kanë vërtetuar se I. I. ishte qëlluar gjersa po qëndronte nga dy drejtime; nga ana e majtë dhe nga ana e djathtë; ndërsa plagët e shkaktuara në anën e tij të djathtë janë më serioze dhe nga një distancë 70 – 80 cm.
224. Bazuar në Raportin e Obduksionit të datës 15 dhjetor 2009¹⁸⁷ mund të konstatohet se i ndjeri I. I. kishte marrë tetë (8) plagë nga të shtënat e armës; katër (4) plagë hyrëse nga të shtënat e armës dhe katër (4) plagë dalëse nga të shtënat e armës. Plaga hyrëse numër 1 ndërlidhet me plagën dalëse numër 2, plaga hyrëse numër 3 ndërlidhet me plagën dalëse numër 4, plaga hyrëse numër 5 ndërlidhet me plagën dalëse numër 6, dhe plaga hyrëse numër 7 ndërlidhet me plagën dalëse numër 8. I. I. kishte marrë plagë në anën e djathtë të kokës, anën e majtë të qafës, anën e djathtë të gjoksit, dhe në dorën e tij të majtë, dhe kishte vdekur në vend për shkak të shokut hemorragjik të shkaktuar nga plagët nga të shtënat e armës.
225. I pandehuri S. G ka pranuar se ai ka shtënë në I. I.; edhe pse S. ka deklaruar se ai ka shtënë në I. I. në mbrojtje të nevojshme.
226. Megjithatë, bazuar në vlerësimin e të gjitha provave të dorëzuara, trupi gjykues ka konstatuar se nuk kishte qenë vetëm i pandehuri S. G. i cili kishte shtënë në I. I. dhe se në të njëjtën kohë një person tjetër kishte shtënë në drejtim të tij dhe e kishte goditur I. I..
227. Së pari, dëshmitari B. I. dhe i pandehuri A. G.1 kanë theksuar se ata e kanë parë A.2 të kishte qëlluar I. I. kur I. kishte rënë në gjunjë. Dhe së dyti, të gjeturat e ekspertëve të angazhuar vërtetojnë faktin se I. I. ishte qëlluar nga dy drejtime.

Pika 2 – Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve

228. Nën pikën 2 i pandehuri S. G. ishte akuzuar për Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328 paragrafi (2) të KPK-së.

¹⁸⁷ Regjistratori i Prokurorisë #I, faqet 95 – 115.

229. Sipas nenit 387, paragrafi (2) të KPP-së, trupi gjykues ka vlerësuar në mënyrë të ndërgjegjshme secilin artikull të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në veçanti dhe në ndërlidhje me artikujt e tjerë të provave dhe mbi bazën e një vlerësimi të tillë ka nxjerr konstatimin se cilat fakte i konsideron të provuara dhe cilat jo.
230. Më 17 mars 2016¹⁸⁸ i pandehuri **S. G.** ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale.
231. Bazuar në Certifikatën mbi sendet e konfiskuara të datës 4 dhjetor 2009¹⁸⁹, trupi gjykues ka konstatuar se pistoleta e kalibrit 7.62x25mm e tipit TT me numër serik 967473766-1964 i ishte konfiskuar **S. G.** së bashku me 1 fishek në fole të pistoletës dhe 4 në karikator.
232. Prandaj, trupi gjykues konstatoi se i pandehuri **A. G.1** ishte në posedim të kësaj pistolete pa pasur një leje të vlefshme që autorizonte mbajtjen e kësaj arme.

G. ARSYETIMI LIGJOR

G.1 Akuzat kundër të pandehurit A. G.1

Pika 1 – Vrasje e rëndë e M. I. dhe Pika 2 – Vrasje e rëndë në tentativë e B. I.

233. I pandehuri **A. G.1** ishte akuzuar pas ndryshimit të aktakuzës sipas Pikës 1 për kryerje të veprës penale të Vrasjes së rëndë të M. I., në kundërshtim me nenin 147, pikën 4) të KPK-së dhe sipas Pikës 2 për kryerjen e veprës penale të Vrasjes së rëndë në tentativë, në kundërshtim me nenin 147, Pikën 4) të KPK-së.
234. Neni 147 paragrafi (1), pika 4) e KPK-së parasheh:
Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:
 [...] 4) Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave; [...]
235. Prokuroria argumenton se incidenti ka ndodhur në mëngjes; se ‘ne të gjithë e dimë se ka njerëz shumë afër vendit të incidentit’; se R. G. ka thënë se një shitës në dyqanin e afërt i kishte bërë titur atyre të bënin kujdes; se dëshmitari I. kishte deklaruar se

¹⁸⁸ Lënda P 199/2015, faqe 8.

¹⁸⁹ Regjistrotori i Prokurorisë nr. #II, faqet 302, 303.

dy zyrtarë police me rroba civile qëlluan atypari; dhe se F. I. dhe M. G. ishin brenda shtëpive të tyre. Prokuroria pretendon se të gjithë këta persona ishin në rrezik potencial që të goditeshin ose nga plumbat direkt ose nga ata qorr.

236. Së pari, trupi gjykues nuk kishte gjetur se elementi objektiv i kësaj vepre penale është dëshmuar, domethënë se jeta e njërit apo më shumë personave ishte rrezikuar.

237. Kur **A.1** kishte shtënë në veturë dhe në B. I., vetëm jeta e M. I. mund të rrezikohej; por menjëherë më pastaj **A. G.1** kishte shtënë në M. I. dhe ky element (rrezikimi) nuk kishte ekzistuar më pasi që një vepër tjetër penale ishte kryer kundër M..

238. Dhe kur **A. G.1** kishte shtënë në M. I., asnjë jetë tjetër nuk ishte rrezikuar pasi që përveç **A.1**, **S. G.**, **A. G.2** dhe **R. G.** nuk kishte asnjë person tjetër të pranishëm.

239. Trupi gjykues gjithashtu thekson se një rrezik i tillë duhet të jetë konkret dhe jo abstrakt; dhe se në rastin në fjalë rreziku konkret nuk kishte ekzistuar.

240. Është e vërtetë se dëshmitari K. më 18 tetor 2011 kishte theksuar¹⁹⁰ se ai kishte vërejtur poshtë rrugës dy persona në rrugën e asfaltuar; por K. kishte parë këta persona kur të shtënat tanimë kishin ndaluar dhe K. dhe I. tashmë kishin prangosur të pandehurit. K. gjithashtu ka thënë se ai nuk i kishte parë ata më parë dhe se kolegu i tij I. i kishte parë ata; ata ishin polic në rroba civile dhe i ofruan K. dhe I. ndihmë pasi që ata i kishin prezantuar kartelat identifikuese të policisë.

241. Për sa i përket F. I. dhe M. G., ato kishin qenë brenda shtëpive të tyre dhe nuk ishin të pranishme afër incidentit.

242. Prandaj, bazuar në provat e administruara dhe siç arsyetohet në detaje në këtë aktgjykim deri tani, trupi gjykues gjeti se i pandehuri **A. G.1** kishte kryer dy vepra penale:

- Veprën penale të *Vrasjes në tentativë të B. I.*, në kundërshtim me nenin 146 të KPK-së lidhur me nenin 20 të KPK-së; dhe
- Veprën penale të *Vrasjes së M. I.*, në kundërshtim me nenin 146 të KPK-së.

243. Neni 146 i KPK-së parasheh:

“Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta [...]”

¹⁹⁰ Lënda P 22/2010, faqe 38.

244. Neni 20 i KPK-së parasheh:

“Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar [...]”

245. Dhe neni 147, pika 11) e KPK-së parasheh:

*Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:
[...] 11) Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, [...]”*

246. Trupi gjykues gjeti se elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të Vrasjes në Tentativë të B. I., janë përmbushur.

247. I pandehuri **A. G.1** kishte drejtuar armën drejt veturës BMW para se ai **[A.1]** të goditej dhe pastaj kishte shtënë në veturën BMW e cila vozitej nga B. I. Veprimet e të pandehurit **A. G.1** të arsyetuara në detaje në këtë aktgjykim dëshmojnë se **A. G.1** kishte vepruar me dashje direkte për të privuar nga jeta B. I. B. I. ishte qëlluar në dorën e tij të majtë duke pësuar kështu lëndim trupor. B. I. nuk kishte vdekur; prandaj, vepra penale e vrasjes nuk ishte realizuar.

248. I pandehuri **A.G.1** ishte plotësisht i aftë mendërisht kur kishte kryer veprën. Ai kishte përdorur armën dhe me dashje kishte shtënë në B. I..

249. Bazuar në të gjeturat e ekspertit mjekësor, i pandehuri **A. G.1** nuk ka pësuar tronditje të rëndë të trurit dhe as nuk është përcaktuar kjo në dokumentacionin mjekësor.¹⁹¹ Nuk ekzistojnë rrethanat që do të përjashtonin përgjegjësinë e tij penale sipas nenit 18 dhe/ose nenit 19 të KPK-së.

250. Lidhur me veprën penale të Vrasjes së M. I., trupi gjykues gjeti se elementet objektiv dhe subjektiv janë përmbushur.

251. I pandehuri **A. G.1** mund të ecte dhe ai kishte ecur pasi që ishte goditur nga vetura BMW. I tërë dokumentacioni mjekësor, të gjeturat e ekspertit të balistikës dhe atij mjekësor si dhe CT vërtetojnë se i pandehuri **A. G.1** nuk kishte pësuar asnjë thyerje dhe ishte në gjendje të ecte.

252. I pandehuri **A. G.1** ishte në këmbë kur, polici i parë K. e pa atë dhe pastaj kur polici i dytë I. e vuri atë nën kontroll. **A. G.1** ndjeku pas veturën BMW; shtiu në drejtim të M. I. derisa ajo dilte nga vetura, dhe e qëllloi M. I. në dorën e djathtë dhe i shkaktoi

¹⁹¹ Lënda P 199/2015, Raporti mjekësor i datës 29 dhe 30 prill 2016, Regjistratori i gjykatës Vëllimi #II, Fashikulli nr.8.

plagë vdekjeprurëse. Përmes veprimeve të tilla siç arsyetohen në detaje në këtë aktgjykim, ka vepruar me dashje direkte për të privuar nga jeta M. I..

253. I pandehuri **A. G.1** kishte qenë plotësisht i aftë mendërisht kur kishte kryer veprën; nuk ka asgjë në dosjen e lëndës që do të sugjeronte të kundërtën. Nuk ka rrethana që do të përjashtonin përgjegjësinë penale të të pandehurit sipas nenit 18 dhe/ose nenit 19 të KPK-së.

254. Për kryerjen e dy veprave penale, veprën penale të Vrasjes në tentativë të B. I. dhe veprës penale të Vrasjes së M. I. trupi gjykues ka dënuar të pandehurin **A. G.1** për kryerjen e veprës penale të *Vrasjes së rëndë në tentativë*, në kundërshtim me nenin 147, Pika 11) të KPK-së lidhur me nenin 20 të KPK-së.

255. Prandaj, trupi gjykues e kishte ri-kualifikuar pikën 1 dhe pikën 2. Pika 1 e aktakuzës për Vrasje të rëndë, në kundërshtim me nenin 147, pika 4) dhe Pika 2 e aktakuzës për Vrasje të rëndë në tentativë, në kundërshtim me nenin 147, pika 4) e KPK-së.

Pika 3 - Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve

256. Në Pikën 3, i pandehuri **A. G.1** ishte akuzuar për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328 paragrafin (2) të KPK-së.

257. Neni 328 paragrafi (2) të KPK-së parasheh:

[...]Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet. [...]

258. Është vërtetuar se i pandehuri ka përdorur armën për të cilën ai nuk ka pasur autorizim.

259. I pandehuri **A. G.1** ka theksuar se ai ndjehet fajtor për posedimin e armës në atë ditë kritike. Ai kishte dëshmuar se përndryshe ai nuk kishte qenë asnjëherë në posedim të armës.

260. Pasi që i pandehuri **A. G.1** kishte qenë në posedim të armës pa leje përkatëse, trupi gjykues gjeti se elementet objektiv dhe subjektiv të kësaj vepre penale janë përmbushur.

261. I pandehuri kishte kërkuar dashjen dhe kishte qenë plotësisht i aftë mendërisht kur kishte kryer veprën; si dhe nuk ekzistojnë rrethanat të cilat do të përjashtonin përgjegjësinë e tij penale në përputhje me nenin 18 dhe/ose nenin 19 të KPK-së.

G.2 Akuzat ndaj të pandehurit S. G.

Pika 1 – Vrasje e rëndë e I. I.

262. I pandehuri **S. G.** ishte akuzuar pas aktakuzës së ndryshuar sipas Pikës 1 për kryerjen e veprës penale të Vrasjes së rëndë të I. I., në kundërshtim me nenin 147, Pika 4) të KPK-së.

263. Neni 147 paragrafi (1), pika 4) të KPK-së parasheh:

Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:

[...] 4) Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave; [...]

264. Sa i përket të pandehurit **A. G.1**, për të pandehurin **S. G.** njësoj, Prokuroria ka pretenduar në aktakuzë se jetët e personave të tjerë ishin rrezikuar. Prokuroria ka pretenduar se incidenti kishte ndodhur në mëngjes; se ‘të gjithë ne e dimë se ka njerëz shumë afër vendit të incidentit’; se R. G. ka thënë se një shitës në një dyqan të afërt i kishte bërtitur atyre që të bënin kujdes; se dëshmitari I. kishte thënë se dy policë me rroba civile kishin rastisur të qëllonin atypari; se F. I. dhe M. G. ishin brenda shtëpive të tyre. Ishte argumenti i Prokurorisë se të gjithë këta persona ishin në rrezik potencial që të qëlloheshin nga plumbat direkt ose plumbat qorr.

265. Trupi gjykues nuk e kishte gjetur të dëshmuar elementin objektiv të kësaj vepre penale, pra se jeta e njërit apo më shumë personave ishte rrezikuar. Kur **S.** e kishte qëlluar I. I., asnjë jetë tjetër nuk ishte rrezikuar pasi që përveç **S.**, **A. G.1**, **A. G.2** dhe **R.G.** të cilët ishin pjesëmarrës në incident, asnjë person tjetër nuk ishte i pranishëm; prandaj rreziku konkret nuk kishte ekzistuar në rastin në fjalë.

266. Siç është potencuar nga trupi gjykues tashmë, dëshmitari K. më 18 tetor 2011 ka theksuar¹⁹² se ai kishte vërejtur poshtë rrugës dy njerëz në rrugën e asfaltuar; por ai i kishte parë ata kur të shtënat tashmë ishin ndalur dhe K. dhe I. tashmë kishin prangosur të pandehurit. K. gjithashtu kishte deklaruar se ai nuk i kishte parë ata më parë dhe se kolegu i tij I. i kishte parë; ata ishin policë në rroba civile dhe se i kishin ofruar K. dhe I. ndihmë. Për sa i përket F. I. dhe M. G., ato ishin brenda shtëpive të tyre dhe jo të pranishme në afërsi të incidentit.
267. Prandaj, bazuar në provat e administruara dhe siç arsyetohet në detaje deri më tani, trupi gjykues konstatoi se i pandehuri **S. G.** ka kryer veprën penale të Vrasjes së I. I., në kundërshtim me nenin 146 të KPK-së.
268. Neni 146 i KPK-së parasheh:
“Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta [...]”
269. Të gjeturat e ekspertëve të balistikës dhe atij mjekësor dëshmojnë se I. I. kishte pësuar plagë në anën e djathtë të kokës, anën e majtë të qafës, anën e djathtë të gjoksit, dhe në dorën e tij të majtë, dhe I.I. kishte vdekur në vend për shkak të shokut hemorragjik të shkaktuar nga plagët nga të shtënat e armës.
270. Bazuar në opinionin e ekspertëve trupi gjykues ka konstatuar se nuk kishte qenë vetëm i pandehuri **S.G.** i cili kishte shtënë në I. I. dhe se njëkohësisht një person tjetër kishte shtënë në drejtim të I. I. dhe e kishte qëlluar atë.
271. Neni 23 i KPK-së e përkufizon bashkëkryerjen me sa vijon:
“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.”
272. I pandehuri **S. G.** e ka pranuar se ai kishte qëlluar I. I.. Trupi gjykues ka konstatuar se ai aktivisht kishte marrë pjesë në kryerjen e veprës penale së bashku me një person tjetër.
273. **S. G.** dhe një person tjetër e kishin qëlluar I. I.; kontributi i të pandehurit **S.** dhe kontributi i një personi tjetër kishin ndikim të ngjashëm dhe rezultati i këtyre veprimeve ishte vdekja e I. I..

¹⁹² Lënda P 22/2010, faqe 38.

274. Trupi gjykues gjeti se elementet objektiv dhe subjektiv të veprës penale të vrasjes së I. I., janë përmbushur.
275. Veprimet e të pandehurit **S. G.** që arsyetohen në detaje në këtë aktgjykim dëshmojnë se **S. G.** kishte vepruar me dashje direkte për të privuar nga jeta I. I..
276. I pandehuri **S. G.** ka theksuar se ai kishte qëlluar I. I. në mbrojtje të nevojshme pasi që I. I. kishte shtënë drejt veturës BMW; pastaj I. ishte kthyer drejt **S.** dhe në atë moment **S. G.** me qëllim që të mbroj jetën e tij ishte më i shpejtë dhe kishte qëlluar I..
277. Për sa i përket mbrojtjes së nevojshme, neni 8 i KPK-së parasheh:
*“[...] (2) Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atqasshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.
 (3) Disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.”*
278. Trupi gjykues gjeti se i pandehuri duke e qëlluar I. I. nuk e ka kryer veprën në mbrojtje të nevojshme, **S. G.** me dashje ka qëlluar I. I..
279. Trupi gjykues tashmë ka arsyetuar në detaje në këtë aktgjykim se para se gjithash, I. I. nuk kishte qenë në posedim të armës dhe prandaj I. nuk kishte qëlluar në veturën BMW. Vetëm **S. G.** kishte thënë se I. I. kishte qenë në posedim të armës. Asnjëri nga dëshmitarët nuk e kishin pohuar deklaratën e **S.**; në fakt dëshmitarët kishin theksuar se ata nuk e kishin parë I. me armë në duar.
280. Gjithashtu, i pandehuri **S. G.** kishte pasur mospërputhje në deklaratat e tij. Ai kishte thënë se arma që I. kishte në dorë kishte rënë afër **A.1** kur I. ishte rrëzuar përtokë; më vonë, në seancën e njëjtë, **S.** kishte thënë se ai [**S.**] e kishte shkelmuar armën e I. tutje kur I. ishte qëlluar dhe kishte rënë përtokë; dhe në dëshminë e tij të fundit, **S.** kishte theksuar se ai kishte larguar tutje armën nga dora e I..
281. Deklaratat e **S.** janë në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve të cilët kanë deklaruar se I. së pari kishte vendosur duart e tij në gjoksin e tij, kishte rënë në gjunjë dhe pastaj ishte rrëzuar në tokë. I. ishte shtrirë përmbys në gjoks me duar nën trupin e tij kur polici kishte ardhur në vendngjarje dhe kjo vërtetohet gjithashtu nga fotot e bëra gjatë ekzaminimit penal.

282. Trupi gjykues konstatoi se I. I. nuk ishte në posedim të ndonjë arme në ditën kritike; I. nuk kishte qëlluar mbi veturën BMW dhe I. nuk e kishte drejtuar armën në të pandehurin S. G.; prandaj, rrethanat për mbrojtje të nevojshme nuk ekzistojnë.
283. Trupi gjykues gjeti se elementet subjektiv të veprës penale janë përmbushur. I pandehuri S. G. penalisht është përgjegjës për veprimet e tij; ai është mendërisht i aftë dhe ka kryer veprën penale me dashje. Nuk ekzistojnë rrethanat të cilat do të përjashtonin përgjegjësinë e tij penale në përputhje me nenin 18 dhe/ose nenin 19 të KPK-së.
284. Prandaj, trupi gjykues e ka ri-cilësuar pikën 1 nga akuza për Vrasje të rëndë, në kundërshtim me nenin 147, pika 4) të KPK-së dhe ka dënuar të pandehurin S. G. për kryerjen e veprës penale të Vrasjes, në kundërshtim me nenin 146 të KPK-së në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

Pika 2 – Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve

285. Në Pikën 3, i pandehuri S. G. ishte akuzuar për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) të KPK-së.
286. Neni 328, paragrafi (2) i KPK-së parasheh:
[...]Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet. [...]
287. Është vërtetuar se i pandehuri ka përdorur armën për të cilën ai nuk ka pasur autorizim.
288. I pandehuri S. G. ka pranuar se ai kishte qenë në posedim të armës; ai e mbante atë vetëm kur shkonte në punë për vetëmbrojtje. Gjithashtu gjatë dëshmisë së tij ai kishte deklaruar se në atë ditë ai kishte harruar ta linte armën në shtëpi siç bënte zakonisht kur vinte nga puna.
289. Pasi që i pandehuri ishte në posedim të një arme pa leje përkatëse, trupi gjykues gjeti se elementet objektiv dhe subjektiv të kësaj vepre penale janë përmbushur.

290. I pandehuri ka kërkuar dashjen dhe ishte plotësisht i aftë mendërisht kur kishte kryer veprën; si dhe nuk ekzistojnë rrethanat të cilat do të përjashtonin përgjegjësinë e tij penale në përputhje me nenin 18 dhe/ose nenin 19 të KPK-së.

H. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

H.1 Akuzat ndaj të pandehurit A. G. 1

291. Sipas nenit 73 të KPRK-së dhe ngjashëm nenit 64 të KPK-së, Gjykata përcakton dënimin për veprën penale brenda kufijve të paraparë me ligj për një veprë të tillë penale, duke marr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara me ligj dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin, në veçanti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryesit, pranimin e fajit dhe rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit.

292. KPRK-ja në paragrafët (2) dhe (3) të nenit 74 numëron rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat merren parasysh kur bëhet caktimi i dënimit por shprehimisht thekson se rrethanat e tilla të përmendura nuk janë të kufizuara por përfshijnë edhe rrethana të tjera. KPK-ja nuk e kufizon shprehimisht se çfarë mund të konsiderohet si rrethanë rënduese apo lehtësuese.

293. Bazuar në këtë, kur ka bërë përcaktimin e dënimit, trupi gjykues ka marrë parasysh rrethanat rënduese vijuese. I pandehuri **A. G.1** kishte qëlluar disa herë; të dy viktimat, B. I. dhe M. I. gjersa ata ishin të cënueshëm dhe pa mbrojtje.

294. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues ka marrë parasysh kohëzgjatjen e procedurës, pasi që vepra penale është kryer në vitin 2009 dhe kohën që i pandehuri **A. G.1** ka kaluar në paraburgim. Megjithatë, rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale mbartin një barrë aq

- të rëndë sa që trupi gjykues nuk ka mundur të gjente ndonjë arsye për të shqiptuar një dënim më të vogël.
295. Sipas nenit 3, paragrafi (1) të KPRK-së dhe ngjashëm sipas nenit 2, paragrafi (1) të KPK-së, ligj në fuqi gjatë kohës kur është kryer vepra penale zbatohet ndaj kryesit.
296. I pandehuri **A. G.1** ishte dënuar për veprat penale sipas pikës 1 dhe pikës 2, dhe pikës 3. Ai kishte kryer veprat penale kur ligj në fuqi ishte KPK-ja, i cili kishte hyrë në fuqi më 6 prill 2004 me emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe ishte ndryshuar më 6 nëntor 2008 vetëm duke pësuar ndryshim të emrit në Kodi Penal i Kosovës. KPRK-ja i ri kishte hyrë në fuqi më 1 janar 2013, domethënë para vendimit përfundimtar në lidhje me këtë rast.
297. Sipas nenit 20, paragrafi (3) të KPK-së, personi i cili tenton të kryej veprë penale dënohet më butë se sa kryesi, në përputhje me nenin 65, paragrafi (2) i cili e përcakton se dënimi i shqiptuar për tentativë nuk është më shumë se tre-të-katërtat e dënimit maksimal të paraparë për veprën penale.
298. Sipas nenit 28, paragrafit (3) të KPRK-së, ndaj personit që tenton të kryej veprë penale, dënimi mund të zbutet. Trupi gjykues mund gjithashtu të shqiptoj dënimin nën kufijtë e paraparë me ligj ose të shqiptoj një dënim të llojit më të butë kur kushtet e përcaktuara me nenin 75, paragrafin (1) janë përmbushur.
299. Sipas nenit 386, paragrafit (2) të KPPK-së, Gjykata nuk është e detyruar të zbatoj dispozitat e cekura nga Prokurori. Gjithashtu, neni 3, paragrafi (2) i KPRK-së, si dhe neni 2, paragrafi (2) i KPK-së parashohin që në rast të ndryshimit të ligjit të aplikueshëm për ndonjë rast të caktuar para se të merret vendimi përfundimtar, zbatohet ligji që është më i favorshëm për kryesin. Trupi gjykues ka konstatuar se elementet materiale të të gjitha veprave, për të cilat është dënuar i pandehuri, kanë qenë të njëjta në KPK-në si në KPRK-në.
300. Prandaj, për secilën pikë, trupit gjykues i është dashur të ketë parasysh se cilat dispozita lidhur me dënimin dhe caktimin e kohëzgjatjes së dënimit, nëse ndonjë, do të kishin qenë më të favorshme për të pandehurin.
301. Për *Vrasjen e rëndë në tentativë*, në kundërshtim me nenin 147, pika 11) të KPK-së, lidhur me nenin 20 të KPK-së (pika 1 dhe pika 2), KPK-ja parasheh dënim me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose burgim afatgjatë. Në përputhje me nenin 65, paragrafi

- (1) të KPK-së dhe duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të mësipërme, trupi gjykues do dënonte të pandehurin **A. G.1** me katërbëdhjetë (14) vjet burgim.
302. Vepra e njëjtë penale përfshihet në KPRK, në nenin 179, pikën 1.11) të KPRK-së së ri. KPRK-ja parasheh dënimin me burgim prej jo më pak se 10 vjet ose burgim afatgjatë. Sipas neneve 73 dhe 74, paragrafët (2) dhe (3) dhe duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të lartpërmendura, trupi gjykues do dënonte të pandehurin me 18 vjet burgim.
303. Duke marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret rënduese dhe lehtësuese të dënimit të parapara ndaras me KPK dhe me KPRK si dhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do të merrte nëse KPK-ja respektivisht KPRK-ja do aplikohet, trupi gjykues gjen se neni 147, pika 11) e KPK-së në lidhje me nenin 20 të KPK-së (pika 1 dhe pika 2) janë më të favorshëm se neni 179 pika 1.11) i KPRK-së së ri.
304. Bazuar në këtë, i pandehuri **A. G.1** është dënuar me katërbëdhjetë (14) vjet burgim në përputhje me nenin 38, paragrafi (2) i KPK-së.
305. Për *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve*, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) të KPK-së, KPK-ja parasheh një dënim me gjobë deri në 7.500 EUR apo me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të lartpërmendura, trupi gjykues do dënonte të pandehurin për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, me një (1) vjet burgim.
306. KPRK-ja i ri parasheh dy vepra penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 të KPRK-së; dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 375 të KPRK-së. Trupi gjykues unanimisht është pajtuar që vepra penale ligjërisht të cilësohet si Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 të KPRK-së.
307. KPRK-ja i ri për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve parasheh një gjobë deri në 7.500 EUR apo burgim deri në pesë (5) vjet.
308. Duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të mësipërme trupi gjykues do dënonte të pandehurin me një (1) vit burgim.

309. Duke marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret rënduese dhe lehtësuese të dënimit të parapara ndaras me KPK dhe me KPRK si dhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do të merrte nëse KPK-ja respektivisht KPRK-ja do aplikohet, trupi gjykes gjen se neni 328, paragrafi (2) i KPK-së është më i favorshëm se neni 374 i KPRK-së.
310. Bazuar në këtë, i pandehuri është dënuar me një (1) vit burgim në përputhje me nenin 38, paragrafin (2) të KPK-së.
311. Sipas nenit 71, paragrafit (2) nën-paragrafit (2.2) të KPK-së dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet (20) vjetësh. Prandaj, kohëzgjatja e dënimit unik është 14 deri në 20 vjet.
312. Sipas rregullave të llogaritjes së veprave penale të bashkuara në përputhje me nenin 80, paragrafi (2) nën-paragrafi (2.2) i KPRK-së, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh. Prandaj, kohëzgjatja e dënimit unik është 18 deri në 25 vjet.
313. Duke marr parasysh dispozitat e lartpërmendura, dispozitat e KPK-së janë më të favorshme se ato të KPRK-së.
314. Pas marrjes parasysh dhe peshimit me kujdes të të gjitha rrethanave të përgjithshme dhe të veçanta lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykes shqipton dënimin unik prej katërmëdhjetë (14) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim.

H.2 Akuzat kundër të pandehurit S.G.

315. Sipas nenit 73 të KPRK-së dhe ngjashëm nenit 64 të KPK-së, Gjykata përcakton dënimin për veprën penale brenda kufijve të paraparë me ligj për një vepër të tillë penale, duke marr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara me ligj dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin, në veçanti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryesit, pranimin e fajit dhe rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij

pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit.

316. KPRK-ja në paragrafët (2) dhe (3) të nenit 74 numëron rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat merren parasysh kur bëhet caktimi i dënimit por shprehimisht thekson se rrethanat e tilla të përmendura nuk janë të kufizuara por përfshijnë edhe rrethana të tjera. KPK-ja nuk e kufizon shprehimisht se çfarë mund të konsiderohet si rrethanë rënduese apo lehtësuese.
317. Bazuar në këtë, kur ka përcaktuar dënimin, trupi gjykues ka marrë parasysh rrethanat rënduese vijuese. I pandehuri **S. G.** kishte qëlluar disa herë; viktimi **I. I.** ishte i cenueshëm dhe pa mbrojtje.
318. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues ka marrë parasysh kohëzgjatjen e procedurës, pasi që vepra penale ishte kryer në vitin 2009; kohën që i pandehuri **S. G.** ka kaluar në paraburgim dhe gatishmërinë e të pandehurit të bëjë pranimin e fajit. Megjithatë, rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale mbartin një barrë aq të rëndë sa që trupi gjykues nuk ka mundur të gjente ndonjë arsye për të shqiptuar një dënim më të butë.
319. Sipas nenit 3, paragrafit (1) të KPRK-së dhe ngjashëm sipas nenit 2, paragrafit (1) të KPK-së, ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale do të zbatohet ndaj kryesit.
320. I pandehuri **S. G.** ishte dënuar për veprat penale sipas pikës 1 dhe pikës 2. Ai kishte kryer veprat penale kur ligj në fuqi ishte KPK-ja, i cili kishte hyrë në fuqi më 6 prill 2004 me emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe ishte ndryshuar më 6 nëntor 2008 vetëm duke pësuar ndryshim të emrit në Kodi Penal i Kosovës. KPRK-ja i ri kishte hyrë në fuqi më 1 janar 2013, domethënë para vendimit përfundimtar lidhur me këtë rast.
321. Sipas nenit 23 të KPK-së, kur dy apo më shumë persona bashkërisht kryejnë veprë penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale apo duke kontribuar në mënyrë të dukshme në kryerjen e saj në ndonjë formë tjetër, secili nga ta mbahet përgjegjës dhe dënohet siç parashihet për veprën penale. Sipas nenit 31 të KPRK-së së ri, kur dy apo më shumë persona bashkërisht kryejnë veprë penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose duke kontribuar në mënyrë të dukshme në kryerjen e saj në ndonjë formë tjetër, secili nga ta mbahet përgjegjës dhe dënohet siç parashihet për veprën penale.
322. Sipas nenit 386, paragrafi (2) të KPPK-së, Gjykata nuk është e detyruar të zbatoj dispozitat e përcaktuara nga Prokurori. Gjithashtu, neni 3, paragrafi (2) i KPRK-së, si dhe

neni 2, paragrafi (2) i KPK-së parashohin që në rast të ndryshimit të ligjit të aplikueshëm për ndonjë rast të caktuar para se të merret vendimi përfundimtar, zbatohet ligji që është më i favorshëm për kryesin. Trupi gjykues ka konstatuar se elementet materiale të të gjitha veprave, për të cilat është dënuar i pandehuri, ishin të njëjta në KPK-në si në KPRK-në.

323. Prandaj, për secilën pikë trupit gjykues i është dashur të ketë parasysh se cilat dispozita lidhur me dënimin dhe caktimin e kohëzgjatjes së dënimit, nëse ndonjë, do të kishin qenë më të favorshme për të pandehurin.
324. Për *Vrasje*, në kundërshtim me nenin 146 të KPK-së, (pika 1), KPK-ja parasheh dënim me burgim prej së paku dhjetë (5) vjet. Në përputhje me nenin 65, paragrafi (1) të KPK-së dhe duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të mësipërme, trupi gjykues do dënonte të pandehurin **S. G.** me dhjetë (10) vjet burgim.
325. Vepra e njëjtë penale përfshihet në KPRK, në nenin 178 të KPRK-së së ri; KPRK-ja parasheh dënimin me burgim prej jo më pak se 5 vjet. Sipas neneve 73 dhe 74, paragrafët (2) dhe (3) dhe duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të lartpërmendura, trupi gjykues do dënonte të pandehurin **S. G.** me 14 vjet burgim.
326. Duke marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret rënduese dhe lehtësuese të dënimit të parapara ndaras me KPK dhe me KPRK si dhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do të merrte nëse KPK-ja respektivisht KPRK-ja do aplikohesh, trupi gjykues gjen se neni 146 i KPK-së është më i favorshëm se neni 178 i KPRK-së së ri.
327. Bazuar në këtë, i pandehuri **S. G.** është dënuar me dhjetë (10) vjet burgim në përputhje me nenin 38, paragrafi (2) të KPK-së.
328. Për *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve*, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) të KPK-së, KPK-ja parasheh një dënim me gjobë deri në 7.500 EUR apo me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të lartpërmendura, trupi gjykues do dënonte të pandehurin për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, me një (1) vit burgim.
329. KPRK-ja i ri parasheh dy vepra penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 të KPRK-së; dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 375 të KPRK-së. Trupi gjykues unanimisht është pajtuar që vepra

penale ligjërisht të cilësohet si Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 të KPRK-së.

330. KPRK-ja i ri për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve parasheh një gjobë deri në 7.500 EUR apo burgim deri në pesë (5) vjet.
331. Duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të lartpërmendura, trupi gjykues do dënonte të pandehurin me një (1) vit burgim.
332. Duke marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret rënduese dhe lehtësuese të dënimit të parapara ndaras me KPK-në dhe me KPRK-në si dhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do të merrte nëse KPK-ja respektivisht KPRK-ja do aplikohet, trupi gjykues gjen se neni 328, paragrafi (2) i KPK-së është më i favorshëm se neni 374 i KPRK-së.
333. Bazuar në këtë, i pandehuri është dënuar me një (1) vit burgim në përputhje me nenin 38, paragrafin (2) të KPK-së.
334. Sipas nenit 71, paragrafit (2) nën-paragrafit (2.2) të KPK-së dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet (20) vjetësh. Prandaj, kohëzgjatja e dënimit unik është nga 5 deri në 20 vjet.
335. Sipas rregullave të llogaritjes së veprave penale të bashkuara në përputhje me nenin 80, paragrafi (2) nën-paragrafi (2.2) i KPRK-së, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh. Prandaj, kohëzgjatja e dënimit unik është 5 deri në 25 vjet.
336. Duke marr parasysh dispozitat e lartpërmendura, dispozitat e KPK-së janë më të favorshme se ato të KPRK-së.
337. Pas marrjes parasysh dhe peshimit me kujdes të të gjitha rrethanave të përgjithshme dhe të veçanta lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues shqipton dënimin unik prej dhjetë (10) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim.

I. SHPENZIMET

338. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës siç ceket në dispozitiv është marrë në përputhje me nenin 102, paragrafët (1) dhe (4) të KPPK-së.

J. LLOGARITJA E KOHËS SË KALUAR NË PARABURGIM DHE NË ARREST SHTËPIAK

339. Për të dy të pandehurit, në përputhje me nenin 391, paragrafi (5) të KPPK-së dhe nenin 278, paragrafin (7) të KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak nga data 4 dhjetor 2009 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit llogaritet në dënim.

K. KONFISKIMI I PASURISË

340. Sipas nenit 60, paragrafit (1) dhe nenit 328, paragrafit (5) të KPK-së, arma – pistoletë e tipit TT, ngjyrë e zezë, me numër serik 967473766-1964, me plumba brenda dhe arma – pistoletë e tipit M57-TT me numër serik 132205, me plumba brenda janë konfiskuar.

L. KËRKESAT PASURORE

341. Sipas nenit 112, paragrafit (2) të KPPK-së, palët e dëmtuara janë udhëzuar se ato mund të kërkojnë të drejtat e tyre pasurore në kontest civil.

MJETI JURIDIK: I pandehuri, avokati i tij mbrojtës, prokurori apo palët e dëmtuara kanë 15 ditë afat, nga dorëzimi i këtij aktgjykimi, për tu ankuar në përputhje me nenet 380 paragrafin (1) dhe nenin 381 paragrafin (1) të KPP-së. Çdo ankesë duhet të paraqitet në Gjykatën e shkallës së parë sipas nenit 388, paragrafi (1) të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. Nr. 199/15

14 qershor 2016

Franciska FISER

Kryetare e trupit gjykues, EULEX

Dukagjin KËRVESHI

Procesmbajtës

I hartuar në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar